

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“LUIGJ GURAKUQI”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave ekonomike

Viti XIII

2019

Shkodër, 2019

REDAKSIA

Prof. dr. Elez Osmani (kryeredaktor)
Dr. Arjola Halluni (Dergjini) (sekretare shkencore)
Prof. dr. Arjeta Troshani, prof. as. dr. Brilanda Bushati,
prof. as. dr. Blerta Dragusha, prof.as.dr. Albana Begani,
prof. as. dr. Ardita Boriçi (anëtarë)

DREJTOR I REVISTËS
Prof. dr. Adem BEKTESHI

Korrektori dhe punoi në kompjuter:

Arta Bajrami

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e shkencave ekonomike
Tel fax: 00355 22800651

PASQYRA E LËNDËS

Albana BUSHATI, Albana BORIÇI BEGANI

Ndikimi i kapitalit njerëzor në performancën e bizneseve,
rasti i Shkodrës

*The impact of Human Capital on Business Performance, the case
of Shkodra.....*3

Mario ÇURÇIJA

Çfarë lidhje ka ndërmjet numrit të popullsisë urbane dhe punësimit?

*What relationship is there between the dimensions of the urban population
and employment?.....*21

Nevila MEHMETAJ BRAHIMI, Samina LICI

Kreditë me probleme dhe faktorët makroekonomikë

*Non Performing Loans and the Macroeconomic Factors*33

Alkida HASA, Rudin BEKA, Ermira MANI

Kualifikimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore të hoteleve dhe
restoranteve në qytetin e Shkodrës, mundësi e ofruar nga AFP-IA

*Qualification and training of human resources at hotels and
restaurants in the city of Shkodra, opportunity provided by
AFP - IA.....*47

Kledia TUFİ HETA, Arlinda SHKABARI

Performanca financiare e biznesit të vogël dhe ndikimi në ekonomi

Small business financial performance and its impact in economy..... 63

Agim BERISHA

Financat personale dhe të ardhurat e ekonomive familjare në Kosovë

Personal finance and family economic income in Kosovo.....81

Arsilda NEHANAJ, Aurora KINKA PULTI

Roli i kreditimit në ekonominë e një vendi. Rasti i Shqipërisë

The role of bank credit in the economy of a country. The case of Albania.....95

Albano BEQIRI, Irsida KOPLIKU

Ndikimi i ristrukturimit në efikasitetin e kompanisë – rasti i OSHEE,
qarku Shkodër

*The organizational restructuring effect in the efficiency of a Company- OSHEE
case.....113*

NDIKIMI I KAPITALIT NJERËZOR NË PERFORMANCËN E BIZNESEVE, RASTI I SHKODRËS

Albana Bushati¹, Albana Boriçi (Begani)²

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Administrim-Biznesit

Abstrakt

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizohet rëndësia e Kapitalit Njerëzor në përcaktimin e performancës së bizneseve që operojnë në qytetin e Shkodrës.

Kapitali njerëzor përfshin 4 elemente të rëndësishme: edukimin, eksperiencën, aftësitë e trashëguara dhe aftësitë e zhvilluara. Vendet e zhvilluara dhe në zhvillim vënë theksin në zhvillimin e Kapitalit Njerëzor drejt përsheptimit të rritjes ekonomike duke i kushtuar kohën dhe përpjekjet e nevojshme. Zhvillimi i kapitalit njerëzor është një nga zgjidhjet për t'u përfshirë gjithnjë e më shumë drejt globalizimit. Bizneset duhet të investojnë burimet e nevojshme për të zhvilluar kapitalin njerëzor që të kenë një ndikim pozitiv në performancën e tyre.

¹ Diplomuar në korrik të vitit 2017 pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës dhe merr çmimin si “Studentja më e mirë e viteve akademike 2014-2017 në Bachelor Administrim - Biznes, Sadetin & Mirjeta Beqiri Excellence Award”. Në korrik të vitit 2019 mori titullin Master i Shkencave në Administrim-Biznes pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës.

² Diplomuar në korrik të vitit 1999 pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës. Në 2002 fiton gradën Master në Administrim- Biznes (MBA) pranë Universitetit të Illinoisit të Jugut në SHBA. Në 2009 i jepet grada Doktor i Shkencave Ekonomike nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës, dhe në 2015, i akordon titullin Profesor i Asociuar. Ka përfunduar me sukses shumë kualifikime dhe punë kërkimore të zhvilluara në institucione të ndryshme, si: Universiteti i Bolonjës, Chietit e Riminit në Itali, Universiteti i Shkencave të Aplikuara i Eberswalde-s në Gjermani, Universiteti i Gracit dhe Vjenës në Austri etj. Ka punuar si lektore pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës që nga viti 1999 dhe ka dhënë leksione pranë Universitetit të Vjenës, Podgoricës, Malit të Zi. Aktiviteti i saj akademik është i gjerë, me pjesëmarrje në konferenca, aktivitete dhe publikime shkencore kombëtare e ndërkombëtare, të lidhura ngusht me sfidat e menaxhimit të biznesit ndërkombëtar.

Metoda që është përdorur për të realizuar këtë studim është pyetëso. Duke arritur një kampion me 65 biznese dhe ndarjes së kapitalit njerëzor në 4 faktorë; rezultoi se faktori që ndikon më tepër në performancën e bizneseve është faktori i aftësive të zhvilluara të punonjësve. Konkretisht rezultoi se performanca e biznesit shpjegohet në një masë 42.5% nga aftësitë e zhvilluara të punonjësve. Është pikërisht ky faktor aty ku bizneset duhet të investojnë në mënyrë që performanca e tyre të rritet gjithnjë e më tepër.

Fjalët kyçe: kapital njerëzor, performanca e bizneseve, edukimi, eksperiencia, aftësitë e trashëguara, aftësitë e zhvilluara.

The impact of Human Capital on Business Performance, the case of Shkodra

Abstract

The aim of this study is to analyze the importance of human capital in determining the performance of businesses operating in the city of Shkodra.

Human capital includes 4 important elements: education, experience, inherited abilities and developed skills. Developed and developing countries emphasize the development of human capital to accelerate economic growth by devoting the time and effort needed. Human capital development is one of the solutions to becoming increasingly involved in globalization. Businesses need to invest the resources needed to develop human capital in order to have a positive impact on their performance.

The method used on this study is a questionnaire. Achieving a champion with 65 businesses and dividing human capital in 4 factors; it turned out that the most influential factor for business performance is the developed skills of employees. Concretely, the business performance is explained to by 42.5% of the developed skills of employees. It is precisely this factor where businesses need to invest in order to increase their performance.

Key words: human capital, business performance, education, experience, inherited abilities, developed skills.

Hyrje

Në një ekonomi globale, në ndryshim të vazhdueshëm, e shoqëruar me një konkurrencë shumë të ashpër, bizneset duhet të jenë shumë vigjilente në mënyrë që të qëndrojnë në periudha afatgjata në treg dhe të gëzojnë avantazhe konkurruese. Si një mjet i cili mund të përdoret për të siguruar një pozitë të fuqishme dhe konkurruese në industrinë ku ai operon, çdo biznes duhet të bëjë përpjekje për t'i kushtuar rëndësi *kapitalit njerëzor* dhe investimit të tij për zhvillim.

Kohët e fundit termi Kapital Njerëzor është bërë shumë i rëndësishëm në çdo fushë. Sado që të përparojë teknologjia, njeriu është dhe do të mbetet një aset i pazëvendësueshëm për çdo biznes.

Shumica e literaturave të huaja të përdorura gjatë këtij punimi tregojnë se sa i rëndësishëm është në sigurimin e një performance të favorshme për bizneset në sektorë nga më të ndryshëm.

Ekonomia shqiptare është e përqendruar më së shumti në aktivitetin tregtar. E njëjta gjë ndodh edhe në qytetin e Shkodrës, i cili është fokusi i këtij studimi. Sipas statistikave të realizuara nga INSTAT (2018), në fund të vitit 2018, gjenden aktualisht 11,309 biznese në qytetin e Shkodrës; ku 1,078 janë regjistruar gjatë vitit të fundit. Bizneset tregtare zënë 23.2% të totalit të bizneseve të regjistruara gjatë gjithë vitit. Meqë literatura në shqip mungon për një temë të tillë, u pa me vlerë realizimi i këtij studimi në qytetin e Shkodrës për të zbuluar të dhëna mbi konceptin e kapitalit njerëzor dhe zhvillimin e tij në biznese në Shkodër.

Në nivel individual, rezultatet e këtij punimi do t'u vijnë në ndihmë të gjithë të punësuarve dhe studentëve që po angazhohen në tregun e punës, për të parë se cilat janë investimet që ata kanë bërë për veten e tyre.

Në nivel institucional, ky punim do t'u vijë në ndihmë bizneseve dhe drejtuesve, në mënyrë që t'i kushtojnë rëndësi kapitalit njerëzor dhe të shohin përfitimet që sjell në performancën e bizneseve.

Në nivel lokal dhe kombëtar, rezultatet e këtij punimi mund të sigurojnë informacion në lidhje me ecurinë e bizneseve dhe identifikimin e rëndësisë së kapitalit njerëzor. Nga identifikimi i sfidave të zhvillimit të kapitalit njerëzor, institucioneve lokale dhe kombëtare, mund t'i shërbejë si nxitje për të hartuar programe të ndryshme për zhvillimin dhe reduktimin e sfidave të kapitalit njerëzor.

Pyetja kërkimore

Cili është ndikimi i Kapitalit Njerëzor në performancën e bizneseve në qytetin e Shkodrës?

Qëllimi i kësaj pyetjeje është të evidentojmë se sa rëndësi i kushtojnë bizneset që operojnë në qytetin e Shkodrës kapitalit njerëzor dhe sa të

gatshëm janë ato të investojnë në përmirësimin e tij.

Objektivat e punimit

- ✓ Të analizohet koncepti i Kapitalit Njerëzor,
- ✓ Të identifikohen elementet që përfshihen në Kapitalin Njerëzor,
- ✓ Të përcaktohen 2 nga teoritë më të hershme mbi Kapitalin Njerëzor,
- ✓ Të trajtohet rëndësia e Kapitalit Njerëzor në performancën e bizneseve,
- ✓ Të identifikohet mënyra se si matet performanca e bizneseve,
- ✓ Të nxirren rezultate reale nga analiza statistikore.

Hipotezat e punimit

Sipas elementeve të Kapitalit Njerëzor: *Edukimi i Punonjësve (ED)*, *Eksperiencia (EX)*, *Aftësitë e Trashëguara (AT)* dhe *Aftësitë e Zhvilluara (AZH)* mund të përcaktojmë 4 hipoteza që do të testojmë me anë të analizës së regresionit:

Hipoteza e parë: Ka marrëdhënie statistikisht domethënëse midis edukimit të punonjësve me performancën e bizneseve.

Hipoteza e dytë: Ka marrëdhënie statistikisht domethënëse midis eksperiencës së punonjësve me performancën e bizneseve.

Hipoteza e tretë: Ka marrëdhënie statistikisht domethënëse midis aftësive të trashëguara të punonjësve me performancën e bizneseve.

Hipoteza e katërt: Ka marrëdhënie statistikisht domethënëse midis aftësive të zhvilluara të punonjësve me performancën e bizneseve.

1. KAPITALI NJERËZOR

1.1 Kapitali Njerëzor si koncept

Kapitali njerëzor është një nga përbërësit e kapitalit intelektual dhe përbëhet nga aftësitë, njohuritë dhe përvojat e punonjësve të organizatës, si dhe të menaxhimit (Vanhala et al., 2006).

Sullivan dhe Sheffrin (2003) përcaktojnë kapitalin njerëzor, si stok i kompetencave, njohurive dhe atributet e personalitetit të mishëruara në aftësinë për të realizuar punën që të krijohet vlerë. Kapitali njerëzor përfaqëson investimin që njerëzit realizojnë vetë ose nga organizatat ku punojnë që të rrisin produktivitetin dhe performancën e biznesit.

Teoria e Kapitalit Njerëzor u propozua nga Schultz në vitin 1961 dhe më pas u zhvillua nga Becker në 1964. Schultz (1961) ka realizuar ndarjen e termit “kapital” në termat: kapital financiar, organizacional, intelektual, njerëzor, strukturor, social dhe atij të inovacionit.

Teoria e kapitalit njerëzor, u riprezantua duke na ndihmuar të kuptojmë aktivitetet trajnuese të firmave (G. S. Becker, 1962). U theksua pikëpamja se arsimi dhe trajnimi përfaqësojnë investime në produktivitetin e ardhshëm dhe jo vetëm konsumim burimesh.

Teoria e Kapitalit Njerëzor tenton të shpjegojë se cilat janë përfitimet që rezultojnë nga edukimi dhe trajnimi si investim në burime njerëzore. Në këtë këndvështrim dy nga investimet më të rëndësishme në kapitalin njerëzor janë *edukimi* dhe *shkollimi*, që bëjnë të mundur përgatitjen e fuqisë punëtore, rritjen e produktivitetit individual dhe si rrjedhojë të produktivitetit të organizatës ku punojnë (Aliaga, 2005).

1.2 Elementet përbërës të Kapitalit Njerëzor

Kapitali njerëzor përfshin: *edukimin, eksperiencën, aftësitë e trashëguara dhe aftësitë e zhvilluara* të çdo individi të caktuar (Hitt et al., 2001).




Figura 1-1. Elementet përbërës të kapitalit njerëzor.

1.2.1 Edukimi

Edukimi është një ndër investimet më të rëndësishme në kapitalin njerëzor. Zhvillimi i nivelit të edukimit ka marrë një hov të madh në ekonomitë moderne, sepse sa më shumë të kesh njohuri dhe informacion, aq më shumë shanse ka të jesh i suksesshëm në të ardhmen në një profesion të caktuar (G. S. Becker, 2009).

Në përgjithësi, gjetjet e studimeve theksojnë, se punonjësit që kanë nivele më të larta të edukimit janë të pakënaqur me punën, sepse kushtet e saj nuk i përshtaten nivelit të tyre të edukimit (Edwards et al., 2009).

Një nivel i lartë i edukimit ka shanse të sigurojë më tepër produktivitet dhe punëdhënësit janë më të gatshëm të ofrojnë paga më të larta për ata punonjës që janë më të arsimuar (Fossen & Büttner, 2013).

1.2.2 Eksperienca

Eksperienca ose përvoja profesionale konsiderohet si një ndër faktorët më të rëndësishëm që prek shumë aspekte të firmave sipërmarrëse (Marvel & Lumpkin, 2007).

Schmidt & Hunter (1998) paraqesin një model të marrëdhënieve shkak-pasojë ndërmjet eksperiencës së punës, nivelin e aftësive, njohurive dhe performancën në punë.

Faktikisht ka dilema të ndryshme për përcaktimin e lidhjes që ekziston midis eksperiencës së punonjësve me nivelin e performancës së bizneseve. Schmidt et al., (1986) shprehin qartazi lidhjen pozitive që ekziston midis nivelit të eksperiencës së punonjësve dhe performancës së bizneseve. Ata argumentojnë se një punonjës i cili ka punuar për shumë vite në biznes, ka më shumë shanse që të sjellë një performancë shumë të lartë të biznesit. Megjithatë, ka raste kur individët me të njëjtën eksperiencë performojnë në mënyrë të ndryshme. Kjo ndodh si pasojë e aftësisë së përballjes së një situatë të caktuar dhe marrjes së vendimeve (Quinones et al., 2001).

1.2.3 Aftësitë e trashëguara ose të lindura

Një nga dilemat më të rëndësishme në fushën e menaxhimit, ka të bëjë me mënyrën e përcaktimit nëse aftësitë e punonjësve janë të lindura apo të fituara gjatë eksperiencës. Aftësitë e trashëguara janë gjithmonë të bazuara në gjene. Këta janë bartësit e faktorëve të trashëguar dhe përcaktojnë pamjen e jashtme të çdo njeriu dhe disa nga karakteristikat që janë të ngulitura thellë. Rëndësi i kushtohet nëse origjina e mendimit, emocioneve, gjuhës dhe personaliteti janë të trashëguara nga prindërit apo arrijnë të fitohen dhe të ndryshojnë me kalimin e kohës (Meltzoff, 1999).

Disa nga aftësitë e zhvilluara janë: dominimi, shoqërizimi, vetëbesimi, pavarësia dhe empatia (Bass, 1990).

1.2.4 Aftësitë e zhvilluara

Përveç aftësive që çdo individ i ka të lindura ose të trashëguara nga familja, ekzistojnë edhe ato aftësi që mësohen dhe zhvillohen me kalimin e kohës. Aftësitë e mësuara mund të ndahen në dy kategori të gjera:

- ▶ aftësi teknike
- ▶ aftësi joteknike.

Aftësitë teknike i referohen njohurive dhe kompetencave që çdo individ merr në fusha të caktuara gjatë studimeve (Cassidy, 2006).

Aftësitë joteknike referohen si shkathtësia e realizimit të një pune dhe përfshijnë aftësi, si: komunikimi verbal, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, përgjegjësia, aftësi ndërpersonale, vetëdisiplina dhe aftësia për të punuar pa mbikëqyrje (Falchikov & Goldfinch, 2000).

1.3 Performanca e bizneseve

Në tregun dinamik global, bizneset janë të rrethuara nga konkurrentët. Për të zhvilluar një avantazh konkurrues, është e rëndësishme që të shfrytëzojnë fuqinë punëtore si një forcë konkurruese (Tessema, 2014).

Ndikimi i kapitalit njerëzor në performancën e biznesit shkaktohet nga dy forca themelore: produktiviteti dhe sinjalizimi. *Së pari*, sa më shumë kapital njerëzor të jetë i ngulitur në biznese, aq më i lartë do të jetë niveli i produktivitetit të biznesit, dhe *së dyti* palët e interesit siç janë klientët, nënkontraktorët dhe investitorët nuk kanë një informacion të detajuar për llojin e bizneseve me të cilat operojnë (B. Becker & Gerhart, 1996). Sipas gjetjeve të studimit të realizuar nga Schmidt et al., (1986) rezultoi se kapitali njerëzor nxit prodhimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe krijimin e inovacioneve të reja në treg.





Figura 1-2. Ndikimi i elementeve të Kapitalit Intelektual mbi Performancën (Crook, Todd, Combs, Woehr, & Ketchen, 2011)

1.4 Modeli Konceptual

Investimi i përgjithshëm i kapitalit njerëzor përfshin trajnimin, arsimin, njohuritë dhe shkathësitë që do të rrisin efektivitetin e kapitalit njerëzor. Bazuar në shqyrtimet e literaturës, supozohet se në shumicën e rasteve kapitali njerëzor çon në një performancë më të lartë për bizneset.

Performanca e biznesit pasqyrohet në dy perspektiva të ndryshme; performancën financiare dhe jofinanciare. Performanca financiare pasqyron rezultatet e biznesit që tregojnë “shëndetin” e përgjithshëm financiar të biznesit gjatë një periudhe të caktuar kohe. Nga ana tjetër performanca jofinanciare përfshin kënaqësinë e klientit, inovacionin, përmirësimin e punës dhe zhvillimin e aftësive të biznesit (Naz et al., 2016).

Figura 1-3. Model konceptual që lidh Investimin e Kapitalit Njerëzor, Efektivitetin e Kapitalit Njerëzor dhe Performancën e Biznesit (Marimuthu et al., 2009).



2. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për këtë punim është anketimi. Anketimi përdoret për të eksploruar diferencat që ekzistojnë ndërmjet një numri më të madh individësh dhe lejon akses edhe në zona të ndryshme gjeografike (Clifford et al., 2016).

2.1 Popullata dhe kampioni

Popullata që përfshihet në këtë studim janë të gjitha bizneset që operojnë në qytetin e Shkodrës. Është përzgjedhur qyteti i Shkodrës për lehtësi studimi dhe gjenerimit të të dhënave, duke pasur në konsideratë edhe limitimet në kohë për të realizuar këtë punim.

Kampioni në këtë studim është i barabartë me 65 biznese që operojnë në qytetin e Shkodrës. Pyetësi është plotësuar nga njëri nga drejtuesit e biznesit që mund të jetë menaxher i nivelit të ulët, të lartë ose të mesëm.

2.2 Metoda e mbledhjes dhe analizës së të dhënave

Metoda e mbledhjes së të dhënave është nëpërmjet pyetësorit. Pyetësori është i ndarë në disa seksione.

Seksioni i parë, karakteristikat socio-demografike.

Seksioni i dytë, niveli i zhvillimit të kapitalit njerëzor ku trajtohen 4 elementet e përfshira në modelin tonë të Kapitalit Njerëzor: edukimi, eksperiencia, aftësitë e trashëguara dhe ato të zhvilluara.

Seksioni i tretë, identifikimi i sfidave të zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Për të analizuar të dhënat është përdorur software statistikor SPSS statistic 20. Analiza e të dhënave bëhet nëpërmjet Analizës Faktoriale dhe regresionit. Analizohet lidhja që ekziston midis variablave të pavarur të përfshira në studim me variablin e varur.

3. ANALIZA E TË DHËNAVE

3.1 Statistika përshkruese

Tabela 1-1. Statistika përshkruese e variablave

Variablat	N	Mesatarja	Devijimi standard
Gjinia	65	1.5231	0.5033
Mosha	65	36.80	11.433
Niveli i edukimit	65	5.8154	1.197
Pozicioni	65	1.908	0.8047
Vitet e eksperiencës	65	13.3846	10.3743
Sektori aktual	65	1.1231	0.3310
Sektori përpara	65	2.2615	1.1763
Kriteri i punësimit	65	2.769	1.08641
Niveli i kënaqësisë	65	1.7230	0.6252
Eksperiencia në biznes	65	2.1230	1.179
Eksperiencia në menaxhim	65	3.1846	7.2949
Vitet e biznesit	65	3.2307	1.444
Lloji i biznesit	65	1.9384	0.7262
Madhësia e biznesit	65	2.1846	0.7265
Origjina e biznesit	65	1.1692	0.3778
Numri i punonjësve	65	2.5538	1.2628
Faza e biznesit	65	2.3220	0.6400

Variablat e mësipërm janë të përfshirë me seksionin e karakteristikave demografike. Siç vihet re, N=65; që do të thotë, që të gjithë të anketuarit i

kanë plotësuar të gjitha pyetjet. Të paraqitura në tabelë janë edhe mesataret e secilës prej variablave që variojnë nga 1-4, pa përfshirë variablin moshë dhe vitet e eksperiencës që janë variabla scale.

Sipas analizës përshkruese rezultoi se 40% e bizneseve të përfshira në studimin tonë janë biznese të mëdha. 75% prej tyre implementojnë programe në lidhje me zhvillimin e kapitalit njerëzor.

Gjithashtu, gjatë analizës së pyetësorit rezultoi se sfida më e madhe e zhvillimit të kapitalit njerëzor është mungesa e burimeve financiare.

3.2 Analiza faktoriale dhe e besueshmërisë

Analiza faktoriale është një metodë statistikore në të cilën vlerat e të dhënave, shprehen si funksione të një numri faktorësh për të gjetur cilat janë më të rëndësishmet (Costello & Osborne, 2005). Metoda e analizës do të realizohet me rotacionin Varimax.

Faktorët e studimit tonë janë 4 elementet e Kapitalit Njerëzor: edukimi, eksperiencia, aftësitë e lindura dhe ato të zhvilluara. Për secilin kemi përfshirjen e 8 nënfaktorëve. Në fillim realizohet analiza e besueshmërisë me anë të krahasimit me Cronbach Alpha. Secili nga pohimet duhet që të ketë vlera të Alpha > 0.7 që të kenë rëndësi statistikore (Santos, 1999). Peshat faktoriale duhet të jenë më të larta se 0.4 (Costello & Osborne, 2005).

Nënfaktorët e ED përfshijnë: nivelin e edukimit të punonjësve, të menaxherëve dhe fushën e studimeve. Peshat faktoriale variojnë nga 0.470 në 0.872. Niveli i Alpha = 0.836 vlerë kjo më e lartë se 0.7.

Nënfaktorët e EX përfshijnë: ide të reja, identifikimin e problemeve, avancimin në karrierë. Peshat faktoriale variojnë nga 0.282 në 0.657. Pohimi i parë që eliminohet është "Identifikimi i problemeve me shpejtësi", sepse ka peshën faktoriale më të vogël.

Nënfaktorët e AT përfshijnë: këmbënguljen, vetëbesimin, aftësi udhëheqjeje, ndjenja motivimi. Peshat faktoriale variojnë nga vlera 0.461 në 0.764. Niveli i Alpha = 0.864.

Nënfaktorët e AZH përfshijnë: komunikimin verbal, ndjenja sigurie, mbikëqyrje, aftësi teknike. Peshat faktoriale variojnë nga 0.630 në 0.768. Niveli i Alpha = 0.891.

Nënfaktorët e Performancës përfshijnë: koston e problemeve, feedback i klientave, menaxhimin e informacioneve, imazhin dhe reputacionin e biznesit. Peshat faktoriale variojnë nga 0.506 në 0.902. Niveli i Alpha=0.936

Tabela 3-1. Analiza Faktoriale

Variablat	Numri i nënfaktorëve/pohimeve
<i>Variablat e pavarur</i>	
Edukimi	8
Eksperienca	6
Aftësitë e lindura	8
Aftësitë e zhvilluara	8
<i>Variabli i varur</i>	
Performanca	14

Burimi: Llogaritjet e autorit, SPSS

3.3.1 Regresioni linear

Regresioni linear është një metodë statistikore që na lejon të studiojmë marrëdhëniet ndërmjet dy variablave të vazhdueshëm (Seber & Lee, 2012).

Hipoteza e parë: Ka marrëdhënie statistikisht domethënëse midis edukimit të punonjësve me performancën e bizneseve.

Tabela 3-2. Modeli i Regresionit, Edukimi dhe Performanca

Modeli	Koeficienti B	Gabimi Standard
Konstantja	1.005	0.221
Edukimi	0.325	0.116

Burimi: Llogaritjet e autorit, SPSS

“Performanca e bizneseve” = 1.005 + 0.325 (Edukimi)

Koeficienti i regresionit është 0.325 që tregon që një rritje në nivelin e edukimit të punonjësve rezulton në një rritje të nivelit të performancës së bizneseve.

Ka një marrëdhënie statistikisht domethënëse midis variablit të varur “performancë” dhe variablit të pavarur “edukim”.

Hipoteza e dytë: Ka marrëdhënie statistikisht domethënëse midis eksperiencës së punonjësve me performancën e bizneseve.

Tabela 3-3. Analiza e Regresionit, Eksperienca dhe Performanca

Modeli	R	R ²	R ² i rregulluar	t	P (sig)
Konstantja	0.224	0.05	0.035	6.395	0.000
Eksperienca				1.825	0.073

Burimi: Llogaritjet e autorit, SPSS

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, dallojmë se vlera e P= 0.073 < Alpha 0.05. Kjo tregon që regresioni linear nuk është domethënës në këtë nivel që do të thotë se variabli jonë i pavarur eksperienca e punonjësve nuk arrin ta shpjegojë në mënyrë statistikisht të rëndësishme variablin performancë.

Si përfundim, hipoteza e dytë hidhet poshtë.

Hipoteza e tretë: Ka marrëdhënie statistikisht domethënëse midis aftësive të trashëguara të punonjësve me performancën e bizneseve.

Tabela 3-4. Analiza e Regresionit, Aftësitë e Trashëguara dhe Performanca

Modeli	Koeficienti B	Gabimi Standard
Konstantja	0.935	0.222
Aftësitë e trashëguara	0.353	0.113

Burimi: Llogaritjet e autorit, SPSS

“Performanca e bizneseve” = 0.935 + 0.353 (Aftësitë e trashëguara)

Koeficienti i regresionit është pozitiv 0,325 që tregon që një rritje në nivelin e aftësive të trashëguara të punonjësve rezulton në një rritje të nivelit të performancës së bizneseve.

Ka një marrëdhënie statistikisht domethënëse midis variablit “performancë” dhe variablit “aftësi të trashëguara”.

Hipoteza e katërt: Ka marrëdhënie statistikisht domethënëse midis aftësive të zhvilluara të punonjësve me performancën e bizneseve.

Tabela 3-18. Modeli i Regresionit, Aftësitë e Zhvilluara dhe Performanca

Modeli	Koeficienti B	Gabimi Standard
Konstantja	0.870	0.205
Aftësitë e zhvilluara	0.373	0.100

Burimi: Llogaritjet e autorit, SPSS

“Performanca e bizneseve” = 0.870 + 0.373 (Aftësi të zhvilluara)

Koeficienti i regresionit është pozitiv 0,373 që tregon që një rritje në nivelin e aftësive të zhvilluara të punonjësve rezulton në një rritje të nivelit të performancës së bizneseve.

Ekziston një marrëdhënie statistikisht domethënëse midis variablit “performancë” dhe variablit “aftësi të zhvilluara”.

PËRFUNDIME

Koncepti i kapitalit njerëzor është trajtuar shumë vite më parë nga studiues të njohur. Në fillim koncepti dhe rëndësia e tij u propozua nga Schultz në 1961 dhe më pas u zhvillua nga Becker në 1964.

Duke qenë një burim i paprekshëm është e vështirë matja e tij. Gjatë rishikimit të literaturës, disa nga faktorët që ndikojnë dhe përfshihen në kapitalin njerëzor janë:

1. Nivelet e arsimit,
2. Eksperienca e punës,

3. Aftësitë sociale – komunikimi,
4. Inteligjenca dhe ajo emocionale,
5. Personaliteti (G. S. Becker, 2009).

Në studimin tonë, duke përfshirë edhe limitimet përkatëse, janë marrë në konsideratë vetëm disa faktorë dhe janë përfshirë në grupe, si: edukimi, eksperiencia, aftësitë e trashëguara dhe aftësitë e zhvilluara.

Vëmendje iu kushtua Analizës së Regresionit Linear. Rezultoi se ka një marrëdhënie statistikisht domethënëse midis “edukimit” dhe “performancës”. Performanca shpjegohet në një masë 11.1% nga edukimi i punonjësve. Variabli i dytë i pavarur “eksperiencia” e punonjësve nuk arrin ta shpjegojë në mënyrë statistikisht të rëndësishme variablin “performancë”. Kjo do të thotë që ky faktor duhet të hiqet nga modeli, pasi nuk është i rëndësishëm. Variabli i tretë “aftësitë e trashëguara” arrin ta shpjegojë në mënyrë statistikisht të rëndësishme variablin “performancë”. Rezultoi se performanca e biznesit shpjegohet në një masë 13.4% nga aftësitë e trashëguara të punonjësve.

Edhe variabli i fundit “aftësitë e zhvilluara” të punonjësve arrin ta shpjegojë në mënyrë statistikisht të rëndësishme variablin “performancë”. Rezultoi se performanca shpjegohet në një masë 42.5% nga aftësitë e zhvilluara të punonjësve. Ky faktor është edhe faktori që ndikon më shumë në variablin “performancë”. Kjo do të thotë që elementet, si: njohuri, kompetenca, aftësi ndërpersonale dhe aftësia për të punuar pa mbikëqyrje janë shumë të rëndësishme për bizneset në mënyrë që të sigurojnë një performancë të mirë.

Vlen të theksohet se janë pikërisht bizneset e mëdha ato që i kushtojnë më tepër rëndësi konceptit dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor, sepse ata kanë më shumë punonjës dhe burime më të shumta financiare për investim. Duke i kushtuar më tepër rëndësi Kapitalit Njerëzor, kuptohet mjaft qartë se edhe performanca e bizneseve të mëdha është më e lartë krahasuar me ato të voglat ose të mesmet. Arsyeja kryesore e sfidës së zhvillimit të kapitalit njerëzor është mungesa e burimeve financiare. Sipas gjetjeve rezultojnë, se bizneset e mëdha realizojnë programe formale të shkruara për zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe sigurojnë: trajnimin, orientimin e punonjësve të rinj, promovimin, rotacionin dhe vlerësimin e performancës.

Rekomandime për menaxherët

Duke qenë se kampioni i studimit janë bizneset që operojnë në Shkodër, rekomandimet e mëposhtme janë për drejtuesit ose menaxherët e tyre.

Megjithatë rezultoi se niveli i edukimit është i lidhur pozitivisht me performancën e bizneseve, menaxherët e tyre duhet t'i kushtojnë rëndësi këtij faktori. Ata duhet të rekrutojnë punonjës të cilët niveli i edukimit dhe fusha e studimit të jenë të ndërlidhura me pozicionin e punës. Ka më shumë shanse që punonjësit të kenë nivele të larta kënaqësie. Ata e realizojnë punën më me dëshirë dhe kanë produktivitet më të lartë. Si rrjedhojë edhe performanca e biznesit do të përmirësohet në periudhë afatgjatë.

Niveli i eksperiencës së punonjësve nuk rezultoi i rëndësishëm statistikisht, por ka nevoja për përmirësim. Me të vërtetë punonjësit me nivele të larta eksperience mund të performojnë më mirë në biznes, duhet që edhe punonjësit e rinj të kenë mundësi të shfaqin talentin e tyre. Ata ndoshta mund të sjellin ide të reja për biznesin dhe të sigurojnë një performancë më të mirë.

Një rekomandim tjetër, ka të bëjë me mënyrën e pozicionimit në vendet e punës të punonjësve në varësi të aftësive që shfaqin. Punonjësit që kanë aftësi shumë të mira teknike preferohen të pozicionohen në proceset e prodhimit ose të Sistemeve të Informacionit. Në të kundërt, punonjësit që shfaqin aftësi të larta joteknike duke përfshirë këtu: komunikimin verbal, aftësitë bashkëpunuese; preferohen që të pozicionohen më afër konsumatorit.

Për të ruajtur nivelin e aftësive që punonjësit kanë, ose edhe për t'i zhvilluar gjithnjë e më tepër, bizneset duhet të hartojnë programe trajnimi, në mënyrë periodike. Bizneset duhet të operojnë paralelisht me teknologjinë që të sigurojnë pozicion strategjik dhe konkurrues në treg.

Si përfundim, mund të themi se bizneset duhet të realizojnë disa plane efektive, sidomos në investimin e elementeve të kapitalit njerëzor, jo vetëm për arritjen e një performace më të lartë, por siguron që firmat të mbeten konkurruese dhe afatgjatë në treg.

Rekomandime për studiuesit e ardhshëm

Duke qenë se kampioni është relativisht i vogël, për studiuesit e ardhshëm rekomandohet përzgjedhja e një kampioni më të madh, në mënyrë që edhe rezultatet e analizës të dalin sa më të sakta.

Edukimi, eksperiencia, aftësitë e trashëguara dhe ata të zhvilluara nuk janë faktorët e vetëm që ndikojnë në kapitalin njerëzor. Përfshirja e

faktorëve të tjerë në studimet e ardhshme do të bënte të mundur një analizë më të detajuar të ndikimit në performancë.

Duke qenë se afati kohor ka qenë relativisht i shkurtër, të dhënat nga pyetësi janë përfituar për 2 muaj, rekomandohet që në studimet e ardhshme të zgjerohet horizonti kohor dhe të përfshihen më tepër biznese.

Limitimet e punimit

Gjatë përgatitjes së këtij punimi dhe analizës së rezultateve shfaqen edhe problematika të caktuara. Një ndër limitimet është numri i pjesëmarrësve në pyetësor. Kampioni i vogël shpesh shfaqet si një ndër limitimet më të shpeshta në çdo punim.

Në një hapësirë të kufizuar kohore për të realizuar këtë punim, ishte e pamundur gjenerimi i një numri më të madh të kampionit, të bizneseve që operojnë në Shkodër. Kufizimi kohor nuk na lejon të kuptojnë ndryshimin në kohë.

Meqenëse edhe studime të tjera në lidhje me këtë koncept janë të pakta në Shqipëri dhe mbi të gjitha në Shkodër janë hasur vështirësi në analizimin e përpiktë të rezultateve. Mungesa e mundësisë së marrjes së informacioneve financiare (ROI, ROE, ROA, Fitimi marxhinal) me shifra konkrete të bizneseve shfaqet si një limitim tjetër i rëndësishëm për punimin. Duke qenë se këto të dhëna janë tepër konfidenciale për bizneset, nuk na lejon të realizojmë një model më të pastër për punimin tonë.

BIBLIOGRAFIA

- Aliaga, O. A. (2005). *A study of innovative Human Resource Development practices in Minnesota companies*. 204.
- Bass, B. M. (1990). From transactional to transformational leadership: Learning to share the vision. *Organizational Dynamics*, 18(3), 19–31. [https://doi.org/10.1016/0090-2616\(90\)90061-S](https://doi.org/10.1016/0090-2616(90)90061-S)
- Becker, B., & Gerhart, B. (1996). The impact of human resource management on organizational performance: Progress and prospects. *Academy of Management Journal*, 39(4), 779–801. <https://doi.org/10.2307/256712>
- Becker, G. S. (1962). Investment in Human Capital: A Theoretical Analysis. *Journal of Political Economy*, 70(5), 9–49.
- Becker, G. S. (2009). Human Capital Revisited. In *Human Capital: A Theoretical and Empirical Analysis, with Special Reference to Education* (3rd ed., pp. 17–21). University of Chicago Press.
- Cassidy, S. (2006). Developing employability skills: Peer assessment in higher education. *Education + Training*, 48(7), 508–517. <https://doi.org/10.1108/00400910610705890>
- Clifford, N., Cope, M., Gillespie, T., & French, S. (2016). *Key Methods in Geography*. SAGE.

- Costello, A. B., & Osborne, J. W. (2005). Best Practices in Exploratory Factor Analysis: Four Recommendations for Getting the Most From Your Analysis. *Exploratory Factor Analysis*, 10(7), 9.
- Crook, T. R., Todd, S. Y., Combs, J. G., Woehr, D. J., & Ketchen, D. J. (2011). Does human capital matter? A meta-analysis of the relationship between human capital and firm performance. *Journal of Applied Psychology*, 96(3), 443–456. <https://doi.org/10.1037/a0022147>
- Edwards, J. A., Laar, D. V., Easton, S., & Kinman, G. (2009). The Work-related Quality of Life Scale for Higher Education Employees. *Quality in Higher Education*, 15(3), 207–219. <https://doi.org/10.1080/13538320903343057>
- Falchikov, N., & Goldfinch, J. M. (2000). *Student Peer Assessment in Higher Education: A Meta-Analysis Comparing Peer and Teacher Marks*. <https://doi.org/10.3102/00346543070003287>
- Fossen, F. M., & Büttner, T. J. M. (2013). *The returns to education for opportunity entrepreneurs, necessity entrepreneurs, and paid employees*. 1.
- Hitt, M. A., Bierman, L., Shimizu, K., & Kochhar, R. (2001). Direct and Moderating Effects of Human Capital on Strategy and Performance in Professional Service Firms: A Resource-Based Perspective. *The Academy of Management Journal*, 44(1), 13–28. <https://doi.org/10.2307/3069334>
- Marimuthu, M., Arokiasamy, L., & Ismail, M. (2009). *Human Capital Development and Its Impact on Firm Performance: Evidence from Developmental Economics*. 2, 8.
- Marvel, M. R., & Lumpkin, G. T. (2007). Technology Entrepreneurs' Human Capital and Its Effects on Innovation Radicalness. *Entrepreneurship Theory and Practice*, 31(6), 807–828. <https://doi.org/10.1111/j.1540-6520.2007.00209.x>
- Meltzoff, A. (1999). Born to Learn: What Infants Learn from Watching Us. *Role Early Exp. Infant Dev*.
- Naz, F., Ijaz, F., & Naqvi, F. (2016, May 1). *FINANCIAL PERFORMANCE OF FIRMS: EVIDENCE FROM PAKISTAN CEMENT INDUSTRY*. 5, 81–94.
- O'Sullivan, A., & Sheffrin, S. M. (2003). *Economics: Principles in action*. Needham, Mass.: Prentice Hall.
- Quinones, M., Teachout, M., & Ford, J., Kelvin. (2001). (PDF) *The Relationship Between Work Experience and Job Performance: A Conceptual and Meta-Analytic Review*. 5–6.
- Santos, J. R. A. (1999). Cronbach's Alpha: A Tool for Assessing the Reliability of Scales. *Journal of Extension*, 37(2). Retrieved from <https://www.joe.org/joe/1999april/tt3.php>
- Schmidt, F. L., & Hunter, J. E. (1998). The validity and utility of selection methods in personnel psychology: Practical and theoretical implications of 85 years of research findings. *Psychological Bulletin*, 262–274.
- Schmidt, F. L., Hunter, J. E., & Outerbridge, A. N. (1986). Impact of job experience and ability on job knowledge, work sample performance, and supervisory ratings of job performance. *Journal of Applied Psychology*, 71(3), 432–439. <https://doi.org/10.1037/0021-9010.71.3.432>
- Schultz, T. W. (1961). Investment in Human Capital. *The American Economic Review*, 51(1), 1–17.

-
- Seber, G. A. F., & Lee, A. J. (2012). *Linear Regression Analysis*. John Wiley & Sons.
 - Tessema, A. D. (2014). The impact of human capital on company performance case of the footwear sector in Ethiopia. *Journal of Business and Administrative Studies*, 6(2), 76-103–103.
 - Vanhala, S., Kaarelson, T., & Alas, R. (2006). Converging human resource management: A comparison between Estonian and Finnish HRM. *Baltic Journal of Management*, 1, 82–101. <https://doi.org/10.1108/17465260610640895>

ÇFARË LIDHJE KA NDËRMJET NUMRIT TË POPULLSISË LOKALE DHE PUNËSIMIT?

Mario Çurçija ¹

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti i Administrim-Biznesit

Abstrakt

Në këtë punim do të mundohemi të trajtojmë lidhjen ndërmjet rritjes së popullsisë urbane dhe çështjes së punësimit. Fenomeni i migrimit të brendshëm rendit ndër arsytet e ndryshme atë të mundësisë për gjetjen e një vendi pune si dhe të një pagese më të mirë. Shpopullimi i disa zonave dhe përqendrimi në disa të tjera sjell nisjen e një cikli, i cili ndikon reciprokisht palët e përfshira, pasi ekziston një lidhje e ndërsjellë ndërmjet madhësisë së tregut, pra madhësisë së qyteteve dhe punësimit. Duke qenë të ndërgjegjshëm për kompleksitetin e çështjes, dhe duke e thjeshtuar atë në vetëm dy faktorë, mund të themi që në këtë punim, kemi gjetur një ndërvarësi pozitive ndërmjet rritjes së numrit të popullsisë urbane dhe punësimit si dhe, që, më të favorizuarit janë ata me arsim të lartë trevjeçar dhe të mesëm të përgjithshëm.

What relationship is there between the dimensions of the urban population and employment?

Abstract

In this paper we try to address the relationship between the size of the urban population and employment. The phenomenon of internal

¹ Që prej vitit 2009 jam përfshirë në mësimdhënie dhe kërkim si pedagog i Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

Formimi im akademik është në fushën e menaxhimit dhe cikleve të prodhimit, për të cilën kam mbrojtur edhe PhD në Universitetin e Romës "La Sapienza", Fakulteti i Ekonomisë. Fushat e mia të kërkimit përfshijnë, por nuk kufizohen, në përcaktimin e rolit, organizimin dhe kontributin e burimeve njerëzore në vlerën shtuar të produkteve dhe shërbimeve. Në programin Bachelor jap leksione në lëndën Manaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe në programin Master Profesional jap lëndën Sjellje Organizative.

migration ranks among various reasons the possibility of finding a job as well as a better pay. Depopulation of some areas and concentration in others sets the start of a cycle that mutually affects the parties involved, as there is a reciprocal causation between market size, i.e. city size, and employment. Being aware of the complexity of the issue, and simplifying it to only two factors, we can summarize that in this paper we have found a positive interdependence between the growth of urban population and employment and that the most favored individuals are those who hold a bachelor degree and a general secondary education.

Fjalët kryesore (kyçe): popullsia, punësimi, demografia, arsimimi.

Qëllimi i punimit

Çështja e rënies demografike është një problem shqetësues për qëndrueshmërinë e çdo vendi për disa arsye të cilat mund t'i përmbledhim, por jo mjaftueshëm për shkak të gjerësisë së tematikës, si më poshtë:

Shpopullimi vë në rrezik dhe pikëpyetje qëndrueshmërinë e shtetit social meqenëse përgjithësisht ulja e popullsisë përkthehet në rritje të moshës mesatare, vjetërim, çka nënkupton rritje të shpenzimeve publike për pensione dhe shëndetësi.

Shpopullimi shoqërohet me frenim të rritjes ekonomike, sepse ai theksohet në largimin e të rinjve të cilët potencialisht janë udhëheqës politikë lokalë, themelues dhe drejtues të bizneseve të reja. (Headey & Hodge, 2009) (Maestas, Mullen, & Powell, 2016).

Shpopullimi është në qendrën e një cikli vicioz të rënies ekonomike, meqenëse papunësia e lartë krahas problemeve sociale, sigurisë dhe kriminalitetit është një faktor përcaktues për largimin e të rinjve dhe njerëzve të aftë, gjë e cila varfëron akoma më tej tregun lokal të punës, i cili kështu gjendet brenda një spiraleje rënëse (Šerý, Svobodová, Šilhan, & Szczyrba, 2017).

Pyetjet që shtron ky punim janë: “A ekziston një lidhje shkakësore ndërmjet dimensioneve të qyteteve të matur nga numri i popullsisë urbane dhe shanseve për punë në Shqipëri?” “Nëse ekziston, mbi çfarë tipologjie personash, referuar nivelit arsimor, kanë impakt më të madh dimensionet e qytetit?”

Rishikim i literaturës akademike

Tkurrja e popullsisë nga disa zona si rezultat i deindustrializimit është një fenomen i njohur në vendet e Evropës Perëndimore dhe SHBA.

Për sa u përket vendeve të Evropës Lindore postkomuniste, pjesë e së cilës është edhe Shqipëria, përmasat e shpopullimit kanë dimensione akoma më të mëdha. Në përgjithësi të gjitha vendet e Evropës Lindore postkomuniste janë përballur me problemin e tkurrjes së popullsisë të disa zonave dhe urbanizimit të disa të tjerave (Turok & Mykhnenko, 2007) (Haase, Grossmann, & Rink, 2016).

Zhvillimi i qyteteve në vendet në tranzicion është një proces kompleks dhe vështirësisht i përmbledhshëm në një model unifikues. Qendrat metropolitane dhe zonat perëndimore të shteteve evropiano-lindore në kufi me vendet e Bashkimit Evropian kanë arritur t'i përshtaten më shpejt kushteve të reja ekonomike (Petraçkos, 2001).

Në rastin e Shqipërisë, tkurrja e disa zonave dhe prosperiteti i disa të tjerave lidhet me disa faktorë të cilat mund të përmbledhen në tri kategori: faktorë politikë, faktorë ekonomikë, faktorë socialë, megjithëse ndarja mes tyre nuk është e prerë, sepse shpesh faktorët ekonomikë përcaktojnë fatin e iniciativave politike dhe anasjelltas.

Faktorë politikë: rënia e kufizimit të lëvizjes së lirë pas '90. Sipas idealit komunist, planifikimi i centralizuar i çdo gjëje përfshinte planifikimin e zhvillimit urban, rural, lëvizjen e lirë, të drejtën e punësimit. Ideali ishte egalitarizmi, që përkthehej si barazim i detyruar i cilësisë së jetës në të gjitha zonat. Planifikimi i kontrolluar i rritjes së qyteteve bëri që në periudhën 1945 – 1989 rritja e popullsisë e qyteteve kryesore, si: Tirana, Durrësi, Shkodra dhe Vlora, të ishte sa gjysma e rritjes së popullsisë së vendit (Kopliku, 2016). Kjo situatë që mbante 70% të popullsisë të bllokuar në zonat rurale ishte potencialisht shpërthyes, çka u verifikua pas rënies së komunizmit dhe heqjes së kufizimeve të lëvizjes së lirë, i cili shënjoji nisjen e një procesi të gjatë të tkurrjes së popullsisë nga zonat rurale.

Ndër faktorët ekonomikë që shkaktuan lëvizjet e popullsisë përmendim reduktimin e rolit të shtetit në ekonomi, mbylljen e ndërmarrjeve publike dhe industrive shtetërore, tkurrjen e administratës shtetërore dhe supremimin e vendeve të punës. Rritja e papunësisë është një nga arsyet e emigrimit të madh post 1990, 1 milion emigrantë nga një vend që mesatarisht ka 3 milionë banorë (Instat, 2018), si dhe të migrimit masiv të brendshëm nga zonat e brendshme drejt qendrave urbane perëndimore (Instat, 2014)

Faktorë të natyrës sociale: tkurrja e rolit të shtetit në ekonomi solli reduktim të shërbimeve publike dhe tërheqje të rolit publik në zona të caktuara (malore, rurale) nga shërbime të transportit publik, arsim, shëndetësi, asistencë sociale. Reduktimi i disa shërbimeve publike sjell përkeqësim të cilësisë së jetës për popullsinë e cila në kërkim të kushteve

më të mira vendos të largohet, por për pastaj vetvetiu ky reduktim i popullsisë nuk justifikon praninë e disa shërbimeve publike të tjera, të cilat reduktohen akoma më shumë duke ngecur sistemin në një lloj rrethi vicioz (Myrdal, 1957).

Lidhja e reciproke: madhësia e tregut dhe zhvillimi ekonomik

Reciprociteti ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe përmasave të qytetit përmendet që në fillimet e shkencës ekonomike nga Adam Smith atëherë kur flet mbi specializimin e zanateve dhe produktivitetin (Smith, (1776) 2000). Nga njëra anë një treg i madh është kusht i nevojshëm për lindjen dhe specializimin në një profesion të caktuar, sepse përndryshe specializimi nuk do të ishte ekonomikisht i leverdisshëm. Nga ana tjetër, zhvillimi i kompetencave dhe specializimit, sjell rritje të produktivitetit dhe është faktor determinues i zhvillimit ekonomik, çka do të thotë treg pune më dinamik dhe atraktivitet më i lartë për punonjësit potencialë që banojnë jashtë tij.

Sipas teorisë neoklasike, madhësia e tregut nxit përqendrimin e ndërmarrjeve si rrjedhojë e lehtësisë në komunikim dhe transport, rrjedhjes së informacioneve dhe njohurive – i ashtuquajtur *spillover effect* – afërsi me furnitorët, treg të gjerë pune dhe disponibilitet të punonjësve të kualifikuar (Marshall, 1890). Madhësia e tregut nxit përqendrimin, por gjithashtu ndërmarrjet janë vetë konsumatore të produkteve të ndërmjetme dhe shërbimeve, çka sjell që tregu të jetë më i madh aty ku ka ndërmarrje. Ky parim i ndërlidhjes dhe ndërvarësisë së faktorëve: kërkesë, fuqi blerëse dhe të ardhura, investim dhe prodhim, sjell një lidhje shkakësore të ndërsjellë, e cila përfshin fushën e marrëdhënieve sociale dhe ka ndikim në shoqëri në përgjithësi. (Myrdal, 1957). Prodhimi ka prirjen të përqendrohet aty ku ka një treg të gjerë, por nga ana tjetër, sipas një përshkrimi keynesian të efekteve multiplikativ, tregu do të jetë i gjerë aty ku ndërmarrjet prodhuese do të përqendrohen (Hirschman, 1958) (Arthur, 1989). Një treg i madh nënkupton produktivitet më të lartë dhe specializim më të lartë dhe si pasojë personat me njohuri, arsim më të lartë, profesionalitet të kualifikuar, pra kapital njerëzor i lartë, kanë mundësi më të mira për punë dhe të ardhura më të larta (Schultz, 1961) (Becker, 1994).

Testimi i teorisë

Ky punim synon studimin e ekzistencës së lidhjes ndërmjet rritjes së popullsisë në një zonë dhe mundësive për punësim. Nisur nga konsideratat në paragrafin paraardhës që zonat metropolitane, për shkak të dimensionit të tregut dhe hapjes më të madhe ndaj ndërkombëtarizimit, janë më të ndjeshme ndaj hapjes së bizneseve të reja, atëherë do të kemi që me rritjen e numrit të popullsisë në atë zonë, mundësitë për punësim do të jenë më të

larta; në veçanti rritja e popullsisë urbane shoqërohet me rritjen e nivelit arsimor të të punësuarve.

H1: Rritja e numrit të popullsisë urbane shoqërohet me rritje të mundësive për gjetjen e një pune.

H2: Rritja e popullsisë urbanë ka efekt pozitiv me të lartë në punësimin e njerëzve me nivel arsimor të lartë.

Baza e të dhënave dhe metodologjia

Për të matur popullsinë urbane në kohë si variabël e vazhduar është përdorur popullsia e qarkut. Qarku është një njësi administrative që përfshin një bashki kryesore – qyteti kryesor që i jep emër qarkut – dhe disa bashki të cilat paraqesin nivelin e dytë të ndarjes administrative shtetërore; Shqipëria është e ndarë në 12 qarqe (Kuvendi i Shqipërisë, 2014). Të dhënat demografike janë marrë prej raportimeve të popullsisë të INSTAT për periudhën 2007 – 2013.

Për sa u përket të dhënave mbi punësimin, përdorim një bazë të dhënash në kohë të disponueshme prej INSTAT – Labour Survey Force për periudhën 2007 – 2013. Anketat e punës përfshijnë informacione mbi vendbanimin, moshën, gjininë, statusin i punësuar, sektorin e aktivitetit, arsimin etj.

Për të testuar hipotezën e parë përdorim modelin probit i cili është një formë regresioni jolinear ku variabli i varur Y, mund të marrë vetëm dy vlera p.sh., 1 dhe 0 (variabël binare), ndërsa regresoret apo variablat e pavarur mund të marrin çfarëdo vlere. Në këtë rast kemi thjeshtuar funksionin e regresionit në formen $Y_{it} = \alpha + \beta X_{it} + \varepsilon$.

Y_{it} shprehet në një nga gjendjet $\in (1;0)$ ku 1 = “I Punësuar” dhe 0 = “I Papunë/Inaktiv”.

i – qarku ku banon i anketuari (Qarku i Beratit, i Dibrës, i Durrësit, i Elbasanit, i Fierit, i Gjirokastrës, i Korçës, i Kukësit, i Lezhës, i Shkodrës, i Tiranës, i Vlorës)

t – viti i anketimit (periudha 2007 – 2013).

Në lidhje me variablën e varur Y_{it} , vlera 0 = “I Papunë/Inaktiv” përfshin të dy gjendjet e mundshme “I Papunë” dhe “Inaktiv” për shkak të pikëpyetjeve që jo vetëm autori i këtij punimi, por edhe literatura akademike (Blanchard, Amighini, & Giavazzi, 2013) ushqen mbi besueshmërinë e statistikave në vendet e pazhvilluara mbi dallimin “Të Papunë” dhe “Inaktiv”. Objekt interesi është gjendja 1 = “I Punësuar”, megjithëse edhe kjo mund të jetë e diskutueshme, pasi në vendet e pazhvilluara dominon punësimi në sektorin primar – bujqësi, blegtori.

Konkretisht në Shqipëri në tremujorin e dytë të 2019, 40% e të punësuarve janë në sektorin e bujqësisë (INSTAT, 2019), çka ngre pikëpyetje mbi vlerën e të dhënave dhe mbi cilësinë e punësimit të pjesshëm në sektorin e bujqësisë.

X_{it} shpreh popullsinë e qarkut në mijëra (Qarku i Beratit, i Dibrës, i Durrësit, i Elbasanit, i Fierit, i Gjirokastrës, i Korçës, i Kukësit, i Lezhës, i Shkodrës, i Tiranës, i Vlorës) në vitin t (periudha 2007 – 2013).

Në lidhje me variablën e pavarur X_{it} , për arsye disponibiliteti të të dhënave demografike, është përdorur popullsia, sipas qarqeve gjatë periudhës 2007 - 2013. Në Shqipëri qarqet janë 12 dhe qendra e gravitetit ekonomik dhe demografik e qarkut është bashkia kryesore. Të anketuarit deklarojnë si vendbanim rrethin – Shqipëria përpara reformës administrative të 2014 numëronte 36 të tillë, por për nevoja të analizës të këtij punimi, të anketuarit janë grupuar në qarqet përkatëse; që do të thotë p.sh., që një i anketuar në vitin 2010, i cili deklaroi si vendbanim një nga rrethet Kuçovë apo Skrapar, është kategorizuar si banues në qarkun Berat, megjithëse ky qark si i tillë është themeluar në 2014.

Për të testuar hipotezën e dytë përdorim modelin multinomial logit, një regresion ndërmjet një variabli të varur nominal dhe një variabli të pavarur gjithnjë sipas formës $Y_{it} = \alpha + \beta X_{it} + \varepsilon$.

Variabli i varur “I punësuarit sipas nivelit arsimor” - Y_{it} - është një variabël sipas 9 kategorive të mundshme ku respektivisht kategoritë janë: 1 = I Punësuar Pa Shkollë, 2 = I Punësuar me Shkollë Filllore, 3 = I Punësuar me Shkollë 8/9 vjeçare, 4 = I Punësuar me Shkollë të Mesme Profesionale 2/3 vite, 5 = I Punësuar me Shkollë të Mesme Profesionale 4/5 vite, 6 = I Punësuar me Shkollë të Mesme të Përgjithshme, 7 = I Punësuar me Diplome Bachelor/Universitet 3 vite, 8 = I Punësuar me Diplomë Master/Universitet, 9 = I Punësuar me Doktoraturë.

Ndërsa:

i – qarku ku banon i anketuari (Qarku i Beratit, i Dibrës, i Durrësit, i Elbasanit, i Fierit, i Gjirokastrës, i Korçës, i Kukësit, i Lezhës, i Shkodrës, i Tiranës, i Vlorës)

t – viti i anketimit (periudha 2007 – 2013).

X_{it} shpreh popullsinë e qarkut në mijëra (Qarku i Beratit, i Dibrës, i Durrësit, i Elbasanit, i Fierit, i Gjirokastrës, i Korçës, i Kukësit, i Lezhës, i Shkodrës, i Tiranës, i Vlorës) në vitin t (periudha 2007 – 2013).

Kufizime

Ndër kufizimet e këtij testimi përmendim periudhën e shkurtër kohore, cilësinë e të dhënave bazë, shtrembërimin e pakorrigjueshëm në lidhje me

vendbanimin e deklaruar dhe vendbanimin e zakonshëm i cili mund të jetë në një qark tjetër.

Gjetjet dhe rezultatet

H1. Në lidhje me hipotezën e parë, testi probit mbi 67693 observime, i cili lidh variablin e varur Y_{it} me variablin e pavarur X_{it} popullsinë e qarkut gjatë periudhës së anketimit, nuk tregon të ketë një lidhje domethënëse, koeficienti i regresionit është negativ -0.00034. Probabiliteti që një person të jetë i punësuar nuk rritet me rritjen e numrit të popullsisë urbane të qarkut ku jeton ref.

Table 1.

Përgjigjet e parashikuara korrektësisht nga modeli janë vetëm 51% ndërkohë që vetë probabiliteti i thjeshtë “I punësuar” është 50%. Modeli nuk ka aftësi parashikuese.

Nëse nga baza e të dhënave përjashtojmë të punësuarit në sektorin e bujqësisë, i cili sipas matjes të LFS angazhon pothuajse 50% të të punësuarve, bazuar në rregullin e pranuar që një person i cili mund të ketë punuar qoftë edhe një ditë të vetme kundrejt një shpërblimi gjatë javës së fundit të anketës së punës, atëherë rezultatet e testit probit ndryshojnë. Rezultati i testit probit pohon një lidhje pozitive ndërmjet rritjes së mundësive të punësimit dhe madhësisë së popullsisë urbane me korrektësi parashikimi 67% ref.

Table 2. Në këtë rast, efekti marzhinal mesatar i rritjes së popullsisë urbane me 1000 njësi mbi rritjen e probabilitetit të gjendjes “I punësuar” në një sektor të ndryshëm nga bujqësia është 0.02% ref. Table 3.

H2. Testi multinomial logit mbi 32524 observime merr si kategori bazë kategorinë më të shumtë në numër e cila në këtë rast përfaqësohet nga të punësuarit me nivel arsimi 8/9 vjeçar. Ky test pohon me besueshmëri $> 99\%$, që rritja e popullsisë së qarkut ndikon mbi rënien e probabilitetit të punësimit të personave me arsim 8/9- vjeçar ndërsa rrit probabilitetin e punësimit të personave me arsim me të lartë se kategoria bazë – arsimi 8/9 vjeçar – ref. Table 4. Efekti marzhinal i rritjes me 1000 njësi të popullsisë urbane është më i lartë për tri nivele arsimi në veçanti Y: 7=Bachelor/Universitet 3 vite, 6=Mesme Përgjithshme dhe 5=Mesme profesionale 4/5 vite, ndërsa ka efekt negativ marzhinal -0.05% mbi të punësuarit me nivel arsimor 8/9- vjeçar ref.

Table 5

Marginal effects aftër mlogit								
Edu_Level	variable	dy/dx	Std. Err.	z	P>z	[95%	C.I.]	X
Tertiary/University	Urban~_k	0.000182	0.00001	23.72	0	0.000167	0.000197	180.995
Upper Secondary general	Urban~_k	0.0001793	0.00001	14.08	0	0.000154	0.000204	180.995
Upper secondary vocational 4/5 year	Urban~_k	0.0000563	0.00001	4.96	0	0.000034	0.000079	180.995
Doctorate	Urban~_k	0.0000411	0	11.32	0	0.000034	0.000048	180.995
Upper secondary vocational 2/3 year	Urban~_k	0.000021	0.00001	3.87	0	0.00001	0.000032	180.995
Post Univ./Master	Urban~_k	5.98E-06	0	4.94	0	3.60E-06	8.30E-06	180.995
No School	Urban~_k	-7.81E-06	0	-2.28	0.023	-1.5E-05	-1.10E-06	180.995
Primary	Urban~_k	0.0000187	0.00001	-2.42	0.016	-3.4E-05	-3.50E-06	180.995
8/9-years school	Urban~_k	0.0004592	0.00002	25.69	0	-0.00049	-0.00042	180.995

Diskutime

Në interpretimin e rezultateve duhet të konsiderojmë faktin që njerëzit zhvendosen drejt zonave ku mundësitë e punësimit janë më të larta, prandaj edhe diferenca në probabilitet punësimi mes qarkut me popullsi të ulët – Kukësi dhe atij me popullsi të lartë – Tiranë – është një fotografi e çastit dhe nuk shpjegon dinamikën e tregut të punës. Kështu të papunët e Kukësit duke parë më tepër mundësi punësimi do të jenë të prirur të migrojnë drejt Tiranës. Por për efekt analize statistikore, tashmë ky person i larguar nga Kukësi ul numrin e të papunëve në Kukës, meqenëse nuk banon më aty, dhe rrit numrin e të papunëve në Tiranë, të paktën për periudhën kur ai nuk ka gjetur akoma një punë. Për këtë arsye, themi që në një shikim të parë dallimi në probabilitet punësimi ndërmjet Kukësit dhe Tiranës është 10% në kushtet e një mobiliteti të forcave të punës, ndërsa për hipotezë absurde, nëse tregu i punës do të ishte i ngurtë, pra lëvizja e lirë e të papunëve të ndalohej, numri i të papunëve në Kukës do të ishte më i lartë dhe në Tiranë më i ulët, prandaj diferenca në probabilitet për punësim do të ishte më e lartë se sa 10%. Por këtu do të lindë pikëpyetja: “A do të ishte e zhvilluar Tirana kaq shumë sa ç’është sot nëse lëvizja e lirë do të ndalohej?” Në qoftë se lëvizja e lirë do të ndalohej, popullsia e Tiranës nuk do të ishte aq sa ç’është sot dhe për rrjedhojë - “circular causation” - lidhja shkakësore e anasjellë treg i madh \Leftrightarrow punësim nuk do të konkretizohej. Për rrjedhojë

në Shqipëri zhvillimi ekonomik i qendrave me popullsi të lartë nuk do të verifikohet, të paktën jo në formën aktuale, pasi do të mungonte kushti themelor domethënë madhësia e tregut - në këtë punim i matur nga numri i banorëve të qarkut, i cili bën të mundur lindjen dhe zhvillimin e industrive që punësojnë njerëz. E pranuar që zhvillimi ekonomik tërheq punonjës dhe vë në lëvizje migrimin e brendshëm, mbeten për t'u hulumtuar më tej shkaqet e thella që qëndrojnë pas zhvillimit ekonomik të një zone të caktuar dhe rënies ekonomike të një zone tjetër.

BIBLIOGRAFIA

- Arthur, W. B. (1989). Competing Technologies, Increasing Returns, and Lock-In by Historical Events. *The Economic Journal*, Vol. 99, No. 394 , 116-131.
- Becker, G. (1994). *Human Capital: A Theoretical and Empirical Analysis With Special Reference to Education*. Chicago: The University of Chicago Press.
- Blanchard, O., Amighini, A., & Giavazzi, F. (2013). *Macroeconomics: A European Perspective*. New York: Pearson.
- Haase, A., Grossmann, K., & Rink, D. (2016). Shrinking cities in postsocialist Europe – what can we learn from their analysis for urban theory-making? *Geografiska Annaler: Series B* , 305-319.
- Headey, D., & Hodge, A. (2009). The Effect of Population Growth on Economic Growth: A Meta-Regression Analysis of the Macroeconomic Literature. *Population and Development Review* , 221-248 .
- Hirschman, A. O. (1958). *The Strategy of Economic Development*. New Haven: Yale University Press.
- Instat. (2018). *Diaspora e Shqipërisë në Shifra*. Tirana: Instituti i Statistikave Shqipëri.
- Instat. (2014). *Migracioni në Shqipëri*. Tirana: Instituti i Statistikave Shqipëri.
- INSTAT. (2019). *Punësimi sipas burimeve administrative dhe sektori bujqësor, T2 2016 - T2 2019*. Tiranë: Instat Albania.
- Kopliku, B. (2016). Migrimi i Brendshëm në Rajonin e Shkodrës gjatë viteve 1945 - 1990. *Buletini Shkencor i Universitetit të Shkodrës, Seria Shkencat Shoqërore*.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2014). *Ligji nr. 8653, datë 31.7.2000, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"*. Tiranë: Fletore Zyrtare.
- Maestas, N., Mullen, K., & Powell, D. (2016). The Effect of Population Aging on Economic Growth, the Labor Force and Productivity. *NBER Working Paper No. 22452* .
- Marshall, A. (1890). *Principles of Economics*. London: Macmillan and Co.
- Myrdal, G. (1957). *Economic theory and under-developed regions*. London: Duckworth.
- Petrakos, G. (2001). Patterns of regional inequality in transition economies. *European Planning Studies*, 9 , 359–383.
- Schultz, T. W. (1961). Investment in Human Capital. *The American Economic Review*, 51 (1), 1-17.

- Šerý, O., Svobodová, H., Šilhan, Z., & Szczyrba, Z. (2017). Shrinking of Cities in the Czech Republic and its Reflection on Society: Case Study of Karviná City. *Geographica Pannonica* 22 .
- Smith, A. ((1776) 2000). *The wealth of nations*. New York: Modern Library.
- Turok, I., & Mykhnenko, V. (2007). The trajectories of European cities, 1960-2005. *Cities* Vol. 24, No. 3 , 165-182.

Apendiks

Table 1

Probit regression	Number of obs = 67693
	LR chi2(1) = 143.10
	Prob > chi2 = 0.0000
Log likelihood = -46794.316	Pseudo R2 = 0.0015

WSTATOR	Coef.	Std. Err.	z	P>z	[95% Conf.	Intěrvál]
UrbanPopul_k	-0.00034	0.0000286	-11.95	0	-0.0004	-0.00029
_cons	0.013872	0.007236	1.92	0.055	-0.00031	0.028055

estat classification	
Correctly classified	51.28%

Table 2

Probit regression	Number of obs = 52281
	LR chi2(1) = 247.00
	Prob > chi2 = 0.0000
Log likelihood = -32911.266	Pseudo R2 = 0.0037

WSTATOR	Coef.	Std. Err.	z	P>z	[95% Conf.	Intěrvál]
UrbanPopul_k	0.0005	0.0000317	15.74	0	0.00044	0.000562
_cons	-0.55312	0.008771	-63.06	0	-0.57031	-0.53593

estat classification	
Correctly classified	67%

Table 3

Average marginal effects		Number of obs = 52281			
Model VCE : OIM					
Expression : Pr(WSTATOR), predict()					
dy/dx w.r.t. : UrbanPopul_k					
	dy/dx	Std. Err.	z	P>z	[95% Conf. Intërvall]
UrbanPopul_k	.0001796	.0000113	15.85	0	0.000157 0.000202

Table 4

Multinomial logistic regression		Number of obs = 32524				
		LR chi2(8) = 1077.63				
		Prob > chi2 = 0.0000				
Log likelihood = -48588.327		Pseudo R2 = 0.0110				
Q94_Educat~1		Coef.	Std. Err.	z	P>z	[95% Conf. Intërvall]
No School	UrbanPopul_k	-.0000515	.0004419	-0.12	0.907	-0.00092 0.00081
	_cons	-4.11893	.0928875	-44.34	0	-4.30099 3.93687
Primary	UrbanPopul_k	.0005338	.000177	3.02	0.003	0.000187 0.00088
	_cons	-2.441119	.0398693	-61.23	0	-2.51926 2.36298
8/9-years school	3	(base outcome)				
Upper secondary vocational 2/3 year	UrbanPopul_k	.0016551	.0001989	8.32	0	0.001265 0.00205
	_cons	-3.140265	.0513438	-61.16	0	-3.2409 3.03963
Upper secondary vocational 4/5 year	UrbanPopul_k	.0013615	.0001082	12.59	0	0.00115 0.00157
	_cons	-1.583652	.0261864	-60.48	0	-1.63498 1.53233
Upper Secondary general	UrbanPopul_k	.0018786	.0000918	20.45	0	0.001699 0.00206
	_cons	-1.304354	.0229099	-56.93	0	-1.34926 1.25945
Tertiary/University	UrbanPopul_k	.0031537	.0001136	27.75	0	0.002931 0.00338
	_cons	-2.370719	.0331017	-71.62	0	-2.4356 2.30584
Post Univ./Master	UrbanPopul_k	.0036009	.0005803	6.21	0	0.002464 0.00474
	_cons	-6.051182	.1898843	-31.87	0	-6.42335 5.67902
Doctorate	UrbanPopul_k	.003173	.0002159	14.69	0	0.00275 0.0036
	_cons	-3.870144	.066417	-58.27	0	-4.00032 3.73997

Table 5

Marginal effects after mlogit								
Edu_Level	variable	dy/dx	Std. Err.	z	P>z	[95%	C.I.]	X
Tertiary/University	Urban~_k	0.000182	0.00001	23.72	0	0.000167	0.000197	180.995
Upper Secondary general	Urban~_k	0.0001793	0.00001	14.08	0	0.000154	0.000204	180.995
Upper secondary vocational 4/5 year	Urban~_k	0.0000563	0.00001	4.96	0	0.000034	0.000079	180.995
Doctorate	Urban~_k	0.0000411	0	11.32	0	0.000034	0.000048	180.995
Upper secondary vocational 2/3 year	Urban~_k	0.000021	0.00001	3.87	0	0.00001	0.000032	180.995
Post Univ./Master	Urban~_k	5.98E-06	0	4.94	0	3.60E-06	8.30E-06	180.995
No School	Urban~_k	-7.81E-06	0	-2.28	0.023	-1.5E-05	-1.10E-06	180.995
Primary	Urban~_k	0.0000187	0.00001	-2.42	0.016	-3.4E-05	-3.50E-06	180.995
8/9-years school	Urban~_k	0.0004592	0.00002	25.69	0	-0.00049	-0.00042	180.995

KREDITË ME PROBLEME DHE FAKTORËT MAKROEKONOMIKË

Nevila (Brahimi) Mehmetaj¹, Samina Lici²

¹*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Administrim-Biznesit*

²*Master i Shkencave në Administrim- Biznes, Fakulteti Ekonomik*

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë ndikimin e faktorëve makroekonomikë në nivelin e kredive me probleme. Rritja e nivelit të kredisë me probleme në sistemin bankar ka bërë që shumë hulumtues të përpiqen të analizojnë disa nga faktorët kryesorë që kanë sjellë këtë shtim të nivelit të kredive me probleme shqetësuese për ekonominë e vendit. Ky studim analizon faktorët kryesorë ndikues në nivelin e kredive me probleme në sistemin bankar shqiptar. Metodologjia e studimit konsiston në përdorimin e një modeli të shumëfishtë linear ekonometrik ku norma e kredive me probleme analizohet si ndryshore e varur dhe faktorë të ndryshëm makroekonomikë, si: norma e rritjes ekonomike, norma e interesit të kredisë, norma e papunësisë, norma e inflacionit dhe norma e rritjes së kredive trajtohen si ndryshore të pavarura. Të dhënat e përdorura në model janë të aksesueshme nga Instat, Banka e Shqipërisë etj. Rezultatet tregojnë se norma e rritjes ekonomike të vendit dhe norma e rritjes së

¹ Arsimi: Ph.D. në Ekonomiks në 2014 në Swiss Management Center. Master në Menaxhim Financiar në 2009, Fakulteti i Ekonomisë Tiranë & Universiteti Marco Biagi, 2011, Modena, Reggio Emilia Itali. Bachelor në Administrim Biznes në 2001, Fakulteti Ekonomik, Shkodër.

Eksperiencia në punë: Analiste Finance pranë bankës BBSH Shkodër gjatë periudhës 2001-2009. Lekore e lëndëve Mikroekonomi, Makroekonomi dhe Ekonomiks Manaxherial pranë Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” nga 2009 deri në ditët e sotme.

Mbajtëse e grantit akademik CERGE-EI Foundation Teaching Fellow nga 2015 deri ditët e sotme.

² Master i Shkencave në Administrim- Biznes në 2018; Bachelor në Administrim - Biznes në 2016 pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

vëllimit të kredisë ndikon në uljen e nivelit të kredive me probleme; norma e papunësisë në vend ndikon në rritjen e nivelit me nivelin e kredive me probleme; ndërsa norma e interesit të kredisë dhe norma e inflacionit nuk kanë ndikim në nivelin e kredive me probleme. Studimi mund të shërbejë si material shtesë plotësues për analizën e vendimmarrjeve në sektorin e administratës drejtuese të bankave të nivelit të dytë.

Fjalë kyçe: Kreditë me probleme, norma e rritjes së PBB, normë inflacioni, normë interesi e kredive, normë e papunësisë, norma e rritjes së kredive.

Non Performing Loans and the Macroeconomic Factors

Abstract

The purpose of this study is to define the impact of macroeconomic factors on the level of nonperforming loans. The increasing level of nonperforming loans in the banking system oriented many researchers to analyse some of influencing factors that have brought such increase of nonperforming loans- being an alarm signal for the economy. This study analyses the main macroeconomic factors that influence the increase of nonperforming loans in the Albanian banking system. The methodology consist on the use of the multiple linear econometric model to show the influence of several macroeconomic factors as GDP growth rate, loan interest rate, unemployment rate, inflation rate and credit growth rate as the independent variables; on the level rates of nonperforming loans as the dependent variable. The used data in the model are accessible from INSTAT, Bank of Albania, etc. The results show that the country GDP economic growth rate and the credit growth rate affect the reduction of non-performing loans; the unemployment rate affect the increase of the level of non-performing loans; while the loan interest rate and the inflation rate do not affect the level of non-performing loans. The study may serve as additional supplementary material for analysis of decision making in the management sector of commercial banks.

Key words: Nonperforming loan NPL, GDP growth rate, inflation rate, loan interest rate, unemployment rate, credit growth rate.

1. Hyrje

Sistemi i kreditimit nëpërmjet institucioneve financiare luan një rol të rëndësishëm në ecurinë dhe zhvillimin ekonomik të vendeve. Shqipëria

është karakterizuar nga një bum në aktivitetin kreditues në vitet e fundit. Një nga burimet kryesore të rritjes ekonomike të vendit tonë janë investimet të cilat janë kryesisht të financuara nga kreditimi i bankave. Por fenomeni i kreditimit të ekonomisë mund të shoqërohet me anën negative të tij siç janë kreditë me probleme ose kreditë e këqija (NPL non performing loans). Rritja e nivelit të kredive me probleme si pasojë sjell dobësimin e stabilitetit financiar të sistemit bankar, pasoja rënduese në ciklet e biznesit dhe ngadalësim të ecurisë së performancës ekonomike të vendit (Mwanza, 2011). Nisur nga rëndësia e këtij treguesi financiar bankar, është *qëllimi* i këtij punimi të përcaktojë, nëse kemi ndikim të faktorëve makroekonomikë të vendit tek ecuria e NPL, dhe nëse po, të vlerësojë nga pikëpamja sasimore masat e secilit prej këtyre ndikimeve.

Nisur nga rëndësia e nivelit të kredive me probleme në ekonominë e vendit, është pikërisht qëllimi i këtij studimi analiza e disa faktorëve përcaktues që ndikojnë në rritjen e NPL. Kjo për arsyen e rëndësisë së këtij treguesi me ndikim në ecurinë e stabilitetit financiar dhe të rritjes ekonomike të vendit. Sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë, kreditë me probleme janë në 13.2% të totalit të kredive të sistemit bankar, e thënë ndryshe vlera monetare e kredisë që nuk kthehet rezulton 72 miliardë lekë (BSH, 2017).

Literatura mbi studimin e faktorëve ndikues tek NPL është mjaft e gjerë. Studime empirike kanë prezantuar se kushte të favorshme makroekonomike, si: rritja ekonomike, norma të ulëta papunësie dhe inflacioni, kanë tendencë të shoqërohen me cilësi të mirë të aktivitetit kreditues. Pikërisht edhe ky studim u përmbahet kornizave të mëparshme kërkimore të kësaj fushe, por me fokus analizat e të dhënave makroekonomike të vendit tonë. Të dhënat zyrtare të vendit të aksesueshme në raportet tremujore të Bankës së Shqipërisë dhe Instat të periudhës 2008-2018 përdoren në një model linear regresioni me variabla të shumëfishtë. Modeli bazohet në metodën e katrorëve më të vegjël OLS duke u mbështetur më parë nga rezultatet e analizës së multikolinearitetit dhe heteroskedasticitetit. Rezultatet tregojnë se norma e rritjes ekonomike të vendit dhe norma e rritjes së vëllimit të kredisë ndikon në uljen e nivelit të kredive me probleme; norma e papunësisë në vend ndikon në rritjen e nivelit me nivelin e kredive me probleme; ndërsa norma e interesit të kredisë dhe norma e inflacionit nuk kanë ndikim në nivelin e kredive me probleme.

Pjesa në vazhdimësi organizohet si vijon. Seksioni dy paraqet një përmbledhje të literaturës së terminologjisë së kategorive të kredive dhe literaturës përmbledhëse empirike të fushës. Seksioni tre paraqet disa fakte

të ecurisë së të dhënave agregate të vendit tonë ndër vite. Seksionet katër dhe pesë paraqesin metodologjinë dhe rezultatet e modelit të aplikuar; duke vazhduar me konkluzionet dhe kufizimet e studimit.

Pyetjet kërkimore

Të këtij punimi janë:

Ha1: Ka lidhje të rëndësishme midis normës së rritjes ekonomike të vendit dhe normës së kredive me probleme.

Ha2: Ka lidhje të rëndësishme midis normës së inflacionit dhe normës së kredive me probleme.

Ha3: Ka lidhje të rëndësishme midis normës së papunësisë dhe normës së kredive me probleme.

Ha4: Ka lidhje të rëndësishme midis normës së interesit të kredive dhe normës së kredive me probleme.

Ha5: Ka lidhje të rëndësishme midis normës së rritjes së nivelit të kredisë në vend dhe normës së kredive me probleme.

2. Literatura e terminologjisë së klasifikimit të kredive

Në bazë të rregullores “Për administrimin e riskut të kredisë” dhe të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 57, 58, 61 dhe 68 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" klasifikimi i kredive për bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ ose financiare në Republikën e Shqipërisë, do të bëhet të paktën një herë në tre muaj në një prej kategorive të mëposhtme bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë dhe në gjendjen financiare të kredimarrësit.

- *Kredi standarde*, quhen kreditë e rregullta dhe që nuk kanë asnjë problematikë në afatin dhe shumën e shlyerjes.
- *Kredi në ndjekje*, quhen kreditë që paraqesin shenjat e para të vonesave në shlyerje dhe janë nën mbikëqyrje nga ana e bankës, por që nuk janë klasifikuar ende si kredi problematike.
- *Kredi nënstandarde*, quhen kreditë të cilat nuk klasifikohen si kredi standarde, për shkak të vonesave në shlyerjen e tyre dhe klasifikohen si kredi problematike.
- *Kredi të dyshimta*, quhen kreditë të cilat kanë vonesa të theksuara në shlyerjen e tyre, por banka ka akoma shpresë në mbledhjen e tyre dhe klasifikohen si kredi problematike.

Zëri i fundit i këtij klasifikimi i referohet kredive me probleme NPL. Një studim i realizuar nga Beck, Jakubik dhe Piloui (2013) tregon që një rënie në ekonominë e vendit është risku më i madh për cilësinë e aseteve të

bankave. Në të njëjtën kohë cilësia e asetëve në vende me natyrë specifike mund të ndikohen negativisht nga faktorë si kursi i këmbimit si dhe çmimi i aksioneve, por nga ky i fundit vendi ynë është i mbrojtur, mbasi nuk funksionon bursa e letrave me vlerë.

2.1. Literatura e studimeve empirike

Autorë të vendeve të ndryshme kanë analizuar dhe prezantuar tregues të rëndësishëm makroekonomikë dhe financiarë që kanë ndikim tek cilësia e nivelit të kredive bankare. Në nivel ndërkombëtar janë kryer disa studime për të analizuar cilësinë e kredisë së bankave, midis tyre: Keeton dhe Morris (1987) për SH.B.A.; Makri et al. (2014) për vendet e eurozonës; Klein (2013) për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore vende; Škarica (2014) për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore; Messai dhe Jouini (2013) për Itali, Greqi dhe Spanja; Agalliu (2014) për Shqipërinë.

Studime të tjera mbi faktorët ndikues tek NPL janë realizuar ndër vite duke prezantuar faktorë të ndryshëm dhe mostra të ndryshme të dhënash. Keeton dhe Morris (1987), në një nga studimet më të hershme empirike të fushës prezantuan ndryshimet midis kushteve ekonomike të lokaliteteve të ndryshme dhe performancës së aktivitetit kreditues bankar. Studimi i tyre bazuar në një kampion prej 2.500 bankash në SHBA, tregoi se pesha të konsiderueshme të humbjeve të kredisë vinin si pasojë e ndryshimeve të kushteve ekonomike ndërmjet rajoneve të ndryshme. Për të konkretizuar në mënyrë sasiore këto ndikime tek performanca e kredive të sistemit bankar, u prezantuan metoda të ndryshme regresioni rreth modelimit të riskut bankar (Chowdhury, Adhikary 2002).

Bofondi dhe Ropele (2011) prezantuan ndikimin e variablave kryesorë makroekonomikë, si: PBB, papunësia, inflacioni; dhe tregues financiar bankar në lidhje me familjet dhe firmat në vitet 1990-2010. Autorët konkludojnë se në nivel kombëtar, zhvillimi i rrezikut të kredisë është në përputhje me luhatjet e variablave makroekonomikë të vendit.

Dimitros dhe Vasilios (2011) prezantuan disa metoda regresioni me të dhëna mikro dhe makroekonomike me ndikim në nivelin e kredive me probleme të konsumatorëve dhe firmave në Greqi. Rezultate të ngjashme u prezantuan në punimin e realizuar nga Lunga dhe Lazea (2012), ku u tregua që niveli i NPL-ve varet nga disa parametra makroekonomikë si rritja e normës së papunësisë, zhvlerësimi i kursit të këmbimit të valutës së vendit dhe rritja e inflacionit. Sipas Andres dhe Bonilla (2012) variablat më të rëndësishëm makroekonomikë janë papunësia dhe GDP, të cilët janë përcaktuesit kryesorë të NPL-ve. De Bock dhe Demyanets (2012), përmes modeleve OLS, vlerësuan ndjeshmërinë e cilësisë së kredisë bankare ndaj tronditjeve të krizës financiare gjatë periudhës 1996-2010.

Messai dhe Jouini (2013) prezantuan studimin e tyre mbi NPL bazuar në analizën e të dhënave të 85 bankave të tri vendeve Italia, Greqia dhe Spanja për periudhën 2004-2008. Pas aplikimit të modelit me të dhënat panel, prezantuan se NPL-të janë të lidhura negativisht GDP, dhe pozitivisht me normën e papunësisë, normën e interesit dhe vëllimin e kredive. Skarica (2013) në një analizë panel mbi vendet e Evropës qendrore dhe lindore ka arritur në përfundimin se ecuria e GDP-së është nxitësi kryesor i NPL-ve dhe nga ana tjetër niveli i lartë i NPL-ve është rezultat i krizave dhe cikleve të biznesit.


Agalliu (2014) prezantoi dy aspekte të ndikimit tek kreditë me probleme: nga dy faktorë makroekonomikë si PBB dhe indeksi i çmimit konsumator ICK (PBB lidhje të zhdrejtë, ICK lidhje të drejtë); nga dy tregues financiar bankar si: raporti i kredive ndaj asetëve K/TA dhe kthimi nga asetet ROA.

2. Ecuria e disa prej faktorëve makroekonomikë në Shqipëri

Kriza financiare globale 2008-2009 ka ndikuar në vitet pasuese edhe në ekonominë e vendit tonë. Ndikimi ka qenë negativ në uljen e të ardhurave të bizneseve në Shqipëri dhe gjithashtu në shtimin e problemeve me likuiditetin. Kjo ka pasur një efekt zinxhir në vendin tonë duke sjellë rritje të papunësisë e cila bën që individët të kenë vështirësi në pagimin e kredive dhe për pasojë kemi rritje të kredive me probleme.

Aktiviteti i kredidhënies ka pasur rritje të konsiderueshme në periudha të ndryshme. Në tabelën e mëposhtme, është paraqitur rritja e kredisë për periudhën 2003-2017. Siç mund të vihet re, niveli i kredisë në sistemin bankar ka ardhur në rritje.

Grafiku 1. Ritmet vjetore të rritjes së kredisë 2003-2018.




Burimi: Banka e Shqipërisë (2018).

Tabela 1. Ecuria e normave vjetore të kredive me probleme (në % ndaj totalit 2008-2018).

Rritja vjetore e kredisë	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Në %	6.7	9.4	14.1	18.7	23.7	24.8%	24.1	17.2	17.4	13.2	11.1

Burimi : Banka e Shqipërisë (2018).

Periodha 2008-2013 përkon me një situatë me rritje të kredive me probleme në vend. Në periudhën në vazhdimësi shohim që niveli i kredive me probleme ka pësuar një rënie të vazhdueshme deri në vitin 2018. Pavarësisht mendimit që kriza financiare globale nuk e ka prekur vendin tonë rritja e nivelit të kredive me probleme tregon që as vendi ynë nuk i ka shpëtuar krizës. Këtë fakt e pasqyrojnë dhe kushtet makroekonomike ku ritmi i rritjes ekonomike ka qenë shumë më i ulët se në periudhën e mëparshme (Grafiku 5) nga ana tjetër dhe niveli i kreditimit ka rënë dukshëm. Nga viti 2015 e deri në 2017 vëmë re një nivel më të ulët të kredive të këqija në krahasim me periudhën më përpara, kjo si pasojë e rritjes së nivelit dhe stabilitetit ekonomik. Normat e interesit ndikojnë në vështirësinë e shlyerjes së borxhit, rritja e barrës së borxhit e shkaktuar nga rritja e normave të interesit të pagesave duhet të çojë në një numër më të lartë të kredive me probleme ose të këqija.


Grafiku 2. Norma e interesit të kredive në Lek (2007-2016).

Burimi: Banka Shqipërisë (2017).

Nga grafiku vëmë re se në periudhën 2005-2011, nuk ka një luhatje shumë të madhe të normave të interesit të kredive, me përjashtim të vitit 2007 që kemi një rritje nga 12,94% në 14,1% në vitin 2006. Nga viti 2011 deri në vitin 2015 kemi një rënie të ndjeshme të normave të interesit të kredive deri në 8,73% në vitin 2015, ndjekur nga një rritje në fund të vitit 2016.

Inflacioni një tjetër tregues me ndikim në sistemin bankar paraqitet me luhatje përgjatë viteve.

Grafiku 3. Luhatjet e normës së inflacionit (2005-2016).




Burimi: Instat (2017).

Deri në vitin 2007 vihet re një normë inflacioni pak a shumë konstante, ndërsa në vitin 2008 vëmë re se kemi një rritje të menjëhershme të inflacionit, për të vijuar rënien në vitet në vazhdimësi.

Niveli i papunësisë paraqitet në rritje deri në vitin 2016, pastaj ky nivel fillon të bjerë ndjeshëm. Në tremujorin e fundit të vitit 2017 niveli i papunësisë është më i ulët i viteve të fundit.


Grafiku 4. Ecuria e normës së papunësisë (2012-2017).



Burimi: Instat (2018).

Nga grafiku mëposhtëm vëmë re se kemi një rënie të ndjeshme të PBB-së, nga 5,9% në vitin 2007 në 1% në vitin 2013. Pas vitit 2013, PBB filloi të rritej gradualisht dhe në vitin 2016 kishte normën 3,37%.

Grafiku 5: Ecuria e normës së PBB-së (2007-2016).



Burimi: Instat (2017).

3. Metodologjia

Për të vlerësuar ndikimin e faktorëve agregat makroekonomikë tek NPL përdoret modeli i regresionit linear me disa variabla. Metoda e zbatuar është metoda e katrorëve më të vegjël (OLS) sipas të cilës minimizohet shuma e diferencave të rezultatit faktik dhe atyre të vlerësuara të quajtura ndryshe termi i gabimit të modelit. Në model janë përdorur të dhëna tremujore, seri kohore të variablave të marrë në studim, gjatë periudhës Q3:2008- Q3:2018, pra $n=44$. Të dhënat e serive kohore tremujore Q3 janë një formë e përshtatshme në analizat ekonometrike për periudha relativisht të shkurtra ose të mesme kohore. Të dhënat janë të aksesueshme online në raportet tremujore dhe vjetore zyrtare publike të mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë dhe Instat. Modeli ilustron më poshtë:

$$NPL = \beta_0 + \beta_1 NPBB + \beta_2 NI + \beta_3 NP + \beta_4 NIK + \beta_5 RNK + \mu$$

NPL është variabli i varur (Y) dhe shpreh normën e nivelit mesatar të kredive me probleme të të gjitha bankave tregtare të vendit. Variablat e pavarur (X_i) janë norma e rritjes ekonomike, norma e inflacionit, norma e papunësisë, norma e interesit të kredive dhe rritja e nivelit të kredisë në sistemin bankar.

Lista e shkurtimeve të përdorura për treguesit agregat makroekonomik:

NPBB – norma e rritjes ekonomike,
 NI – norma e inflacionit,
 NP – norma e papunësisë,
 NIK – norma mesatare e interesit të kredisë,
 RNK – norma e rritjes së nivelit të kredisë.

Modeli OLS mbështetet nga rezultatet e testit të multikolinearitetit dhe heteroskedasticitetit. Në mënyrë të veçantë varianca e faktorit inflacion (VIF) është përdorur për të verifikuar multikolinearitetin, dhe White test është përdorur për të siguruar që modeli nuk ndikohet nga heteroskedasticiteti. Metoda e vlerësimit është model me koeficient të vlerësuar ‘fikse’, ku termi ‘fikse’ përdoret për të treguar që koeficienti nuk ndryshon në kohë (Greene, 2002).

4. Rezultatet e analizës

Nga analiza e modelit linear të regresionit me shumë variabla, koeficienti i përcaktueshmërisë R^2 , matës i madhësisë së përshtatjes së të dhënave tregon se 91.69% e ndryshimit të normës së NPL shpjegohet nga variablat e mësipërm të përfshirë në model.

Nga tabela më poshtë shohim se modeli është statistiki i rëndësishëm ($F(5,38) = 2.45$, $p\text{-value}=0.0000$), pra modeli i zgjedhur e përshkruan mjaftueshëm mirë lidhjen e variablave të përfshirë në model.

Tabela 3. Rezultatet e modelit OLS.

Variables	Coefficients	t-statistic	Prob.
Constant	-5.438306	-0.44	0.661
NPBB	-2.661552	-6.61	0.000
NI	-3.570366	0.67	0.508
NP	2.248783	2.73	0.010
NIK	1.240067	0.18	0.856
RNK	-3.199423	-2.22	0.033
Number of observations = 44		F-statistic = 68.05	
R-squared = 0.9169		Prob (F-statistic) = 0.0000	
Adjusted R-squared = 0.8407		Akaike info criterion = -5.3236	
S.E. regression = 0.0156		Hannan-Quinn crit. = -5.0168	
Sum squared resid. = 0.00759		Durbin –Watson stat = 1.5679	

Burimi: Llogaritje të Autorit.

Nga rezultatet e tabelës së mësipërme konkludohet se faktorët makroekonomikë, si: NPBB, NP dhe RNK kanë rëndësi statistikore në

modelin e mësipërm (vlera e probabiliteteve të secilit prej tyre është më e vogël se $p=0.05$), domethënë hipotezat H_{a1} , H_{a3} dhe H_{a5} janë statistikisht domethënëse. Ndërsa NI dhe NIK nuk kanë ndikim tek NPL (vlera e probabiliteteve të tyre është më e madhe se $p=0.05$) domethënë hipotezat H_{a2} dhe H_{a4} janë statistikisht jodomethënëse.

Shenja para koeficientëve të vlerësuar tregon lidhjen pozitive ose negative midis variablave. Konkretisht një rritje me 1 përqind të normës së PBB ndikon në uljen e normës së NPL me 2.66 përqind; një rritje me 1 përqind të normës së nivelit të kredive RNK ndikon në uljen e normës së NPL me 3.19 përqind. Një rritje me 1 përqind të normës së papunësisë ndikon në rritjen e normës së NPL me 2.24 përqind.

Studimi i multikolinearitetit midis variablave, një analizë mbështetëse në modelin e regresionit OLS ofrohet përmes faktorit të variancës së inflacionit VIF. Ky tregues siguron një matje të variancës të koeficientëve të vlerësuar të regresionit për shkak të multikolinearitetit. Vlerat e tij, nga tabela më poshtë për të gjithë variablat janë më të vogla se 10, gjë që tregon se nuk kemi probleme të konsiderueshme me multikolinearitetin (James et al., 2017).

Tabela 4. Varianca e Faktorit Inflacion VIF.

Variables	VIF
NPBB	8.88
NI	3.71
NP	4.07
NIK	2.90
RNK	1.09
Mean VIF	4.112

Burimi: Llogaritje të Autorit.

Metoda e regresionit OLS supozon që termi i gabimit ka të njëjtën variancë, ky supozim njihet si kushti i homoskedasticitetit. Për të testuar këtë kusht testi White paraqet rezultatet e mëposhtme.

Tabela 5. Testi White i Heteroskedasticitetit

R^2 e vrojtuar = 14.8954	Prob. i χ^2 = 0.1924
----------------------------	---------------------------

Burimi: Llogaritje të Autorit

Meqë vlera e probabilitetit nga testi White është më e madhe se 0.05, nuk kemi praninë e heteroskedasticitetit.

5. Konkluzione

Analiza e ndikimeve të faktorëve makroekonomikë të variablave të pavarur është zbatuar në model të shumëfishtë regresioni me të dhëna seri kohore tremujore gjatë periudhës 2008-2018. Nga më sipër konkludohet se disa nga faktorët agregat makroekonomikë shfaqin lidhje të zhdrejtë tek niveli i kredive me probleme. Një rritje e normës ekonomike ndikon në uljen e nivelit të kredive me probleme. Ose ndryshe nëse ekonomia përjeton rritje ekonomike, kjo gjendje e mirë e ekonomisë do të ndikojë pozitivisht në cilësinë e kredisë (Babouček dhe Jančar, 2005; Bofondi dhe Ropele, 2011; Nkusu, 2011; Klein, 2013; Messei dhe Jouini, 2013; Škarica, 2014). Po ashtu rritja e normës së aktivitetit kreditues në vend sjell një reduktim të nivelit të kredive me probleme, kjo shpjegohet edhe nga shprehja e rritjes së peshës së emëruesit në formulën e llogaritjes së normës së kredive me probleme ndaj peshës së numëruesit totalit të kredive.

Norma e papunësisë shfaq një lidhje të drejtë me nivelin e kredive me probleme. Një rritje në normën e papunësisë ndikon në rritjen e nivelit të kredive me probleme, kjo shpjeguar me faktin e mungesës së të ardhurave të individit të papunë për shlyerjen e kredisë.

Norma e inflacionit dhe norma e interesit të kredive nga rezultatet e modelit nuk shfaqin ndikim tek niveli i kredive me probleme, rezultat ky në kundërshtim me studime të ngjashme empirike (Bofondi dhe Ropele, 2011; Nkusu, 2011; Klein, 2013; Messei dhe Jouini, 2013; Agalliu 2014). Ky rezultat mund të interpretohet nga mungesa e tregut të maturuar financiar në vendin tonë shoqëruar me mungesë informacioni dhe kulture ekonomike e financiare të kredimarrësve.

6. Kufizimet e punimit

Meqë studimi bazohet kryesisht në të dhëna sasiore, një shtrirje më e gjatë kohore do të ndihmonte në saktësimin e rezultateve të modelit. Njëkohësisht përfshirja e variablave të tjerë shtesë në model përveç faktorëve të mësipërm do të ndihmonte në një analizë më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse.

BIBLIOGRAFIA

- Andres, C., Banilla, O. (2012). "The Profit Structure Relationship in Banking, Tests of Market Power and Efficient Structure Hypotheses". *Journal of Money, Credit and Banking*, 27(2), 404.
- Banka e Shqipërisë. *Raporte Vjetore 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018*. Tirana.
- Banka e Shqipërisë. *Raporte Tremujore 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018*. Tirana.
- Babouček, I., Jančar, M. (2005). Effect of macroeconomic shocks to the quality of the aggregate loan portfolio. Czech National Bank. Working Paper Series 1, 1-62.
- Banka e Shqipërisë. Rregullore " Për bankat në Republikën e Shqipërisë", tërhequr në https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Kuadri_Rregullativ_Mbikeqyres/
- Beck, R., Jakubik, P. & Piloju, A. (2013). "Non-performing loans: What matters in addition to the economic cycle?" *Working Paper Series No. 1515 / February 2013*, pp. 1 – 32
- Bofondi, M., Ropele, T. (2011). Macroeconomic determinants of bad loans: Evidence from Italian banks. Banca d'Italia. Occasional Papers, 89, 14-17.
- Chowdhury, C., Adhikary, A. (2002). "An introduction to credit risk modeling", *Chapman & Hall/CRC Financial Mathematics Series*, (25).
- De Bock, R., Demyanets, A. (2012). Bank Asset Quality in Emerging Markets: Determinants and Spillovers. IMF Working paper, 12(71), 1-26.
- Dimitros, A., Vasilios, V. (2011). "The determinants of non-performing mortgage, business and consumer loans in Greece: A dynamic panel data study" International Conference on Applied Economics – ICOAE, 479 – 487.
- Grene, W. H. (2004). *Econometric analysis*. Singapore: Pearson Education.
- James, G., Witten, D., Hastie, T. & Tibshirani, R. (2017). *An Introduction to Statistical Learning* (8th ed.). Springer Science Business Media New York. HYPERLINK "https://www.wikipedia.org/wiki/International_Standard_Book_Number" \o "International Standard Book Number" ISBN HYPERLINK "<https://www.wikipedia.org/wiki/Special:BookSources/978-1-4614-7138-7>" \o "Special: Book Sources/978-1-4614-7138-7" 978-1-4614-7138-7 .
- Keeton, W., Morris C.S. (1987). Why do banks' loan losses differ? Federal Reserve Bank of Kansas City, Economic Review, 72(3), 3-21.
- Klein, N. (2013). Bank Asset Quality in Emerging Markets: Determinants and Spillovers. IMF Working paper, 13(72), 1-26.
- INSTAT. Shifra e Statistika 2007- 2018. Tirana: Instituti i Statistikave Shqipëri.
- Lunga, L., Lazea, R. (2012). New Approaches to Value at Risk and Other Paradigms, Second Edition, *Wiley & Sons, Inc 2010*, pp. 9 – 22, 46 – 52.
- Messai, A., Jouini, F. (2013). Nonperforming Loans in the GCC Banking System and their Macroeconomic Effects. *IMF Working Papers*, 10 (224), 1.
- Messai, A. S., Jouini, F. (2013). Micro and Macro Determinants of Non-performing Loans. *International Journal of Economics and Financial Issues*, 3(4), 852-860.
- Mwanza, N. (2011). Macroeconomic determinants of bad loans: Evidence from European bank, *Occasional Paper*, pp. 5 – 40.
- Nkusu, M. (2011). Nonperforming Loans and Macro-financial Vulnerabilities in Advanced Economies. IMF Working paper, 11(61), 1-27.
- Skarica, B. (2013). Banking supervision and nonperforming loans: a cross country analysis. *Journal of Financial and Economic Policy*, 1(4), 286-318.

KUALIFIKIMI DHE TRAJNIMI I BURIMEVE NJERËZORE TË HOTELEVE DHE RESTORANTEVE NË QYTETIN E SHKODRËS, MUNDËSI E OFRUAR NGA AFP-IA

Alkida Hasaj¹, Rudin Beka², Ermira Mani³

^{1, 2}*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Marketing – Turizmit,*
³*Shkolla Profesionale “Hamdi Bushati”, Shkodër*

Abstrakt

Mjedisi shumë konkurrues në të cilin bizneset në fushën e hotelerisë dhe restoranterisë veprojnë sot, kërkon një fuqi punëtore të aftë dhe të mirë

¹ Dr. Alkida Hasaj është lektore pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në qytetin e Shkodrës, Fakulteti Ekonomik. Ajo mbaroi studimet e larta për Administrim - Biznes në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, gradën master për Marketing në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës dhe studimin e doktoratës në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Durrësit “Aleksadër Moisiu”, Shqipëri. Ajo ka kryer kërkime shkencore në Universitetin Politeknik të Katalonjës, Spanjë; Fazeza, Itali, Universiteti George Washington, Washington DC. Si drejtuese dhe anëtare e ekipit, ajo ka punuar në një numër projektesh kërkimore në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Ka punuar si konsulent marketing ndaj bizneseve të rishitjes.

² Dr. Rudin Beka është lektor pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në qytetin e Shkodrës, Fakulteti Ekonomik. Lëndët e mësimi që ai jep janë Marketing Shërbimesh, Komunikim i Integruar dhe Menaxhim Evenimentesh. Ai zotëron një doktoraturë në dizajnin ambiental dhe interesat kryesore të kërkimit fokusohen rreth fushës së impresionizmit të produktit, inovacionit në turizëm dhe simbolika e markës. Ka eksperiencën të ndryshme ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, është ideator startupesh si dhe ka punuar për disa vite si konsulent marketingu për industrinë e turizmit dhe atë të ushqimit.

³ MSC. Ermira Mani është mësuese dhe drejtuese e ekipit lëndor të drejtimit “Hoteleri – Turizëm” në shkollën e mesme profesionale “Hamdi Bushati” në qytetin e Shkodrës dhe pedagoge e jashtme në Fakultetin Ekonomik. Është diplomuar për “Drejtues Biznesi” në Fakultetin Ekonomik, dega “Administrim – Biznes”, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Gradën Master për “Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm” në Fakultetin Ekonomik, dega “Turizëm”, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Ajo zotëron një sërë kualifikimesh, të tillë si: Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik, titullin Trajnere në edukim në Arsimin e Mesëm Profesional, anëtare e Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve në Shqipëri, si dhe shumë kualifikime të tjera brenda dhe jashtë vendit në fusha të ndryshme të Arsimit dhe Formimit Profesional.

kualifikuar, në mënyrë që të mbeten “lojtarë” të suksesshëm në garën konkurruese të industrisë. Një nga problemet kryesore që ndodhin në vendin e punës është mungesa e kualifikimit dhe trajnimit e burimeve njerëzore. Ky studim parashikon të vlerësojë rëndësinë që ka kualifikimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore të hoteleve dhe restoranteve në qytetin e Shkodrës, nga shkolla e mesme profesionale “Hamdi Bushati”, e cila mbështetet në kurrikula të bazuara në kompetencat bazë të punës.

Për të arritur qëllimin e studimit, të dhënat u siguruan nga burime primare dhe sekondare. Rezultatet ngaurvejimi me pyetësor, u bazuan në një kampion prej 30 biznesesh në qytetin e Shkodrës, nga të cilat: 6 hotele dhe 24 restorante. Pyetësi është shpërndarë gjatë muajve shkurt – mars 2019, në mjediset e biznesit dhe në mjedisin e “Njësisë së Zhvillimit” në shkollë. Ndërsa intervistat janë realizuar me drejtues të shkollës “Hamdi Bushati”.

Nga rezultatet e studimit konstatohet se pjesa më e madhe e bizneseve “vuajnë” nga mospërputhja e kërkesave të kualifikimeve të punës (si kuzhinier, kamarier, receptionist, barist etj.) me ofertën aktuale të tregut të punës. Gjithashtu u evidentua që bizneset në fushën e turizmit (hotele dhe restorante) kualifikimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore në mjediset reale pune dhe në bashkëpunim me shkollën profesionale është mjaft i rëndësishëm në rritjen e produktivitetit dhe uljen e kostos së prodhimit.

Duke u bazuar në gjetjet e studimit, rekomandohet që bizneset duhet të ndërgjegjësohen më shumë për bashkëpunimin afatgjatë me shkollën profesionale “Hamdi Bushati”, me qëllim rritjen e produktivitetit dhe sigurimin e një qëndrueshmërie afatgjatë të biznesit.

Fjalë kyçe: Arsim Profesional, Kualifikimi i Burimeve Njerëzore, Trajnim, Hotele, Restorante.

Qualification and training of human resources at hotels and restaurants in the city of Shkodra, opportunity provided by AFP - IA

Abstract

The highly competitive environment in which businesses in the field of hotels and restaurants operate today require a skilled manpower in order to remain successful "players" in this competitive industry. One of the main problems occurring at the workplace is the lack of qualified and trained human resources. This study anticipates the importance of qualification and

training of hotel and restaurant human resources in the city of Shkodra from professional high school "Hamdi Bushati", which based its curricula on core competencies.

To achieve the purpose of the study, data were obtained from primary and secondary sources. The findings from the survey are the result of the analysis on a sample of 30 questionnaires collected from 6 hotels and 24 restaurants during the months of February - March 2019 in business environments and in the School Development Unit environment. Interviews were conducted with "Hamdi Bushati" school administrators.

The results of the study show that most businesses "suffer" from the inconsistency of job qualification requirements (such as cook, waiter, receptionist, bartender, etc.) with the current job market offer. Businesses in the field of tourism (hotels and restaurants) are also evidenced that human resources training in real work environments and in cooperation with professional school, is very important in increasing productivity and reducing production costs.

Based on the findings of the study, it is recommended that businesses should be more aware of the long-term cooperation with Hamdi Bushati professional school, in order to increase productivity and ensure long-term business sustainability.

Key words: Professional Education, Human Resource Qualification, Training, Hotel, Restaurant.

1.1 Hyrje

Globalizimi dhe ndikimi ndërkombëtar pothuajse i menjëhershëm në ndërmarrjet lokale dhe kombëtare në një vend ka shtuar arsyetimin e ndërmarrjeve në të gjithë botën që t'i rrisin kërkesat e tyre për aftësi dhe shkathtësi si dhe kualifikime të burimeve njerëzore. Domosdoshmëria për trajnime të vazhdueshme të stafit ekzistues dhe stafit të ri gjithashtu është shtuar si rezultat direkt i këtyre proceseve ndryshuese nga ndikimi i globalizimit dhe ndryshimeve në teknologji (Hill, 2008; Wall dhe Rees, 2004). Disa ndryshime dhe zhvillime (p.sh., ndryshimi i tregut të punës, rritja e konkurrencës në mbarë botën, përparimet teknologjike dhe modifikimi i kërkesave në turizëm) kërkojnë aftësi të reja të punësimit nga të diplomuarit që u mundësojnë atyre të përballojnë rrethanat në ndryshim të biznesit të turizmit. Prandaj, Arsimi dhe Formimi Profesional, inkurajon të përfshijë aftësitë kyçe profesionale në kurrikulat e tyre, për aftësimin e burimeve njerëzore në koherencë me dinamikën e

tregut të punës. Trajnimi është një proces thelbësor i cili duhet të dizajnohet dhe zbatohet me maturi në të gjitha firmat. Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi është të shqyrtojë rëndësinë e kualifikimit dhe trajnimit në industrinë e mikpritjes të burimeve njerëzore, mundësi kjo e ofruar nga ofruesit e AFP-së (Arsim Formim Profesional). Sot AFP-ja është ofruesi kryesor i burimeve njerëzore të kualifikuara duke u bazuar në kurrikula në përputhje me standardet e kualifikimit. Shkolla e mesme profesionale “Hamdi Bushati” që nga viti 2008 përgatit nxënës të kualifikuar për tregun në industrinë turistike. Për të siguruar lidhjen midis programeve të AFP-së dhe tregut të punës, është e domosdoshme që ofruesit e AFP-së të rishikojnë dhe të përshtasin ofertën e tyre në mënyrë periodike.

Burimet njerëzore janë pasuria më e madhe në një ndërmarrje, pasi i gjithë zhvillimi është i varur nga kualifikimi dhe angazhimi i tyre. Çdo biznes ka për qëllim maksimizimin e fitimit. Që ndërmarrja ta arrijë këtë duhet që të përzgjedhë dhe të trajnojë burimet njerëzore.

Në këtë studim është punuar rreth rolit të burimeve njerëzore në zhvillimin e tyre si dhe rritjen e të ardhurave të bizneseve të vogla dhe të mesme në industrinë e turizmit (të tillë hotele dhe restorante). Së pari është analizuar rreth përgatitjes profesionale të stafit, duke ditur që industria e turizmit përbëhet kryesisht nga biznese të vogla dhe të mesme. Kjo industri karakterizohet nga paqëndrueshmëria e shumë variablave të burimeve njerëzore, si: kënaqësia në vendin e punës; zhvillimi i karrierës; diversifikimi i tregut; një tendencë për mësimin e vazhdueshëm; inovacionit dhe kreativitetit; kualifikimi për pozicionin e punës etj.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi është të vlerësojë rëndësinë që ka kualifikimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore të hoteleve dhe restoranteve në qytetin e Shkodrës, nga shkolla e mesme profesionale “Hamdi Bushati”, e cila mbështetet në kurrikula të bazuara në kompetencat bazë të punës.

Pyetja kërkimore: *“A sjell përfitim biznesit në sektorin hoteleri dhe restoranti në qytetin e Shkodrës, bashkëpunimi me shkollën e Mesme Profesionale “Hamdi Bushati”?”*

Bazuar në këtë pyetje u ndërtua hipoteza: Si rrjedhë e bashkëpunimit me shkollën e Mesme Profesionale, bizneset në sektorin hoteleri dhe restoranti në qytetin e Shkodrës, kanë siguruar rritjen e produktivitetit dhe uljen e kostos së prodhimit.

Për përmbushjen e qëllimit të temës janë formuluar objektivat e mëposhtme:

1. Të identifikojë rëndësinë e kualifikimit dhe trajnimit të burimeve njerëzore në sektorin hotelier dhe të restoranterisë.
2. Të paraqesë ndikimin e kualifikimit të forcës punëtore të bizneseve në fushën e hotelerisë dhe restoranterisë në qarkun e Shkodrës, në uljen e kostos dhe rritjen e produktivitetit.
3. Të tregojë rëndësinë e zhvillimit profesional të nxënësve në mjediset e biznesit (realizimi i moduleve profesionale në biznes) dhe përshtatja e tyre me kërkesat e tregut të punës.

Ky material i shërben qeverisë për të zhvilluar politika për zhvillimin profesional të kapaciteteve për burime njerëzore, i shërben shkollave profesionale për të përgatitur profesionalisht burime njerëzore në përputhje me kërkesat e tregut, i shërben sektorit privat për të parë rëndësinë e kualifikimit dhe trajnimit të forcës punëtore si dhe krijimit të një lidhjeje afatgjatë të qëndrueshme me IoAFP-në për një të ardhur më të mirë dhe mundësi zhvillimi jo vetëm në tregun shqiptar, por edhe atë rajonal.

1.2 Rishikim literature

Studiues të shumtë theksojnë faktin se Menaxhimi i Burimeve Njerëzore janë çelësi kryesor i suksesit të organizatës dhe performanca organizative varet drejtpërdrejt nga ato (Schultz, 1971; Becker, 1994; Mincer, J., 1958). Në qoftë se një gamë e gjerë procesesh dhe politikash të përshtatshme për burimet njerëzore janë zhvilluar dhe implementuar në mënyrë efektive, burimet njerëzore do të japin një impakt të konsiderueshëm në performancën e firmës.

Shumë studiues të MBNJ-së theksojnë që ka një lidhje pozitive midis praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe performancës së organizatës. Qëllimet e një organizate dhe performanca e mirë e saj mund të arrihet vetëm nëpërmjet punonjësve të saj. Një matje e performancës efektive dhe një sistem menaxhimi lidh sjelljet individuale dhe në ekip të organizatës, strategjitë e biznesit, qëllimet dhe vlerat (Al Hrou dhe Mohamed, 2014). Që një organizatë të arrijë qëllimet e saj, është thelbësore për çdo punonjës të kuptojë rolet dhe përgjegjësitë individuale, dhe gjithashtu duhet të ketë dialog të vazhdueshëm në mes të liderëve dhe të të punësuarve për të vendosur pritjet e performancës, monitorimin e progresit, dhe vlerësuar rezultatet. Modeli i organizimit Performancë dhe Ndryshim, apo Burke & Litwin Model (1992), tregon lidhjet që supozojnë se si performanca është e ndikuar nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm.

Një studim i bërë nga Bulatović, Đurašević & Stranjančević. (2016) na tregon se në përgjithësi një produkt hoteli përbëhet nga shërbime dhe se karakteristikat e tij nuk duhet të harrohen. Simultaniteti i konsumit dhe ofrimi i shërbimeve përmes bashkëveprimit të të dy palëve krijon një atmosferë unike (Kotler, Bowen dhe Makens, 2014). Shërbimet, për dallim nga produktet nuk mund të shihen, preken, provohen, nuhaten ose dëgjohen para blerjes. Shërbimet mund të prodhohen dhe konsumohen në të njëjtën kohë dhe në prani të "prodhuesve" dhe konsumatorëve. Janë shumë cilësi të veçanta të shërbimeve, gjë që bëjnë që produkti hotel dhe restorant të tregojnë rëndësinë e faktorit njerëzor në procesin e ofrimit të shërbimeve dhe sigurisht gjatë shitjes së produkteve hoteliere. Kjo do të thotë që ofruesit e shërbimeve duhet të kenë karakteristika të caktuara: arsim (sipas shkallës dhe profilit), cilësia e punës, kultura e përgjithshme, kultura e biznesit, etika, personaliteti i qëndrueshëm, mirësjellja, konfidencialiteti, integriteti, komunikimi, durimi, bukuri, pamja relativisht e mirë fizike (Curuvija, 2007). Marchante dhe Ortega (2012) deklarojnë se një mospërputhje midis arsimit të kërkuar për një vend pune dhe niveleve të arsimit të punonjësve mund të shpjegojë ndryshimet në produktivitetin e stafit të hotelit. Përveç nivelit të duhur të arsimit, produktiviteti dhe konkurrueshmëria e kompanive hotelerike varen kryesisht nga aftësitë e veçanta të punonjësve të tyre.

Podolny dhe Baron (1997) argumentojnë se koncepti i kapitalit njerëzor është një faktor i rëndësishëm që mund të ndikojë në avantazhin konkurrues dhe performancën e një kompanie. Kështu zhvillimi i fuqisë punëtore dhe motivimi i shpeshtë janë çelësi kryesor drejt një biznesi të suksesshëm hotelesh Al Hrou (2015). Trajnimi i rregullt i personelit në fushën e aftësive të komunikimit është një rrugë e gjatë në përmirësimin e stafit parësor në ofrimin e shërbimeve të klientëve të tyre të ardhshëm, i cili siguron shkathtësi, kompetencë si dhe aftësi profesionale. Mungesa e trajnimit adekuat midis stafit të hotelit ku ka qenë joproduktiv, shpesh ka rezultuar në performancë të ulët dhe rënie të të ardhurave. Sheldon dhe Gee (1987) identifikuan aftësitë kryesore në mënyrë që personeli i hotelit të mund të sigurohej me trajnime të caktuara.

Në anën tjetër, Zhvillimi i Burimeve Njerëzore, që përfshin trajnime të rregullta të stafit, është një faktor i rëndësishëm i MBNJ edhe pse shumë pak organizata i kushtojnë vëmendje të duhur këtij fakti. Qëllimi i kësaj është për të parë sfidat me të cilat përballet sot Zhvillimi i Burimeve Njerëzore. Pajisja e punonjësve të hotelit me aftësitë e nevojshme për kryerjen e punës së tyre patjetër që do të ndikojë në rezultatet e pritshme të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në fushën e hotelerisë. Prandaj është

shumë e rëndësishme, punëtorët e linjës së shërbimit, duhet të jenë të trajnuar mirë për t'u kualifikuar, gjë që u jep shërbime të mira klientëve të hotelit dhe restoranteve.

Historia e ndërmarrjeve të suksesshme të turizmit është ajo që ka të bëjë kryesisht me njerëzit - se si ata janë të trajnuar dhe të kualifikuar, se si vlerësohen dhe shpërblehen dhe se si mbështeten përmes një procesi të mësimi të vazhdueshëm dhe zhvillimit të karrierës. Asnjë nga këto nuk ndodh rastësisht. Riley dhe Szivas (2009) argumenton se "*vetëm punonjësit kompetentë dhe të motivuar mund të ofrojnë shërbime me cilësi të lartë dhe të arrijnë përparësi konkurruese për firmat e tyre dhe destinacionet turistike*". Rritja sasiore e atyre që janë të përfshirë në organizimin e udhëtimeve në shërbim të turistëve është një efekt i rritjes së konsiderueshme të numrit të personave që bëjnë një udhëtim, distancat e nisjes, kohën e caktuar për pushime etj. Numri i atyre që punojnë në hotele dhe restorante, transporte, agjenci turizmi, ofrimin/ ushqyerjen e kënaqësisë, udhëheqja administrative e aparatit turistik regjistron një rritje të konsiderueshme pas zhvillimit të turizmit. Menaxhimi i performancës integron zhvillimin e punonjësve me vlerësimin e bazuar në rezultate në përputhje me objektivat strategjike për të arritur: angazhimin, kompetencën, përputhjen dhe kosto-efektivitetin.

1.3 Modeli zvicerian, si një qasje e re për ofruesit e AFP-së në Shqipëri

Një rol të rëndësishëm në kualifikimin dhe trajnimin e stafit luajnë AFP-të. Aktualisht në 6 shkolla dhe një qendër të AFP-së në Shqipëri, po zbatohet modeli zvicerian i realizimit të praktikave profesionale i cili konsiston në sistemin dual (nxënësit 2-3 ditë në javë zhvillojnë praktikën profesionale në biznes dhe pjesën tjetër të javës zhvillojnë mësimin teorik në mjediset e shkollës). Një ndër iniciativat më të reja në AFP është edhe ngritja e NjZh-së (Njësia e Zhvillimit) si një strukturë brenda shkollës e cila konsolidon dhe më tej bashkëpunimin me sektorin privat dhe realizimin e moduleve profesionale në ambientet e biznesit me qëllim përvetësimin sa më të mirë të shprehive dhe qëndrimeve nga ana e nxënësve.

Një nga gjërat më të arrira në lidhje me modelin zviceran është përfshirja e madhe e punëdhënësve në Arsimin Profesional. Në vend që ta shohin këtë si një përgjegjësi të korporatave sociale, bizneset udhëheqin përpjekjet për të zhvilluar talentin e ardhshëm. Punëdhënësit e dinë se nëse nuk ndihmojnë në trajnimin dhe kualifikimin e fuqisë punëtore, ata do të zbatojnë një cikël trajnimit të tyre shumë më vonë, ndërkohë që edhe kostot do të rriten. Trajnimi i punëtorëve të rinj zviceranë është tregues pozitiv i

kthimit të investimeve për bizneset. Praktikantët janë një pjesë integrale dhe e rëndësishme e sistemit arsimor të Zvicrës. Kompanitë zvicerane e shohin praktikën si një strategji për ndërtimin e një grupi talentesh, prandaj ata kanë një interes të madh për të investuar në gjeneratën e ardhshme të punëtorëve të kualifikuar.

Sot në shkollën “Hamdi Bushati” numërohen rreth 83 biznese partnere të shkollës të shtrira në qarkun Shkodër ndër të cilët 65 i përkasin drejtimit Hotelieri – Turizëm (7 hotele, 46 bar – restorant, 3 pastičeri, 4 fast food, 5 agjenci turistike). Nxënësit realizojnë praktikën profesionale nëpërmjet një kontrate (2-vjeçare) të rregullt ligjore e cila vjen si rrjedhojë e nënshkrimit të një Memorandumi Bashkëpunimi ndërmjet shkollës dhe biznesit. Gjithsej në drejtimin Hotelieri – Turizëm e zhvillojnë praktikën profesionale rreth 245 nxënës nga klasa 10 – 13

1.4. Metodologjia

Për hulumtimin e këtij punimi janë shfrytëzuar burime primare dhe sekondare. Të dhënat sekondare janë siguruar nga publikime kërkimore shkencore dhe librave në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, trajnimin, kualifikimin e tyre dhe rëndësinë e shkollave profesionale në këtë drejtim. Këto të dhëna të publikuara ndihmuan në kuptimin e koncepteve të ndryshme, përkufizimeve dhe metodave të trajnimit, analiza e gjurmimit, si dhe për të vlerësuar më mirë programet e trajnimit, dokumentacionin shkollor.

Kërkimi primar është realizuar me ndihmën e instrumentit të pyetësorit, i cili është i përbërë nga një sërë pyetjesh të mbyllura dhe të hapura të drejtuara bizneseve që ndodhen në marrëveshje me shkollën “Hamdi Bushati”. Shkolla e mesme profesionale “Hamdi Bushati” që prej dy vitesh mbështetet nga projekti zvicerian *Aftësi për Punë* (S4J) model i cili po aplikohet në shkollë. Nëpërmjet këtij modeli sot rreth 75% e nxënësve të drejtimit: Hotelieri – Turizëm zhvillojnë modulet profesionale në mjediset reale pune (biznes). Shkolla ka bërë marrëveshje me 65 biznese në drejtimin e Hotelieri – Turizmit (hotele, bare, pastičeri, restorante) për realizimin e moduleve profesionale në masën 65% në mjediset e biznesit, marrëveshje këto afatgjata të nënshkruara në një Memorandum Mirëkuptimi.

Gjithashtu për të realizuar këtë studim janë ndërmarrë intervistat e realizuara me drejtuesit e shkollës profesionale “Hamdi Bushati”. Rezultatet e kësaj interviste ishin të dhëna rreth bashkëpunimit me biznesin dhe kurrikulave të aplikuara nga shkolla.

Pyetëtorët janë standardë dhe të njëllojtë për të gjitha bizneset e përfshira në studim. Qëllimi i realizimit të këtyre pyetësorëve ishte mbledhja e informacionit të nevojshëm për realizimin e këtij studimi. Kampioni i studimit kanë qenë pronarët e bizneseve hoteleri dhe restoranti në qytetin e Shkodrës. Kampioni për anketim është 30 hotele dhe restorante nga rreth 140 të tilla në qarkun e Shkodrës, nga e cila do të merren rezultatet për profesionalizimin dhe trajnimin e Burimeve Njerëzore si dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e hoteleve dhe restoranteve. Kampioni është përzgjedhur nga hotelet dhe restorantet me numrin më të madh të nxënësve që zhvillojnë praktikën në mjediset e tyre. Pyetëtorët u janë shpërndarë gjatë muajve shkurt – mars 2019 në mjediset e biznesit dhe në mjedisin e Njesisë së Zhvillimit në shkollë. Pronarët e bizneseve janë informuar prapakisht në lidhje me qëllimin dhe objektivat e pyetësorit, natyrën e pyetjeve, kohën, vendin dhe mënyrën e plotësimit të pyetësorëve.

Në pyetësorë janë marrë në shqyrtim variabla, të tillë si: numri i kualifikimit dhe trajnimi i burimeve njerëzore, punësimi i praktikantëve/nxënësve, kostoja e burimeve njerëzore.

1. Metoda sasiore – është aplikuar nëpërmjet përdorimit të instrumentit të pyetësorit, ku janë mbledhur të dhëna në lidhje me numrin e punëtorëve me kualifikimet në biznes, numrin e praktikantëve si dhe kualifikimet e tyre.
2. Metoda cilësore – është aplikuar intervista personale me drejtuesit e shkollës profesionale “Hamdi Bushati”.

1.5. Analiza e rezultateve

Siç u përmend edhe më lart në studim u morën një kampion me 30 biznese (6 hotele dhe 24 restorante) nga një popullim me rreth 140 të tilla në qarkun e Shkodrës. Të gjitha pyetjeve të pyetësorit u është dhënë përgjigje në masën 100% nga të gjithë të anketuarit. Duke u mbështetur në të dhënat e marra nga pyetëtori në lidhje me format ligjore të bizneseve të regjistruara: 18 biznese janë Persona Fizikë (PF), 8 biznese Persona Juridike (PJ) dhe 4 biznese Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK).

Duke pasur parasysh se kryesisht bizneset në qarkun e Shkodrës janë biznese familjare, ato dominohen nga një numër mesatar punonjësish që varion nga 11 deri në 27 punëtorë dhe shumë pak biznese me një numër deri në 10 punëtorë. Rreth 75% e bizneseve kanë një numër punonjësish që varion nga 11 deri në 50.

Numri më i madh i punonjësve në hotele dhe restorante i përketin posteve të punës: Ndihmëskuzhinier, kamarier, picajol (prodhime brumi) dhe sanitare. Pasticierët janë më pak të kërkuar në restorantet, sepse furnizohen nga pasticieritë lokale ose produktet prodhohen nga

ndihmëskuzhinierët. Gjithashtu edhe profili i recepsionit është më pak i kërkuar për arsye se edhe numri i hoteleve është shumë i kufizuar.

Duke analizuar të dhënat e pyetësorit është arritur në këto rezultate përsa u përket kualifikimeve të burimeve njerëzore:

- Kryesisht arsimimi i kategorisë *shefa të kuzhinës* është kualifikim nëpërmjet kurseve profesionale 1-2 vjeçare dhe më pak nga shkolla profesionale;
- Arsimimi i kategorisë *ndihmëskuzhinier* në rreth 80% të rasteve është me arsim të mesëm dhe arsim profesional, më pak janë të kualifikuar me kurse kuzhine 1–2 vjeçare;
- Arsimimi i kategorisë *picajol* i përket kryesisht kualifikimit profesional me shkollë të mesme, shkollë profesionale ose kurse profesionale;
- Arsimimi i kategorisë *barist* i përket kualifikimit me shkollë të mesme dhe shumë pak raste janë kualifikime jashtë shteti.
- Arsimimi i kategorisë *receptionist* i përket kualifikimit me shkollë të mesme ose me shkollë të lartë. Asnjë receptioniste nuk zotëron kualifikimin përkatës për pozicion pune.
- Arsimimi i kategorisë *pastiçier* siç u përmend edhe më lart i përket arsimit të mesëm të përgjithshëm, arsimit profesional ose kurse profesionale. Ky post pune mbulohet nga ndihmëskuzhinierët.
- Arsimimi i kategorisë *kamarier* aktualisht i përket arsimit të mesëm të përgjithshëm, arsimit profesional dhe pak raste, studentë që kanë përfunduar arsimin e lartë dhe nuk kanë gjetur punë akoma.
- Arsimimi i kategorisë *sanitare/lavapjatëse* i përket më tepër arsimit të mesëm dhe 9-vjeçar.


Nga rezultatet e pyetësorit rreth 85% e punonjësve nuk kanë bërë ndonjë herë trajnime pas përfundimit të shkollës së mesme, shkollës së mesme profesionale apo të një kursi kualifikimi. 15% e punonjësve kanë zhvilluar kurse të shkurtra ose trajnime disaditore në lidhje me profesionin e tyre.

Pjesa më e madhe e punonjësve në të gjitha profilet e punës në biznes të marra në studim (shef kuzhine, ndihmëskuzhinier, barist, pasticier, picajol, receptionist, sanitare/lavapjatëse) janë me një eksperiencë 11 – 20 vjeçare në tregun e punës. Ajo çfarë vihet re në biznese është edhe punësimi i të rinjve sidomos dy vitet fundit nga shkolla e mesme profesionale (kryesisht në postet e punës ndihmës kuzhinier, kamarier, receptioniste dhe picajol). Numri më i vogël i stafit të punës përbëhet nga punonjës që i përket eksperiencës në punë mbi 20 vjet (kryesisht shef kuzhine, barist, kamarier dhe sanitare).

Përfitimet e biznesit si rrjedhojë e bashkëpunimit me shkollën e Mesme Profesionale


Në këtë sesion paraqitet analiza e pyetjeve në lidhje me përfitueshmërinë e biznesit si rrjedhojë e bashkëpunimit me shkollën, kostot dhe produktivitetin.

Figura 1-1. Ndikimi në produktivitet të kualifikimit dhe trajnimit të burimeve njerëzore sipas kurrikulave.



Rreth 60% të të anketuarve (Figura 1-1), kanë argumentuar se kurrikula e zbatuar në shkollë, trajnimi në mjediset e biznesit janë faktorë kyç që nxisin rritjen e produktivitetit. Rreth 25% e të anketuarve mendojnë se biznesi duke mos qenë në koherencë me kurrikulat e shkollës, mund të na adresojë në një kualifikim jo të mirë të nxënësve (biznese që nuk e përmbushin në mënyrë optimale kurrikulën). Ndërsa 10% janë skeptikë në lidhje me rritjen e produktivitetit si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi, kurse 5% janë plotësisht dakord. Bizneset skeptike janë ato biznese të cilët e shohin si “angari” në procesin e tyre të përditshëm edhe angazhimin me nxënësit e shkollës në mjediset e tyre.

Figura 1-2 Bashkëpunimi me shkollën profesionale sjell përfitime ekonomike.



Rreth 97% e të anketuarve (Figura 1-2), e shohin me shumë optimizëm bashkëpunimin me shkollën profesionale si një mundësi për rritjen e përfitimeve ekonomike, ndërsa 3% e tyre janë skeptikë ndaj përfitimeve që mund të sjellë bashkëpunimi me shkollën në biznesin e tyre.

Figura 1-3. Efektet pozitive që bizneset kanë nga bashkëpunimi me shkollën.



Duke iu referuar rezultateve të kësaj pyetjeje (figura 1-3) vëmë re se të anketuarit vlerësojnë përfitimet që mund të marrin nëpërmjet kryerjes së praktikave profesionale në ambientet e tyre si dhe marrjes në punë të nxënësve të kualifikuar nga shkolla. Përfitimet që janë vlerësuar më shumë nga ky bashkëpunim: ftohen më shumë klientë si rrjedhojë e një shërbimi më cilësor (35%), ulen kostot e produkteve të dëmtuara gjatë prodhimit (28%), fitohen më shumë klientë si rrjedhojë e prodhimeve më cilësore (25%). Në këtë analizë janë shprehur edhe përfitime të tjera që biznesi mund të ketë të cilat argumentohen në mënyra të ndryshme nga pronarët e bizneseve. Në disa raste, pronarët janë skeptikë ndaj përfitimeve që mund të kenë gjatë bashkëpunimit me shkollën (5%). Një arsye është edhe mbi ngarkesën e këtyre bizneseve me praktikantë, si rrjedhojë e kësaj mjedisi është i kufizuar për nga numri i nxënësve.

1.6 Konkluzione dhe rekomandime

Duke u mbështetur në studimin e realizuar mund të dalim në një sërë konkluzionesh dhe rekomandimesh, të cilat janë paraqitur më poshtë.

Konkluzione

- Kualifikimi i burimeve njerëzore është një funksion bazë organizativ, që jep një kontribut të rëndësishëm në arritjen e objektivave jo vetëm në fushën e biznesit, por edhe në sferat e tjera të aktivitetit njerëzor. Cilësia e kapitalit njerëzor dhe intelektual që zotërojnë organizatat përgjithësisht trajtohet si një faktor kyç për diferencimin e tyre nga rivalët dhe për arritjen e rezultateve cilësisht të larta;
- Kualifikimi i burimeve njerëzore në tregun e turizmit është i rëndësishëm të arrihet nëpërmjet ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat nëpërmjet përfshirjes së këtij të fundit në zhvillimin e kurrikulave, përmirësimin dhe bashkëpunimin për realizimin e praktikave profesionale në mjedise reale pune, identifikimin e nevojave të tregut etj. Si rrjedhojë e bashkëpunimit me shkollën e Mesme Profesionale, bizneset në sektorin hoteleri dhe restoranti në qytetin e Shkodrës, kanë siguruar rritjen e produktivitetit dhe uljen e kostos së prodhimit.
- Vihet re kurrikula që ofron shkolla profesionale me kërkesat e tregut të punës për këto pozicione është koherente njëkohësisht e adoptueshme me të rejat;
- Bizneset janë ndërgjegjësuar që zhvillimi i praktikave në ambientet e tyre do të thotë më pak kosto, më pak problem, rritje e produktivitetit. Në këtë mënyrë reduktohet koha dhe kostot për rekrutimin e personelit të ri si dhe produktiviteti do të rritet.
- Bizneset kanë filluar të ndërgjegjësohen për të bashkëpunuar me shkollën jo vetëm në realizimin e praktikës profesionale, por edhe në kualifikimin e forcës punëtore si mundësi punësimi në ambientet e tyre. Gjatë vitit shkollor 2018 – 2019 mjaft biznese (hotele dhe restorante) në qarkun Shkodër kanë kërkuar burime njerëzore me qëllim punësimin e tyre në profile të ndryshme;
- Në lidhje me trajnimin e burimeve njerëzore në biznese është vënë re nga pyetësi se 85% e tyre nuk janë trajnuar ndonjëherë, pra gjatë gjithë kohës së punësimit nuk janë zhvilluar më profesionalisht, ndërsa 15% janë trajnuar dhe kanë ndjekur kurse apo programe të ndryshme kualifikimi më shumë se një herë në vit.

Rekomandime

- Shkolla duhet të diversifikojë ofertën e profileve të drejtimit Hoteleri – Turizëm çdo 2 – 3 vite në mënyrë të tillë që të plotësojë më mirë nevojat e tregut dhe mos të krijojë ofertë të tepërt të burimeve njerëzore një një kualifikim/profil të vetëm.
- Të zgjerohet numrin dhe llojin e bizneseve në industrinë e turizmit për të krijuar më shumë mundësi për zhvillimin e kompetencave profesionale (njohuri, shprehi dhe qëndrime) në mjedise reale pune dhe diversifikim oferte. Në këtë mënyrë krijohen më shumë hapësira (mundësi) punësimi për nxënësit e diplomuar në shkollë.
- Shteti duhet të krijojë patjetër lehtësira për bizneset që pranojnë praktikantë për realizimin e praktikës profesionale. Kjo marrëdhënie ndërmjet shkollës, biznesit dhe qeverisë duhet të rregullohet nëpërmjet ligjit dhe akteve nënligjore, siç mund të jenë për shembull lehtësi në taksa, tatime, mbështetje financiare etj.
- Bizneset duhet të ndërgjegjësohen më shumë në lidhje me bashkëpunimin me shkollën profesionale për një përfitim të ndërsjellë.
- Shkolla të organizojë kurse afatshkurtra apo trajnime për burimet aktuale njerëzore të hoteleve dhe restoranteve në qëllim zhvillimin e kapaciteteve dhe përshtatjen me të rejtat e tregut, sipas një plani të identifikimit të nevojave.
- Përderisa ekziston një kërkesë nga hotelet dhe restorantet për staf të kualifikuar të burimeve njerëzore dhe nga ana tjetër ekziston një ofertë, sipas kurrikulave dhe standardeve të ofruar nga Arsimi Profesional, atëherë bashkëpunimi ndërmjet shkollës dhe bizneseve duhet të jetë më i frytshëm me qëllimin sigurimin e një suksesi të qëndrueshëm dhe afatgjatë.
- Diversifikimit të ofertës së shkollës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulave, kryesisht i drejtimit Hoteleri–Turizëm në përputhje me kërkesat e tregut.

REFERENCA

- Al Hrou, S. A., & Mohamed, B. (2014). Human Resource Management Practice Tourism and Hotel Industry. In SHS Web of Conferences (Vol. 12, p. 01076). EDP Sciences.
- Alhrou, S. A. (2015). Human Resources Management and Employees' Prosocial Behaviour of Hotel Front Liners in Penang, Malaysia (Doctoral dissertation, Universiti Sains Malaysia).
- Becker, G., 1994. Human Capital: A Theoretical and Empirical Analysis With Special Reference to Education.
- Bulatović, I., Đurašević, S., & Stranjančević, A. (2016). Human resources as a factor of competitiveness and quality in the hospitality industry. In SITCON–Singidunum International Tourism Conference, Belgrade, Serbia, 30th September. Available online: <https://singipedia.singidunum.ac.rs/preuzmi/42427-human-resourcenas-a-factor-of-competitiveness-and-quality-in-the-hospitality-industry/2625>.
- Burke, W. W., & Litwin, G. H. (1992). A causal model of organizational performance and change. *Journal of management*, 18(3), 523-545.
- Ćuruvija, I. (2007). Kvalitet usluga turističkih vodiča. Beograd:Zadužbina Andrejević.
- Hill, C. (2008). International business: Competing in the global market place. *Strategic Direction*, 24(9).
- Kotler, Ph., Bowen, J., & Makens, J. (2014). *Marketing for hospitality and tourism* (6th Ed). Upper Saddle River, Neë York: Prentice Hall Inc.
- Marchante, A. J., & Ortega, B. (2012). Human Capital and Labour Productivity: A Study for the Hotel Industry, *Cornell Hospitality Quarterly*, 53(1), 20-30., first published on December 19, 2011.
- Mincer, J., 1958. Investment in human capital and personal income distribution. *Journal of Political Economy*, Volume 66, pp. 281-302.).
- PhD Dragan, Mustapić, Teacher, Croatian Military College “Dr. Franjo Tuđman”, Zagreb “The role of human resource in the success of small hotels”. (2017)
- Podolny, J. M., & Baron, J. N. (1997). Resources and relationships: social networks and mobility in the workplace. *American Sociological Review*, 62(5), 673-693.
- Rees, C.J. (2008), “Organization development in the 21st century”, in Wankel, C. (Ed.), *Handbook of 21st Century Management*, Sage, New York, NY, pp. 433-41.
- Riley, M., & Szivas, E. (2009). The valuation of skill and the configuration of HRM. *Tourism economics*, 15(1), 105-120.
- Schultz, T. W., 1971. Investment in Human Capital; The Role of Education and of Research. *American Journal of Agricultural Economics*, 53(4), pp. 692-693
- Sheldon, P. J., Gee, C. Y. (1987). Training needs assessment in the travel industry, *Annals of Tourism Research*, 14(2), 173-182.

PERFORMANCA FINANCIARE E BIZNESIT TË VOGËL DHE NDIKIMI NË EKONOMI

Kleida Tufi Heta¹, Arlinda Shkabari²

¹*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Departamenti i Financë-Kontabilitetit*

²*Master shkencor, Universiteti i Tiranës,
Fakulteti Ekonomik*

Abstrakt

Në bazë të ekonomisë shqiptare qëndrojnë bizneset e vogla të cilat kanë pasur një rritje të dukshme gjatë dhjetë viteve të fundit në krahasim me bizneset e mëdha. Duke konsideruar përhapjen dhe rëndësinë e tyre, ky punim fokusohet në përcaktimin e performancës financiare të bizneseve të vogla në qytetin e Shkodrës duke krahasuar raportet e tyre financiare. Punimi synon të përcaktojë gjendjen, strukturën dhe ndryshimet e

¹ *Kleida TUFİ HETA* është pedagoge me kohë të plotë pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” që nga viti 2005. Ajo jep mësim në lëndët Baza Finance, Financë Ndërkombëtare në ciklin e parë të studimeve dhe Drejtım Fianciar, Drejtım Portofoli e Modelim Fianciar në ciklin e dytë të studimeve. Ajo gjithashtu ka dhënë mësim lëndën Corporate Finance në Butler University, IN, USA (2012) dhe International Finance në Sandhills Community College, NC, USA (2014). Ajo është diplomuar në degën Financë-Kontabilitet në Universitetin e Shkodrës (2005) dhe ka përfunduar studimet për Master Shkencor në Financë pranë universitetit të Tiranës, Fakulteti Ekonomisë (2008). Në 2016 merr gradën Doktor Shkencash në fushën e ekonomisë në Universitetin e Durrësit Aleksandër Moisiu. Në periudhën janar-maj 2009 është specializuar për mësimdhënie dhe kërkim shkencor në fushën e financës dhe ekonomisë në Butler University, IN, USA (në bazë të programit JFDP).

Ajo është pjesëmarrëse në mjaft konferenca brenda dhe jashtë vendit si dhe autore e disa botimeve shkencore. Ka kryer trajnime të vazhdueshme (si në Massaryk University (2018), Brno, Çeki; Universita degli studi Guglielmo Marconi, Rome, Itali (2018); Universiteti i Beogradit (2019), etj.) dhe që nga 2010 mban edhe titullin Kontabël i Miratuar.

² *Arlinda Shkabari* është diplomuar me rezultate të shkëlqyera në degën e Financë-Kontabilitetit pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (2019). Ka spikatur si një studente mjaft aktive dhe e përfshirë në projekte e konkurse të ndryshme gjatë ciklit të parë të studimeve. Aktualisht vazhdon studimet për Master Shkencor në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë.

bizneseve të përzgjedhura si dhe të analizojë performancat e tyre në periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2018 me qëllim të përcaktimit të ndikimit të tyre në gjendjen e përgjithshme të ekonomisë.

Analiza e bizneseve të përzgjedhura u krye me përcaktimin e raporteve financiare në bazë të të dhënave të mbledhura nga burimet dytësore në një mostër prej 30 biznesesh që operojnë në sektorët e tregtisë, prodhimit dhe shërbimeve. Hulumtimi i kryer ka zbuluar se ekonomia varet nga karakteristikat e performancës së bizneseve, të cilat mund të kenë një ndikim negativ edhe në ekonominë e përgjithshme në Republikën e Shqipërisë.

Fjalët kyç: performancë financiare, raporte financiare, biznes i vogël, ekonomi.

Abstract

Small business financial performance and its impact in economy

Albanian economy is mainly based on small businesses, the number of which has been considerable increased in the last decade, compared to the number of large businesses. Considering their economic importance, as well as their expansion, this paper focuses on determining and measuring the financial performance of the small businesses in the city of Shkodra, by comparing their financial reports. This study aims to determine the actual financial conditions, the capital structure and the change in financial performance of the businesses included in this study for the period from 2014 to 2018. This study will also try to determine whether the financial performance of small businesses affects the overall economic development stage of our country.

The sample of the study was comprised from 30 companies operating in Shkodra in the sectors of trade, production and service. The analyses of the businesses included in this study was carried out by calculating the financial reports based on secondary data. The study shows that the economy depends from the financial performance characteristics of the businesses, which might even have a negative impact on the overall economic conditions in the Republic of Albania.

Key word: financial performance, financial ratios, small business, economy.

I. Hyrje

Në ekonomitë e vogla në zhvillim, siç është ekonomia e Shqipërisë, biznesi i vogël është gjithmonë dominues, sepse është i vetmi lloj që arrin t'i mbijetojë tregut të kufizuar dhe popullsisë të reduktuar. Gjithashtu ai merr një rëndësi të veçantë në zhvillimin e vendit, sepse është ofruesi kryesor i mallrave dhe shërbimeve si dhe siguron një pjesë të konsiderueshme të vendeve të punës për popullsinë. Sipas INSTAT numri i tyre në 2017 arrinte në 107,500 duke bërë që kjo kategori të përfshijë rreth 99% të numrit total të bizneseve. Duke qenë se biznesi i vogël përbën një pjesë të madhe të ekonomisë shqiptare, performanca e tij financiare është me interes për t'u analizuar.

Pyetja kërkimore është formuluar si në vazhdim: A varet ekonomia shqiptare nga performanca financiare e bizneseve të vogla?

Qëllimi i studimit është analiza e performancës financiare të bizneseve të vogla në qytetin e Shkodrës gjatë periudhës 2014-2018.

Objektivat të cilat synohen me anë të këtij studimi janë:

- të paraqiten të dhëna mbi gjendjen e bizneseve të vogla në Shqipëri;
- të tregohet rëndësia e performancës financiare dhe metodat e maksimizimit të saj;
- të vlerësohet performanca financiare e 30 bizneseve të vogla në qytetin e Shkodrës;
- të analizohet ndikimi i tyre në ekonominë shqiptare dhe të jepen rekomandime.

Metodologjia e përdorur për realizimin e punimit është një ndërthurje e asaj sasiore dhe cilësore. Fillimisht performanca financiare, do të përshkruhet nga ana teorike me ndihmën e literaturave të ndryshme, në mënyrë që të krijojmë pritshmëritë e para mbi ndikimin e saj në ekonomi. Më pas duke përdorur burimet sekondare të publikuara në QKB, janë grumbulluar të dhënat empirike financiare për bizneset e marra në shqyrtim, të nevojshme për llogaritjen e trendit të raporteve financiare që masin performancën financiare. Kjo lloj metodologjie është menduar si më e përshtatshme për të shtjelluar plotësisht objektin e studimit.

I. BIZNESI I VOGËL NË SHQIPËRI

II.1. Përkufizimi i biznesit të vogël dhe rregullimi ligjor i tyre

Identifikimi i biznesit të vogël në Shqipëri rregullohet me ligj (Ligji Nr.10042, datë 22. 12. 2008). Sipas këtij ligji, identifikimi i ndërmarrjeve të

vogla bëhet duke marrë parasysh numrin e punonjësve dhe qarkullimin vjetor ose bilancet e aseteve të tyre. Këta tregues për secilën kategori janë përkufizuar si në tabelën 2-1.

Tabela 2-1. Përkufizimi i biznesit të vogël

	Numri i punonjësve	Totali i aktiveve
Mikronjësitet	0 – 9 punonjës	0 – 10 milion lekë
Njësitet e vogla	10 – 49 punonjës	50 milionë lekë
Njësitet e mesme	50 – 249 punonjës	250 milionë lekë

Burimi: Ligji Nr. 10042, datë 22.12.2008

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NVM) përfaqësojnë pjesën dërrmuese të strukturave sipërmarrëse në Shqipëri. Ato kontribuojnë në masë të madhe në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe në inovacion. Përhapja e tyre gjatë 2017, sipas raportit të INSTAT, është në këto shifra e paraqitur në tabelën 2-2.

Mikronjësitet dhe njësitet e vogla dominojnë sektorin tregtar dhe atë të shërbimeve, ndërsa njësitet e mesme dhe të mëdha dominojnë sektorët e industrisë dhe të ndërtimit. Ky raport ka nxjerrë gjithashtu disa ndikime të rëndësishme që kanë këto kategori biznesesh në ekonominë shqiptare të cilat janë:

- 99,8 % të ndërmarrjeve aktive e zënë NVM.
- Sektori i tregtisë ka peshën më të madhe me 41,4 %, i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera me 20,8 %.
- 80,3 % e të punësuarve janë punësuar nga NVM.
- 77,2 % të shitjeve neto realizohen nga NVM.
- 60,1 % të investimeve në vend kryhen nga NVM.

Tabela 2- 2. Përhapja e biznesit gjatë 2017 në Shqipëri

	Numri i Ndërmarrjeve	Përqindja
Mikronjësitë	101,595	94.4%
Njësitë e vogla	4,839	4.4%
Njësitë e mesme	1,077	1%
NVM	107,511	99.8%
Njësitë e mëdha	166	0.2%
Totali	107,677	100%

Burimi: INSTAT 2019

Shumica e NVM-ve janë në pronësi private. Në vitin 2017, kapitali i huaj ishte i pranishëm në 4,951 NVM (ose 4.5% të numrit të përgjithshëm), duke përfshirë 3,753 ndërmarrje me 1-4 të punësuar. Origjina e vetme më e madhe e investimeve të huaja është Italia, qytetarët e të cilëve kanë investuar në 2,116 NVM shqiptare (ose 42.7% e të gjitha NVM-ve me kapital të huaj). Vende të tjera përfshijnë Greqinë, Turqinë dhe Kosovën. Tradicionalisht, shumica e NVM-ve janë të vendosura në kryeqytetin e Tiranës, por trendi është duke u zhvendosur.

Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve ka ardhur duke u rritur që nga 2013. Rritje kanë pësuar kryesisht mikronjësitë, numri i të cilave është rritur nga 99,798 në vitin 2013 në 101,595 në vitin 2017. Rënie kanë pasur njësitë e vogla dhe të mesme, megjithatë kjo nuk ka ndikuar në përqindjen totale të tregut që zënë NVM.

Tabela 2-3. Numri i NVM përgjatë 2013 - 2017

	Mikro	Të Vogla	Të mesme
2013	99,782	5,235	4,660
2014	101,025	5,387	4,647
2015	101,120	5,179	3,705
2016	101,343	4,926	2,367
2017	101,595	4,839	1,077

Burimi: Raportet vjetore INSTAT 2013-2017

II.2. Matësit ekonomike të biznesit të vogël

Vendi që zënë bizneset e vogla në tregun shqiptar i është i konsiderueshëm prandaj duhet t'u jepet rëndësi dhe t'u kushtohet vëmendje. Megjithëse ekonomia shqiptare është ende një ekonomi në zhvillim, jo

vetëm bizneset e vogla, por të gjitha njësitë ekonomike në tërësi përballen me luhatje ekonomike, megjithatë ecuria e bizneseve të vogla në ekonominë e Shqipërisë ka qenë mjaft pozitive vitet e fundit. Në veçanti, përparimi ka qenë më i rëndësishëm në sektorët e tregtisë dhe të transportit. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që operojnë në industrinë dhe sektorin e shërbimit janë kontribuesit kryesorë të rritjes së punësimit krahasuar me sektorët e tjerë jobujqësorë. Shqipëria është një treg shumë tërheqës për investitorët e huaj, sepse vendi ka pozitë shumë të favorshme gjeografike të Shqipërisë dhe burimet e pasura natyrore dhe burimet njerëzore me kosto të ulët, si dhe është një ekonomi e dominuar nga shërbimet.

Në tabelën 2-4 janë paraqitur treguesit bazë ekonomikë si numri i ndërmarrjeve, të punësuarit, qarkullimi (shitjet neto) dhe investimet për vitin 2017, sipas madhësisë së ndërmarrjeve.

Tabela 2-4. Indikatorët ekonomikë të bizneseve të vogla.

Indikatorët e përgjithshëm	Mikronjësitë	Njësitë e vogla	Njësitë e mesme	Totali
Numri i ndërmarrjeve	95%	4%	1%	100%
Numri i të punësuarve	45%	19%	36%	100%
Qarkullimi	25%	30%	45%	100%
Kostot totale	24%	31%	45%	100%
E ardhura neto	36%	20%	44%	100%
Totali i investimeve	11%	26%	63%	100%
Prodhimi	22%	26%	52%	100%
Vlera e shtuar	23%	23%	54%	100%

Burimi: INSTAT 2019

Burimet njerëzore janë një nga faktorët më të rëndësishëm të prodhimit, veçanërisht nëse marrim parasysh se ndryshimet teknologjike nuk janë ende të përhapura në ekonominë shqiptare. Megjithatë, analiza e këtij treguesi (punësimit) është e rëndësishme jo vetëm për të kuptuar ndryshimet në strukturën e ndërmarrjes dhe të ekonomisë në tërësi, por edhe nga këndvështrimi social. Duke iu referuar shifrave të punësimit për ekonominë jobujqësore, NVM-të kontribuojnë në 60% të totalit të punësimit në nivel kombëtar.


Qarkullimi është një tregues shumë i rëndësishëm i ecurisë së ndërmarrjeve. Si koncept ky tregues korrespondon me shitjet e mallrave ose shërbimeve, të kryera nga ndërmarrja për një periudhë të caktuar kohore. Duke analizuar këtë tregues sektori i NVM-ve, përbën rreth 55% të xhiros totale të realizuar në ekonomi dhe kontributi në qarkullimin e NVM-ve, sipas klasës së madhësisë (mikro, të vogla dhe të mesme) mbetet në nivele të qëndrueshme.

Investimet përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera ose të krijuara nga ndërmarrjet, me qëllim të përdorimit të tyre për një periudhë prej jo më pak se një vit në procesin e prodhimit. Brenda NVM-ve, është grupi i ndërmarrjeve të mesme që kanë realizuar rreth 26% të totalit të investimeve. Komponenti kryesor i investimeve përfaqësohet nga "makineri dhe pajisje" për rreth 40%, pasuar nga investimet në ndërtesa me rreth 15%.

Vlera e shtuar ka një trend të ngjashëm me punësimin. Përqindja më e lartë e vlerës së shtuar nga mikronjësitë realizohet në sektorin e akomodimit dhe të shërbimeve ushqimore (69.2%). Sektori i tregtisë ka përqindjen më të lartë (28.6%) të realizuar nga ndërmarrjet e vogla. Ndërmarrjet e mesme kanë realizuar përqindjen më të lartë të vlerës së shtuar (38.2%) të realizuar nga industria prodhuese.

Në krahasim me ndërmarrjet e mëdha, NVM mbajnë këto pozita siç janë paraqitur në figurën 2-1:

Figura 2-1. *Ndikimi i NVM dhe BM sipas indikatorëve.*



Burimi: INSTAT 2019.

II. KUPTIMI I PERFORMANCËS FINANCIARE

III.1. Performanca financiare dhe rëndësia e saj

Performanca nënkupton kryerjen e një pune të caktuar, e matur kundrejt një standardi saktësie, përmbushjeje, kostoje dhe shpejtësie (Lipi, 2014). Performanca financiare i referohet shkallës në të cilën objektivat financiarë janë duke u realizuar apo janë realizuar dhe është një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të riskut financiar. Ajo përfshin procesin e matjes së rezultateve të politikave dhe operacioneve të një firme në terma monetarë. Performanca financiare mat shëndetin e përgjithshëm financiar të një firme përgjatë një periudhe të caktuar kohe dhe gjithashtu mund të përdoret për të krahasuar firmat e ngjashme në të njëjtën industri ose për të krahasuar industrinë ose sektorët në tërësi. Analiza e performancës financiare përfshin analizën dhe interpretimin e pasqyrave financiare në mënyrë të tillë që të evidentohet tabloja e plotë e rentabilitetit dhe shëndetit financiar të biznesit. Prandaj pasqyrat financiare kanë një rëndësi jetike për analizën e performancës financiare.

Çdo biznes përpiqet të arrijë një performancë të lartë, të përmirësojë avantazhin konkurrues dhe të ketë kthimet më të mira. Zbatimi i strategjive financiare është një nga proceset më të rëndësishme që ndihmon biznesin për të mbijetuar, zhvilluar dhe rritur. Performanca e përgjithshme e një njësie ekonomike përfshin produktivitetin e përgjithshëm, qarkullimin e inventarëve, likuiditetin, rentabilitetin dhe proporcionin e tregut. Koncepti i performancës së përgjithshme është thelbësor për njësitë ekonomike, sepse qëllimi kryesor i tyre është maksimizimi i saj. Pirtea (2009) theksoi se performanca e përgjithshme e një biznesi, duhet të shikohet në drejtim të katër perspektivave të cilat janë qasja financiare, konsumatorët, qasja e brendshme dhe inovacioni. Me interes në këtë studim është qasja financiare, e cila identifikon treguesit kryesorë financiarë të përmirësimit të performancës së përgjithshme, të cilat mund të jenë fitimet, qarkullimi i aktiveve, shkalla e borxhit, qarkullimi i mjeteve monetare dhe kapitali punues.

Performanca financiare na jep një pamje se si ka performuar firma në terma të likuiditetit, drejtimit të mjeteve, borxhit, frytshmërisë dhe vlerës së tregut (Ross, Westerfield, & Jordan, 2010). Tregues të tjerë të rëndësishëm për performancën e njësie ekonomike janë produktiviteti i punonjësve, ulja e kostove të punës për punonjës, vlera e shtuar nga punonjësi dhe qëndrueshmëria e fitimit marginal.

III.2. Faktorët që ndikojnë në performancën financiare

Performanca financiare varet drejtpërdrejt nga menaxhimi financiar i një biznesi. Shpesh ky menaxhim mund të jetë i vështirë për shumë pronarë, sidomos nën një klimë pasigurie ndaj së ardhmes që është e pranishme në ekonominë shqiptare, megjithatë ai mbetet çelësi kryesor për drejtimin efikas të bizneseve. Funksionet si mbajtja e të dhënave, raportimi financiar dhe mbledhja e fondeve, ndihmojnë një firmë në rrugën e saj drejt suksesit financiar. Faktorë të jashtëm që ndikojnë në performancën financiare përfshijnë rregullat dhe ligjet e qeverisë, konkurrencën dhe kostot e huamarrjes.

Rregullat dhe ligjet qeveritare

Drejtuesit organizojnë bizneset e tyre në përputhje me rregullat dhe ligjet përkatëse të vendit, të cilat janë të hartuara për të krijuar një mjedis të përshatshëm për funksionimin e sipërmarrjeve. Legjislacioni i një vendi është shpesh në ndryshim me qëllim përmirësimin, prandaj është e nevojshme për drejtuesit që t'i monitorojnë këto ndryshime. Performanca financiare varet ndjeshëm nga legjislacioni, pasi ky i fundit udhëzon mbi mënyrat e hartimit të pasqyrave financiare, përcakton normat tatimore, pagat, vendos standarde mbi prodhimin, magazinimin, nivelet e ndotjes etj. Objektivi i biznesit në këtë rast është gjetja e mënyrave për të gjeneruar fitime, duke respektuar ligjin.

Konkurrenca

Konkurrenca mund të jetë edhe shkak edhe pasojë e një performace të fortë financiare. Si furnitorët ashtu edhe konsumatorët dhe kredituesit ndikohen nga niveli i konkurrencës në mjedisin ku operon firma. Zakonisht konkurrenca e theksuar ndihet në ekonomitë e zhvilluara ndërsa në vendet si Shqipëria, ajo është e pranishme në nivele mesatare. Kjo i jep avantazh ideve inovative, të cilat absorbohen me lehtësi nga konsumatori, duke bërë që performanca financiare të pësojë rritje të shpejta.

Kreditimi i biznesit

Kreditimi i biznesit është një faktor me shumë ndikim në performancën financiare të bizneseve. Ky faktor u jep njësive mundësinë për të vepruar në perioda afatshkurtra. Kreditë e biznesit janë mënyra më e përdorshme si në fazat fillestare të biznesit, kur ai po ngrihet, por edhe në fazat e zgjerimit ose në fazat e problemeve financiare. Ekuilibri midis borxhit dhe kapitalit është kritik për suksesin e një firme. Kreditimi i biznesit i referohet instrumenteve financiare, të tilla si: kreditë, marrëveshjet e mbitërheqjeve (overdraftet), linjat e kreditit dhe obligacionet.

III.3. Matësit e performancës financiare

Performanca financiare ka shumë mënyra për t'u matur. Ajo matet si në aspekte sasiore ashtu edhe në aspekte cilësore, që hyjnë në kategorinë e menaxhimit. Megjithatë mënyra më e lehtë dhe më objektive për të matur performancën është me anën e analizës financiare. Instrumentet kryesore për matjen e performancës financiare janë raportet financiare. Nëpërmjet tyre mund të shohim nëse janë grumbulluar shumë borxhe, niveli i inventarëve është i lartë, llogaritë e arkëtueshme nuk mbledhen shpejt etj. Ka mjaft diskutime rreth matjes së performancës financiare. Autorë të ndryshëm përdorin raporte të ndryshme.

Heta (2016) bën një përmbledhje literature për matjen e performancës financiare, sipas sektorëve të ekonomisë dhe madhësisë së firmës. Ajo përdor kthimin nga kapitali i vet, kthimin nga aktivet dhe marzhin e fitimit për matjen e performancës së firmave të marra në shqyrtim. Cohen, et al. (2008) sugjeruan si matës për vlerësimin e performancës financiare përdorimin e kthimit nga mjetet, kthimin nga kapitali i vet, raportin e qarkullimit të inventarit, raportin e qarkullimit të borxhit, marzhin e shitjeve, raportin e qarkullimit të mjeteve. McGivern dhe Tvorik (1998) përdorën kthimin nga mjetet, kthimin nga investimi, nga shitjet, nga kapitali i investuar etj. si matësa të performancës.

Sipas Hetes (2016), ka mjaft diskutime rreth matjes së performancës financiare dhe literatura nuk e përcakton dot se cili ose cilët janë matësit më të saktë të performancës financiare. Ajo thekson që matja e performancës financiare varet kryesisht nga aktiviteti i firmës, madhësia e saj, sektori, pronësia etj. Në industrinë prodhuese ajo sugjeron që performanca financiare të matet me raportin e rritjes së shitjeve, kthimit nga kapitali i vet, kostos për njësi, vlerës ekonomike të shtuar, të ardhurës para interesave dhe taksave. Ndërkohë për bizneset familjare sugjerohen rritja e të ardhurës dhe përmirësimi i produktivitetit.

III. ANALIZA E PERFORMANCËS FINANCIARE NË BIZNESIN E VOGËL

Ky studim përqendrohet në bizneset e vogla në qytetin e Shkodrës të cilat kanë detyrimin të publikojnë deklaratat e tyre financiare vjetore. Të gjitha të dhënat financiare janë marrë nga Regjistri Tregtar i mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB). Kriteret e përzgjedhjes së bizneseve që do të përdoren për studim përfshijnë: biznesi është i detyruar të publikojë pasqyrat financiare, është funksional nga viti 2014 deri në vitin

2018 dhe është klasifikuar si biznes i vogël sipas Ligjit Nr.10042, datë 22. 12. 2008.

Hapi tjetër i studimit empirik, është mbledhja e të dhënave për ndërmarrjet e vogla, sipas aktivitetit të biznesit. Mostra e analizuar përbëhet nga 30 biznese që i përkasin sektorit tregtar, të prodhimit dhe të shërbimit (përkatesisht nga 10 për secilin sektor)

Pas përmbushjes së kriterëve të lartpërmendura, janë kryer: analiza e likuiditetit, borxhit financiar, ROA dhe ROE për periudhën 2014-2018 për bizneset e vogla të përzgjedhura.

IV.1. Analiza e të dhënave

Raporti i likuiditetit gjatë periudhës së vrojtuar tregon se bizneset e zgjedhura kanë probleme me likuiditetin, i cili është shumë mbi nivelin e rekomanduar prej 2.0. Mund të konkludohet se arsyeja për një raport të lartë të likuiditetit është niveli i ulët i detyrimeve. Kjo në fakt karakterizon pothuajse të gjitha bizneset. Gjithashtu, bizneset tentojnë të mbajnë stoqe inventari, si dhe nivele të larta cashi. Tabela 4.1 tregon llogaritjen e raportit të likuiditetit, sipas aktiviteteve gjatë periudhës së vrojtuar.

Tabela 4-1. Raportet e likuiditetit

Aktivitetet	2014	2015	2016	2017	2018	Mesatarja
Aktiviteti tregtar	5.45	6.32	7.38	7.46	7.48	6.82
Aktiviteti prodhimit	5.36	6.34	7.40	7.42	7.39	6.78
Aktiviteti shërbimit	4.25	5.99	6.15	6.64	7.21	6.05
Mesatarja	5.02	6.22	6.98	7.17	7.36	

Nga **raporti i borxhit**, vërejmë një shkallë të ulët të përdorimit të borxhit, e cila karakterizon të gjithë aktivitetet. Kjo vjen, sepse detyrimet afatgjata janë pothuajse inekzistente. Bizneset nuk marrin përsipër të financohen nga burime të jashtme, ato tentojnë të mbështeten plotësisht në kapitalin e tyre. Ka diferenca midis llojeve të aktiviteteve, ku raportet më të ulëta janë në aktivitetet e shërbimeve. Megjithatë vihet re një tendencë rritjeje përgjatë viteve, që ka ardhur si rezultat i rritjes së detyrimeve afatshkurtra (tabela 4.2).

Tabela 4-2. Raportet e borxhit financiar.

Aktivitetet	2014	2015	2016	2017	2018	Mesatarja
Aktiviteti tregtar	3.57%	4.32%	4.43%	4.78%	5.41%	4.50%
Aktiviteti prodhimit	4.92%	5.64%	5.19%	5.51%	5.37%	5.33%
Aktiviteti shërbimit	4.87%	4.21%	4.15%	4.64%	4.21%	4.42%
Mesatarja	4.45%	4.72%	4.59%	4.98%	5.0%	

Raportet e përfitueshmërisë përfshijnë ROE dhe ROA. Analiza e bizneseve të vëzhguara nuk tregon dallime të mëdha ndërmjet këtyre dy raporteve. Kjo shpjegohet nga fakti se shkalla e borxhit e përdorur në këto biznese është e vogël, prandaj pjesën më të madhe të pasiveve e zë kapitali. Këto raporte nuk janë në vlera të mëdha. Kjo vjen kryesisht sepse nivelet e shitjeve nuk janë shumë të larta, pasi bizneset janë lokale dhe tregu nuk është shumë i madh. Vihen re tendencat e rritjes që reflektojnë rritjen e raportit të levës financiare (tabela 4.3 dhe tabela 4.4).

Tabela 4-3. Raportet e ROA.

Aktivitetet	2014	2015	2016	2017	2018	Mesatarja
Aktiviteti tregtar	9.45%	9.17%	9.79%	10.28%	10.41%	9.82%
Aktiviteti prodhimit	10.61%	10.37%	10.22%	10.40%	10.43%	10.41%
Aktiviteti shërbimit	9.12%	9.24%	9.16%	9.27%	9.33%	9.22%
Mesatarja	9.73%	9.59%	9.72%	9.98%	10.05%	

Tabela 4- 4. Raportet e ROE.


Aktivitetet	2014	2015	2016	2017	2018	Mesatarja
Aktiviteti tregtar	9.86%	9.43%	10.14%	10.57%	10.83%	10.17%
Aktiviteti prodhimit	11.34%	10.82%	10.71%	11.20%	11.31%	11.08%
Aktiviteti shërbimit	9.62%	9.87%	9.66%	9.91%	10.18%	9.85%
Mesatarja	10.27%	10.04%	10.17%	10.56%	10.77%	

IV.3. Ndikimi në ekonominë shqiptare

Biznesi i vogël ka një përhapje të konsiderueshme në ekonominë shqiptare me rreth 99% të të gjitha bizneseve, prandaj padyshim duhet të merret në konsideratë ndikimi i tij. Duke vërejtur indikatorët ekonomikë të biznesit të vogël, arrihet të dallohet që pjesa më e madhe e PBB të vendit gjenerohet nga ky lloj biznesi. Gjithashtu, ai kontribuon në punësim, duke ofruar mundësitë më të mëdha për vende pune, si dhe ndikon në zhvillimin lokal. Numri i bizneseve të vogla në qytete rrit mirëqenien për banorët, kjo, sepse konsumatorët zakonisht preferojnë të kryejnë blerjet e tyre në bizneset lokale. Avantazhi i tyre është se një përqindje e lartë e të ardhurave që shpenzohen në bizneset e vogla, qëndron po në komunitet, sepse bizneset i riinvestojnë të ardhurat po në aktivitetin e tyre.

Për ndikimin e performancës financiare të biznesit të vogël në ekonomi, mund të bëjmë një analogji midis performancës financiare të biznesit të vogël që rezultoi nga studimi i bërë në qytetin e Shkodrës dhe ecurisë ekonomike të Shqipërisë përgjatë viteve të marra në shqyrtim. Kështu, sipas raporteve të Bankës Botërore, ekonomia e Shqipërisë ka pësuar rritje vitet e fundit, për shkak se ka pasur rënie në nivelin e papunësisë dhe janë rritur investimet në ekonomi. Si matës kryesor për ta paraqitur këtë është përdorur rritja e PBB-së reale.

Figura 4- 1. Rritja e PBB-së reale në Shqipëri gjatë 2014-2018



Burimi: World Bank (2019)


Siç shihet vitet 2014 dhe 2015 kanë rritjen më të ulët të PBB-së reale ku të njëjtin trend na pasqyrojnë edhe raportet e qëndrueshmërisë, ndërkohë në këtë periudhë rriten edhe raportet e borxhit. Ndërsa në vitet 2016 deri në 2018, kemi një përmirësim si në indeksin e PBB-së dhe në

raportet e performancës. Kjo shihet nga raportet më të larta që shoqërojnë vitet 2017 dhe 2018. Raporti i borxhit pëson luhatje, ndërsa ai i likuiditetit rritet. Është një marrëdhënie e ndërsjellë midis ekonomisë dhe performancës së bizneseve.

Shpesh janë këto të fundit që përcaktojnë ecurinë e ekonomisë në tërësi, siç u tregua më sipër, por ka raste kur vetë raportet janë rezultat i karakteristikave të ekonomisë së një vendi, kjo tregohet nga rezultatet e pazakonta të raporteve. Nga raportet u vu re niveli i ulët i detyrimeve që karakterizonte të gjitha bizneset e marra në shqyrtim. Kjo vjen, sepse bizneset e vogla nuk marrin përsipër risk. Ato nuk përfshihen në aktivitete huamarrëse, por preferojnë të mbahen me fitimet e gjeneruara. Gjithashtu vlerat e raporteve janë larg nga vlerat e zakonshme të kompanive evropiane. Kjo ndodh, sepse biznesi i vogël në Shqipëri, nuk investon në tregje financiare. Në aktivitet e bilanceve të tyre mungojnë aktivitetet financiare dhe kjo është edhe rezultat i zhvillimit të ulët që karakterizon këtë treg.

Gjithashtu vërehet se nuk ka ndryshime shumë të mëdha midis llojeve të aktiviteteve që kemi marrë në shqyrtim. Nëse vërejmë mesataret e aktiviteteve për çdo raport, shohim se janë të përafërta.

Figura 4-2. Performanca financiare sipas aktiviteteve³



Kjo sepse tregu dhe politikat qeveritare ofrojnë të njëjtat mundësi për të gjithë llojet e aktiviteteve apo sektorëve. Të tre sektorët janë njëllor të zhvilluar, ndonëse ai i shërbimeve ka më tepër përhapje, kjo edhe për shkak se kërkon një kapital më të vogël hapja e këtij lloji aktiviteti. Ndërkohë që në politikat qeveritare nuk ka mbështetje për sektorë të

³ Aktiviteti A = aktiviteti tregtar; aktiviteti B = aktiviteti i prodhimit; aktiviteti C = aktiviteti i shërbimit

veçantë⁴, kështu këto të fundit dallojnë vetëm nga mënyra e drejtimit të biznesit që kushtëzohet nga vetë lloji i aktivitetit. Është e kuptueshme që një biznes prodhimi i administron ndryshe aktivet e veta në krahasim me një biznes tregtar apo shërbimi. Ndryshimet e vogla në raporte i detyrohen këtij fakti.

Përmirësimi i raporteve vitet e fundit i atribuohet ndërgjegjësimit të bizneseve gjithnjë e më tepër ndaj qasjeve të reja të strategjive financiare. Me hapjen e shumë kompanive financiare vitet e fundit, por edhe me politikat e Bankës Qendrore me normat e interesit, është krijuar një mjedis i përshtatshëm që nxit bizneset drejt huamarrjes dhe investimit. Kjo krijon pritshmëri për një ecuri më të mirë ekonomike në të ardhmen.

IV. Konkluzione dhe rekomandime

Ky punim u realizua me qëllimin për të vlerësuar **kushtet financiare** të aktiviteve të përzgjedhura në periudhën e vëzhguar mbi bazën e të dhënave të marra nga Rregjistri Tregtar në një mostër të përbërë nga 30 biznese të vogla që operojnë në qytetin e Shkodrës në periudhën 2014 – 2018. Për këtë qëllim, u parashtrua pyetja e mëposhtme kërkimore: A varet e gjithë ekonomia shqiptare nga performanca financiare e bizneseve të vogla në aktivite të përzgjedhura? Në mënyrë që t'i jepet përgjigje pyetjes në fjalë, u kryen analizat e aktiviteve të zgjedhura duke analizuar raportet e likuiditetit, borxhit, ROA dhe ROE. Studimi i kryer tregoi varësinë e ekonomisë nga performanca e aktiviteve specifike. Kjo u duk në ngjashmërinë e performancës së biznesit me rritjen ekonomike në Shqipëri. Për të dhënë përfundime më të detajuara mbi aktivitetet duhen bërë analiza më të zgjeruara që përfshijnë më tepër raporte të marra në shqyrtim, megjithatë objekti i studimit ishte biznesi i vogël në tërësi.

Do të ishte e rekomandueshme që bizneset e vogla të nxiten drejt investimeve, qoftë në vetë aktivitetin e tyre, qoftë në instrumentet financiare që ofron tregu. Gjithashtu duhet të shfrytëzohen likuiditetet e tepërta për të zgjeruar aktivitetin në mënyrë që të ekspozohen ndaj një tregu më të madh. Në këtë mënyrë mund të përmirësohen raportet e përfitueshmërisë. Edhe në aspektin e politikave mbështetëse të biznesit të vogël ka vende për përmirësime. Ndonëse është lehtësuar barra fiskale e këtyre bizneseve, duhet punuar në përmirësimin e legjislacionit për biznesin e vogël duke e harmonizuar me standardet evropiane. Si dhe duhet

⁴ Në raportin e Small Business Act (2018) për Shqipërinë theksohet se politika aktuale ekonomike e Shqipërisë nuk ka vendosur prioritet ndonjë prej sektorëve që merren në shqyrtim në këtë punim dhe kjo shpjegon shkallën e ulët të zhvillimit të tyre.

të krijohen programe mbështetëse, veçanërisht në aspektin e ndihmës financiare dhe teknike për të rritur konkurrencën e bizneseve të vogla drejt tregjeve rajonale, tregjeve evropiane dhe ndërkombëtare.

Aftësitë financiare të pronarëve luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e biznesit të vogël. Ato mundësojnë kuptimin e shumicës së çështjeve financiare dhe bëjnë të mundur që drejtuesit të veprojnë në përputhje me kornizat financiare. Mundësitë e biznesit gjithashtu mund të përmirësohen nëse pronarët kanë aftësi të mira financiare. Në këtë drejtim do të ishte e këshillueshme që bizneset e vogla t'i drejtohen më tepër konsulentëve financiarë, ose të ndërmerren programe informimi drejt këtij target grupi, mbi njohuritë bazë që duhet të ketë çdo menaxher.

Si përfundim, mund të themi, se ky studim mund të zgjerohet më tej duke analizuar më me detaje raportet financiare dhe duke klasifikuar rezultatet, sipas një ndarjeje më të specifikuar të aktiviteteve, në mënyrë që të kemi rezultate më të plota mbi impaktin e performancës financiare në ekonominë e vendit.

BIBLIOGRAFIA

- Banerjee, A., & De, A. (2014). *Determinants of Corporate Financial Performance Relating to Capital Structure Decisions in Industry: An Empirical Study*. Marrë nga: <http://eds.a.ebscohost.com/eds/pdfviewer/pdfviewer?vid=3&sid=9b669ec8-4620-4f4e9a90-29de1ca03afe%40sdc-v-sessmgr02>
- Banka Evropiane e Investimeve (EIB) (2016). Albania – Assessment of financing needs of SMEs. Marrë nga: https://www.eib.org/attachments/efs/assessment_of_financing_needs_of_smes_albania_en.pdf
- Cohen, S., Thiraios, D., & Kandilorou, M. (2008). Performance parameters interrelations from a balanced scorecard perspective: An analysis of Greek companies. *Managerial Auditing Journal*, 23 (5), 485-503.
- Dinca, M. S. (2018). Financial Performance Analysis of Romanian Companies. *Bulletin of the Transilvania University of Brasov. Series V: Economic Sciences*, 11(2), 147–156. Marrë nga: <http://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&AuthType=custuid&custid=ns083231&db=bsu&AN=134175397&site=eds-live>
- Fiegner, M., Nielsen, J., & Sisson, J. R. (1996). Tenure Characteristics of Outside Directors And Financial Performance. Marrë nga: <http://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&AuthType=custuid&custid=ns083231&db=bsu&AN=5631250&site=eds-live>
- Heta, K. (2016). Ndikimi i faktorëve të riskut në performancën financiare të firmave që operojnë me nënkontrakte në distancë. Teme Doktorature: Universiteti i Durrësit, Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Financë-Kontabilitetit
- INSTAT (2019). Statistika mbi biznesin e vogël dhe të mesëm. Marrë nga: <http://www.instat.gov.al/media/5319/rezultatet-e-sme.pdf>

-
- INSTAT (2019). Statistikë mbi strukturat e ndërmarrjeve 2017. Marrë nga: <http://www.instat.gov.al/en/themes/industry-trade-and-services/structural-business-statistics/>
 - Lipi, R. (2014). Performanca financiare dhe orientimi sipërmarrës i NVM-ve, qarku Vlorë. Temë doktrature: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Financës.
 - Luftig, J. T., Qatar Financial Centre, & Ouellette, S. M. (2012). Business Performance Excellence. London: Bloomsbury Information. Marrë nga: <http://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&AuthType=custuid&custid=ns083231&db=e000xëë&AN=1739522&site=eds-live>
 - McGivern, M. H., & Tvorik, S. J. (1998). Vision driven organisations: Measurement techniques for group classification. *Management Decision*, 36 (4), 241-264.
 - NFBI Research Foundation (2012). Small Business Indicators of Macro-Economic Performance: An Update. Marrë nga: <https://www.nfib.com/Portals/0/PDF/AllUsers/research/studies/macro-economic-performance-nfib-201207.pdf>
 - Ngwenya, B. & Ndalama, C. (2016). An Evaluation of Factors Influencing Financial Performance of Selected Manufacturing Companies. CLEAR International Journal of Research in Commerce & Management, 7(9), 1–4. Marrë nga: <http://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&AuthType=custuid&custid=ns083231&db=bsu&AN=119728196&site=eds-live>
 - Pirtea, M., Nicolescu, C., & Botoc, C. (2009). The role of strategic planning in modern organization. Marrë nga: <https://core.ac.uk/download/pdf/6481355.pdf>
 - Ross, S. A., Westerfield, R. W., & Jordan, B. D. (2010). *Fundamentals of corporate finance, 9th ed.* New York: McGraw-Hill/Irwin.
 - Wagner, M., & Schaltegger, S. (2006). Managing the Business Case for Sustainability : The Integration of Social, Environmental and Economic Performance. Sheffield, UK: Routledge. Marrë nga: <http://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&AuthType=custuid&custid=ns083231&db=e000xww&AN=561561&site=eds-live>
 - Waghmare, P., Jacksone, C., Poulouse, J., Krishnan, P., Mundeja, S., Deep, V., et al. (2011). An empirical study of factors that influence financial flexibility, financial structure and financial performance of a firm. Marrë nga: https://www.academia.edu/7982008/An_Empirical_Study_of_factors_that_influence_Financial_Flexibility_Financial_Structure_and_Financial_Performance_of_a_Firm

FINANCAT PERSONALE DHE TË ARDHURAT E EKONOMIVE FAMILJARE NË KOSOVË

Agim Berisha¹

Kolegji Biznesi, Fakulteti Ekonomik

Abstrakt

Në kuadër të punimit shqyrtohen financat personale përfshirë të ardhurat e ekonomive familjare në Kosovë. Pas luftës së vitit 1999, Kosova ballafaqohet me probleme të shumta ekonomike përfshirë nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik dhe papunësinë e lartë që ka ndikuar edhe në nivelin e të ardhurave si dhe në standardin dhe mirëqenien ekonomike të ekonomive familjare në Kosovë. Punimi përfshin studimin mbi financat personale dhe të ardhurat e ekonomive familjare në Kosovë. Në këtë studim, analizohet ecuria e të ardhurave të ekonomive familjare përfshirë periudhën e viteve të fundit.

Individët përballen me menaxhimin financiar çdo ditë, të tilla si: shpenzimet për ushqim, blerjen e veshjeve, blerjen e shtëpive ose makinën. Shumë prej këtyre vendimeve financiare që bëjmë sot mund të kenë efekte afatgjata për jetën. Duke pasur parasysh se shumë nga vendimet financiare që bëjmë gjatë jetës ndikojnë në mirëqenien tonë si dhe në shoqërinë në tërësi, niveli i ulët i menaxhimit financiar mund të kuptohet si një shqetësim i madh që lidhet drejtpërdrejt me edukatën financiare.

Edukimi financiar është një çështje dydimensionale. Ai përfshin të kuptuarit e koncepteve themelore financiare dhe aftësinë e disiplinës për ta përdorur këtë informacion për të marrë vendime të mençura financiare. Këto vendime përfshijnë, sa të shpenzojnë, si të kursejnë, të menaxhojnë në

¹ Ka kryer Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës dhe studimet pasdiplomike-Magjistraturën në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë. Studimet e Doktoraturës në Universitetin Bujqësor të Tiranës-Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit në drejtimin: Financë-Kontabilitet në vitin 2013. Në vitin 2002 punësohet në Shkollën e Mesme "Xhelal Hajda-Toni" në Rahavec, profesor i lëndëve ekonomike. Prej vitit 2005 punon në Kolegjin "BIZNESI", ku dhe tani punon, profesor i lëndëve ekonomike, ndërsa që nga viti 2009 punësohet në MBPZHR, aktualisht në pozitën e auditorit të brendshëm. Ka kryer disa trajnime në fushën e financave publike.

mënyrë efektive një buxhet mujor, zgjedhjen e produkteve të duhura financiare dhe gatishmërinë për adresimin e ngjarjeve të tjera të jetës, siç është planifikimi i një investimi.

Në këtë punim objektivi kryesor konsiston në analizën e ecurisë së të ardhurave të ekonomive familjare në Kosovë viteve të fundit. Për finalizimin e punimit, për arritjen e objektivave përdoren kryesisht metoda e analizës dhe sintezës, tabelore dhe grafike veçmas, metoda krahasuese, etj.

Përmes këtij studimi synojmë, që konkluzionet dhe rekomandimet e dhëna, të merren në konsideratë dhe t'u shërbejnë sadopak akterëve në fushën e financave publike.

Fjalët kyçe: Financat Personale, të ardhurat ekonomive familjare, paga, sektori publik, sektori privat, remitencat.

Personal finance and family economic income in Kosovo

Abstract

Within the paper, personal finances are considered including household income in Kosovo. After the 1999 war, Kosovo faces numerous economic problems, including low levels of economic development and high unemployment, which has influenced both the level of income and the standard and economic well-being of households in Kosovo. The paper includes a study on personal finances and household income in Kosovo. In this study, the performance of household income is analyzed, including the period of recent years.

Individuals face financial management every day, such as spending on food, purchasing clothing, home purchase, or car. Many of these financial decisions we make today can have long lasting effects for life. Given that many of the financial decisions we make during life affect in our well-being as well as the society as a whole, the low level of financial management can be understood as a major concern directly related to education financial.

Financial education is a two-dimensional issue. It includes understanding of basic financial concepts and the ability of discipline to use this information to make wise personal financial decisions. These decisions include, how much to spend, how to spare, effectively managing one

monthly budget, choice of appropriate financial products and readiness for it addressing other life events, such as planning an investment.

In this paper, the main objective is to analyze the household income performance in Kosovo in recent years. For the finalization of the work, mainly the method of analysis and synthesis, the table and the graphic separately, the comparative method, etc. are used to achieve the objectives.

Through this study we intend that the conclusions and recommendations given be taken into consideration and serve some of the stakeholders in the field of public finances.

Key words: Personal Finances, Household Income, Salary, Public Sector, Private Sector, Remittances.

Hyrje

Në kuadër të financave, çështje mjaft e rëndësishme konsiderohen padyshim financat personale. Në këtë punim objektivi kryesor konsiston në analizën e ecurisë së të ardhurave të ekonomive familjare në Kosovë viteve të fundit. Po ashtu, analizimi i nivelit të pagave në sektorin publik dhe sektorin privat në Kosovë.

Në kuadër të këtij studimi për arritjen e objektivave përdoren kryesisht metoda e analizës dhe metoda krahasimore duke analizuar në dinamikë çështjen që lidhet me financat personale dhe ecurinë e të ardhurave të ekonomive familjare.

Pyetjet kërkimore të punimit:

- Cili është trendi i të hyrave sipas burimit në strukturën e të ardhurave të ekonomive familjare?
- Sa është niveli i pagave në sektorin publik dhe sektorin privat në Kosovë?

Metodologjia e përdorur

Për finalizimin e këtij punimi, materiali i paraqitur ka mbështetje përfshirë literaturën vendëse dhe të huaj, si dhe raporte e publikime nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ku trajtohen çështje të lidhura me buxhetin e ekonomive familjare, përkatësisht të ardhurat e ekonomive familjare viteve të fundit në Republikën e Kosovës. Po ashtu është përdorur burimi statistikor vendas, metoda e analizës dhe sintezës, tabelore dhe grafike veçmas, metoda krahasuese etj.

Rishikimi i literaturës

Financa personale konsistojnë në studimin e burimeve të familjes, pra ka të bëjë me mënyrën se si njerëzit shpenzojnë, kursejnë, mbrojnë dhe investojnë paratë e tyre. Planifikimi i financave personale është procesi i menaxhimit të burimeve financiare (parave) për të arritur kënaqësinë ekonomike personale. Një person i edukuar financiarisht zotëron aftësinë për të marr vendime lidhur me:²

- Kursimin.- për të përmbushur objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë;
- Kredinë.- përdorimin e përgjegjshëm të saj;
- Administrimin e rreziqeve financiare.

Administrimi i parave apo financave personale është një aftësi e përvetësuar që përfitohet me edukim dhe përvojë. Avantazhet specifike të planifikimit financiar përfshijnë:

- Rritjen e efikasitetit në sigurimin, përdorimin dhe mbrojtjen e burimeve financiare gjatë gjithë jetës;
- Rritjen e kontrollit për çështjet financiare, duke shmangur tejkalimin e borxhit, falimentimin, si dhe varësinë nga të tjerët (për siguri ekonomike).

Me fjalë tjera në jetën e përditshme të gjithë ndeshemi para marrjes së vendimeve financiare. Nisur nga kjo pjesa më e madhe e vendimeve janë të thjeshta dhe kanë më pak pasoja, disa janë më komplekse me efekte afatgjata në jetën dhe financat tona. Padyshim që çdo individ apo familje ndeshet me një sërë problemesh financiare. Prandaj, për të përballuar këto probleme, duhet të përcaktohen qëllimet financiare të formuluar mirë.

Qëllimi financiar shpreh objektivat që duhet të përmbushen në të ardhmen dhe që përkojnë me nevojat financiare. Qëllimi financiar duhet të përmbushë dy attribute kryesore:

- Të jenë të matshëm në vlerë dhe në kohë;
- Të jenë të arritshme (të realizueshme).

Analiza e financave personale

Financat personale kanë të bëjnë me administrimin e parave të cilat mund të përdoren për shpenzimet e përditshme (si p.sh.; për pagimin e faturave), për kursim dhe kryerjen e investimeve.³ Planifikimi financiar kalon nëpër gjashtë hapa kryesorë:

² Banka e Shqipërisë, Financat personale në duart tuaja, Tiranë, 2011, fq. 9.

³ Po aty, fq. 11.

- 1) Përcaktimin e situatës aktuale financiare (të ardhurat, kursimet, shpenzimet e jetesës dhe borxhet);
- 2) Përcaktimin e qëllimeve financiare;
- 3) Përcaktimin e alternativave të tjera, kur merret vendimi.
 - Mund të vendosim që shuma e parave që kursehet çdo muaj është e mjaftueshme;
 - Mund të zgjedhim të kursejmë një shumë më të madhe të hollash çdo muaj;
 - Mund të vendosim të investojmë në Bono Thesari, në vend të depozitës së kursimit.
- 4) Vlerësimin e alternativave të tjera;
- 5) Hartimin dhe zbatimin e planit financiar;
- 6) Rishikimin e planit.

Kursimi është proces i heqjes mënjane të asaj pjese të të ardhurave që nuk e konsumojmë (që nuk e përdorim tani për të blerë të mira dhe shërbime), të cilën e ruajmë për të konsumuar në një moment të dytë ose për të përballuar shpenzimet e papritura.⁴ Tre faktorët kryesorë që ndikojnë në vendimet për planifikim financiar janë:

- Cikli i jetës,
- Vlerat individuale dhe
- Faktorët ekonomikë.

Njerëzit në moshën 20-vjeçare shpenzojnë shumë më ndryshe paratë nga ata rreth të 50-ve. Faktorët personalë, si: moshë, të ardhurat, madhësia e familjes, ndikojnë në mënyrën e të shpenzuarit dhe të kursimit. Element tjetër që duhet të merret në konsideratë janë edhe vlerat personale të cilat kanë një ndikim direkt në vendime, të tilla si: të shpenzojmë tani në vend që të kursejmë për të ardhmen etj. Vendimet financiare personale varen në mënyrë thelbësore nga indeksi i çmimeve të konsumit (inflacioni), shpenzimet për konsum dhe normat e interesit. Pikë kyçe për fillimin e planifikimit financiar është gjendja aktuale financiare e individit.

Të ardhurat e ekonomive familjare në Kosovë

Financa personale studion aspektet financiare të individit dhe familjes. Financat personale konsistojnë në studimin e burimeve të familjes, të cilat konsiderohen të rëndësishme në përmbushjen e suksesit financiar,

⁴ Banka e Shqipërisë, Financat personale në duart tuaja, Tiranë, 2011, fq. 98.

pra ka të bëjë me mënyrën se si njerëzit shpenzojnë, kursejnë, mbrojnë dhe investojnë paratë e tyre.⁵

Në kuadër të familjes, individët ndajnë në mënyrë të përbashkët mirëqenien, pasurinë, të ardhurat dhe shpenzimet. Familjet përballen me katër lloj vendimesh financiare bazë:⁶

- Vendimet e konsumit dhe kursimit: ç ‘pjesë të të ardhurave të tyre duhet të konsumojnë dhe ç’ pjesë të të ardhurave të tyre duhet të kursejnë për të ardhmen;
- Vendimet e investimit: Si duhet t’i investojnë paratë që kanë kursyer;
- Vendimet e financimit: Kur dhe si duhet t’i përdorin paratë e të tjerëve për të zbatuar planet e tyre të konsumit dhe investimit;
- Vendimet e menaxhimit të riskut: Si dhe në cilat kushte, familjet do të kërkojnë të reduktojnë pasiguritë financiare me të cilat përballen, apo kur duhet të marrin përsipër më shumë risk?

Prandaj në kuadër të familjes, përgjegjësia financiare, nënkupton që individët janë të përgjegjshëm, për mirëqenien e tyre në të ardhmen, dhe që bëjnë të gjithë përpjekjet e mundshme, për të marrë vendimet e duhura në financat personale.

Të ardhurat e ekonomive familjare në Kosovë rrjedhin prej burimeve të ndryshme. Në tabelën në vijim paraqitet burimi i të ardhurave të ekonomive familjare në Kosovë në periudhën 2010-2017.

Tabela-1

Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë 2010-2017 - në përqindje.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Rrogat dhe pagat nga sektori publik	26	25	23	23	22	26	25	23
Rrogat dhe pagat nga sektori privat	21	22	23	28	30	22	26	29
Bujqësi	6	7	5	5	4	5	5	3

⁵ Sharku, dr.Gentiana, Leka, dr.Brikena, Bajrami, dr. Etleva, Financa, Tiranë, 2013, fq. 252.

⁶ Sharku, dr.Gentiana, Leka, dr.Brikena, Bajrami, dr. Etleva, Financa, Tiranë, 2013, fq. 14.

Të ardhurat nga mëditjet	8	9	9	7	7	6	7	6
Biznese të tjera të ekonomive familjare	14	12	15	11	10	11	11	13
Pensionet	8	8	8	11	13	13	11	12
Të hollat e dërguara nga jashtë	9	9	10	8	8	9	8	8
Të hollat e dërguara nga Kosova	1	0	0	0	0	1	1	1
Ndihma sociale – Kategori I	3	4	4	4	3	4	3	3
Ndihma sociale – Kategori II	2	2	1	1	1	1	1	1
Të ardhurat nga prona	---	---	---	---	---	1	0	0
Pensionet e familjeve të dëshmorëve	---	---	---	---	---	---	1	1
Të tjera	2	2	2	2	2	1	1	1
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2019, Prishtinë, 2019, fq. 109-110.

Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë mbeten të ardhurat nga sektori publik dhe nga sektori privat. Përveç rrogave nga sektori publik dhe rrogave nga sektori privat si burim i rëndësishëm i të ardhurave për ekonomitë familjare në Kosovë, burime të tjera të rëndësishme janë pensionet dhe bizneset e ekonomive familjare, si dhe paratë e dërguara nga jashtë (remitencat).

Nga tabela shihet burimi i të hyrave nga ekonomitë familjare në Kosovë në periudhën 2010-2017. Burimi kryesor i të hyrave mbeten rrogat në sektorin publik, ku pjesëmarrja në të hyrat e ekonomive familjare në vitin 2010 ishte 26%, ndërsa në vitin 2017 ishte 23%, pastaj rrogat nga sektori privat në vitin 2010 ishin 21%, ndërsa në vitin 2017 duke u rritur pjesëmarrja në 29%, po ashtu burime tjera të rëndësishme të të hyrave për

ekonomitë familjare mbesin bizneset e ekonomive familjare, pensionet, paratë e dërguara nga jashtë (remitencat) etj.

Sektori publik përfshin atë pjesë të ekonomisë kombëtare, për të cilën, në këtë apo atë mënyrë, ka përgjegjësi direkt qeveria.⁷ Sektori privat dhe sektori publik thjesht mund të mendohen si dy institucione alternative që mund të përdoren për shpërndarjen e resurseve të pakta në ekonomi.⁸

Në kuadër të sektorit publik, përveç institucioneve qeveritare (shtetërore) qendrore dhe lokale, përfshihen edhe organizata të tjera qeveritare dhe korporatat (ndërmarrjet) publike. Sektori publik nënkupton çdo organizatë e cila vepron për të siguruar shërbime publike e jo të krijojë fitim, ku financimi i të cilit është i kontrolluar nga qeveria, i cili gjithashtu monitoron performancën e saj.

Pra, sektori publik, përfshin departamentet e qeverisë qendrore, komunale, agjenci të tjera të cilat përdorin fondet publike. Organizatat e sektorit publik financohen në mënyrë publike dhe janë të varura nga sistemi tatimor. Shteti përmes të ardhurave publike që i mbledh kryen funksionin e tij publik dhe mbulimin e shpenzimeve publike.

Sa i përket veprimtarisë financiare të sektorit publik dhe sektorit privat ekzistojnë dallime. Veprimtaria financiare e shtetit (sektorit publik) të cilave u është besuar plotësisht i nevojave publike, ndryshon qenësisht nga veprimtaria financiare e personave fizikë dhe juridikë privatë (sektorit privat).

Për dallim nga kompanitë në sektorin privat të cilat objektiv kryesor kanë maksimizimin e fitimit, ndërsa organizatat, të tilla si: departamentet qeveritare, autoritetet komunale dhe kompanitë publike në sektorin publik nuk janë të orientuar kryesisht nga fitimi. Objektivat e tyre financiare janë kryesisht sekondare krahasuar me objektivat e tyre sociale, të cilat mund të shtrihen nga ofrimi i strehimit ose arsimimit e deri tek mbledhja e taksave.

Përmes tabelës në vijim pasqyrohet numri i të punësuarve dhe paga mesatare në sektorin publik në Kosovë.

⁷ Mançellari, Ahmet, Hadëri, Sulo, Kule, Dhori, Qiriçi, Stefan, Hyrje në ekonomi, Tiranë, 2002, fq. 233.

⁸ Jurgen G.Backhaus, Richard E.Wagner, Handbook of Public finance, 2006, fq. 21.


Tabela-2

Numri i të punësuarve dhe paga neto mesatare në sektorin e buxhetit në Kosovë, në periudhën 2010-2018.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Numri i marrësve të pagave në sektorin e buxhetit	77.164	78.068	79.181	80.816	81.618	81.777	81.629	81.466	81.884
Pagat neto mesatare në Administratën Shtetërore në euro	285	343	353	356	408	441	449	454	---


Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Vjetari Statistikor i Kosovës 2019, Prishtinë, 2019, fq. 95.

Figura 1: Numri i marrësve të pagave në sektorin e buxhetit në periudhën 2010-2018.



Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Vjetari Statistikor i Kosovës 2019, Prishtinë, 2019, fq. 95.

Figura 2: Paga neto mesatare në sektorin e Administratës Shtetërore në periudhën 2010-2017.



Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Vjetari Statistikor i Kosovës 2019, Prishtinë, 2019, fq, 95.

Në Kosovë, në sektorin publik sa i përket numrit të punësuarve dhe nivelit të pagave gjatë periudhës 2010-2018, ka pasur rritje si në numrin e të punësuarve, po ashtu edhe në nivelin e pagave. Nga tabela dhe grafiku shihet se, në vijueshmëri gjatë viteve ka pasur ecuri në rritje si në numrin e të punësuarve si dhe në nivelin e pagave. Në vitin 2010 në sektorin publik numri i të punësuarve ishte 77,164 të punësuar, ndërsa paga neto mesatare ishte 285 euro, duke u rritur numri i të punësuarve dhe pagave në vitin 2018, në 81,884 të punësuar, ndërsa paga mesatare neto në vitin 2017 ishte 454 euro.

Subjektet ekonomike janë bartëse kryesore të afarizmit të ekonomisë kombëtare. Ekonomia e çdo vendi është e përbërë prej shumë subjekteve nga sfera të ndryshme ekonomike. Të ardhurat nga puna paraqesin burimin kryesor të fitimit për pjesën dërrmuese të njerëzve. Në tabelën në vijim paraqitet niveli i pagave në sektorin privat sipas sektorëve ekonomikë në periudhën 2010-2017.


Tabela-3

Paga (bruto) mesatare mujore në sektorët ekonomikë, sipas viteve 2010-2017
- në euro

Përshkrimi i sektorëve ekonomikë	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Xehetari dhe gurëthyes	382	383	561	461	470	472	489	490
Prodhim	227	248	275	332	326	325	322	307
Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	555	557	564	608	610	615	702	714
Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	210	214	219	360	361	369	464	456
Ndërtimtari	227	275	360	319	329	337	383	401
Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve, motoçikletave	206	252	274	305	305	306	302	311
Transporti dhe magazinimi	262	263	263	366	379	394	389	372
Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	221	220	269	266	265	252	251	240
Informacion dhe komunikim	792	829	852	707	708	712	684	686
Aktivitete të shërbimeve tjera	255	302	334	275	293	308	266	265
Gjithsej	280	309	388	349	352	354	359	359

Agjencia e Statistikave e Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2018, Prishtinë, 2019, fq. 182.

Figura 3: Paga (bruto) mesatare mujore në sektorët ekonomikë, sipas viteve 2010-2017.



Agjencia e Statistikave e Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2018, Prishtinë, 2019, fq. 182.

Sa i përket nivelit të pagave në Kosovë, paga mesatare në sektorin privat është më e ulët se sa ajo në sektorin publik në Kosovë.

Nga tabela dhe grafiku vërehet, se gjatë periudhës 2010-2017, në sektorin privat edhe përkundër ecurisë në rritje të nivelit të pagave nga 280 euro sa ishte në vitin 2010 në 359 euro në vitin 2017, krahasuar me sektorin publik niveli i pagave në sektorin privat vazhdon të jetë më i ulët.

Po ashtu burim tjetër i rëndësishëm i të hyrave për ekonomitë familjare konsiderohen remitencat e dërguara nga emigrantët kosovarë, që vazhdojnë të luajnë rol shumë të rëndësishëm për mirëqenien e një numri të madh të qytetarëve të Kosovës, si dhe për ekonominë e vendit në tërësi. Dërgesat e emigrantëve kanë ndikim në proceset ekonomike dhe shoqërore në Kosovë, veçmas në vlerën e konsumit të popullsisë.⁹ Remitencat ofrojnë

⁹ Limani dr. Musa, Makroekonomia, Prishtinë 2013, fq. 222.

një burim të rëndësishëm të konsumit dhe investimeve të ekonomive shtëpiake.


Tabela-4

**Remitencat sipas kanaleve të dërgimit, për periudhën 2010-2017
- në milionë euro.**

	Gjithsej	Bankat komerciale	Agjencitë për transferimin e parave	Format e tjera
2010	584.3	141.3	213.1	229.9
2011	492.5	93.9	220.2	178.4
2012	516.4	92.6	236.7	187.0
2013	573.4	115.4	250.3	207.7
2014	622.3	115.2	281.6	225.4
2015	665.5	121.1	303.3	241.1
2016	691.0	116.3	324.4	250.3
2017	759.2	120.4	363.7	275.0

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Buletini Mujor Statistikor, Nr.208, Prishtinë, 2018, fq. 98.

Figura 4: Dërgesat e diasporës (Remitencat) në periudhën 2010-2017.



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Buletini Mujor Statistikor, Nr.208, Prishtinë, 2018, fq. 98.

Remitencat e diasporës të dërguara në Kosovë mbeten burim i rëndësishëm i të ardhurave për ekonomitë familjare në Kosovë. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën dhe grafikun më lart shihet, se remitencat kanë pasur ecuri në rritje gjatë periudhës 2010 - 2017.

Pra, remitencat e diasporës të dërguara në Kosovë, kanë pasur ecuri në rritje nga viti 2010 dhe viteve në vijim, kështu që në vitin 2010, remitencat e diasporës të dërguara në Kosovë ishin 584.3 milion euro, ndërsa në vitin 2017 ishin 759.2 milion euro.

PËRFUNDIMI

Të ardhurat paraqesin faktor të rëndësishëm në plotësimin e nevojave dhe përbalimin e kushteve të jetesës. Njerëzit me të ardhura më të mëdha kanë më shumë prirje për konsum se ata me të ardhura të ulëta. Lartësia e të ardhurave përcakton kërkesën për të mira materiale dhe shërbime. Me rritjen e të ardhurave njerëzit më shumë konsumojnë dhe anasjelltas. Nga kjo mund të themi, se në Kosovë vazhdon të mbetet burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare të ardhurat nga sektori publik, pastaj nga sektori privat.

Përveç rrogave nga sektori publik dhe rrogave nga sektori privat si burim i rëndësishëm i të ardhurave për ekonomitë familjare në Kosovë, konsiderohen të jenë pensionet dhe bizneset e ekonomive familjare, si dhe paratë e dërguara nga jashtë (remitencat).

Nga pjesa e përmbledhur e këtij punimi nxjerrim disa nga konkluzionet dhe përfundimet si vijon:

- Burimi kryesor i të ardhurave për ekonomitë familjare në Kosovë vazhdojnë të mbeten të ardhurat nga sektori publik, pastaj sektori privat dhe burim tjetër i rëndësishëm mbeten remitencat.
- Të ardhurat e ekonomive familjare duke qenë në nivel të ulët, padyshim ndikojnë edhe në nivelin e konsumit dhe përbalimin e kushteve të jetesës të ekonomive familjare në Kosovë.

LITERATURA

1. Mançellari, Ahmet , Hadëri, Sulo, Kule, Dhori, Qiriçi, Stefan, *Hyrje në ekonomi*, Tiranë, 2002.
2. Backhaus, G. Jurgen, Wagner, E. Richard, *Handbook of Public finance*, 2006.
3. Limani, dr.Musa, *Makroekonomia*, Prishtinë, 2013.
4. N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor, *Makroekonomia*, Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, Tiranë, 2012.
5. Koka, dr. Mimoza, *Makroekonomia*, Tiranë, 2014.
6. Sharku, dr. Gentiana, Leka, dr. Brikena, Bajrami, dr. Entleva, *Financa*, Tiranë, 2013.
7. Agjencia e Statistikave e Kosovës, *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2018*, Prishtinë, 2018.
8. Agjencia e Statistikave e Kosovës, *Rezultatet e anketës së buxhetit të ekonomive familjare 2019*, Prishtinë, 2019.
9. Banka Qendrore e Kosovës, *Buletini Mujor Statistikor*, Nr.208, Prishtinë, 2018.
10. Banka e Shqipërisë, *Financat personale në duart tuaja*, Tiranë, 2011.

ROLI I KREDITIMIT NË EKONOMINË E NJË VENDI. RASTI I SHQIPËRISË

Arsilda Nehanaj¹, Aurora Kinka (Pulti)²

¹*Opportunity Course Center,*

²*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Departamenti Financë – Kontabilitet*

Abstrakt

Ndikimi i sistemit financiar dhe veçanërisht i atij bankar pranohet që jetë mjaft i rëndësishëm për ekonominë e një vendi. Bankat bëjnë të mundur kalimin e fondeve nga njësitë sufiçitare tek ato defiçitare duke u bërë në këtë mënyrë një ndërmjetësues i rëndësishëm në përcaktimin e kanalit të shpërndarjes që do të vihet në dispozicion të sektorit privat.

Sistemi bankar ka njohur një zhvillim shumë të madh gjatë njëzet viteve të fundit megjithë problematikat e mëdha të pas viteve '90. Momentalisht sistemi bankar në Shqipëri përbën sektorin më të rëndësishëm të sistemit financiar duke na tregur në një farë mënyre për rolin e dobët që ka tregu i kapitalit dhe zhvillimi financiar. Niveli i kreditimit në një ekonomi ka lidhje të drejtëpërdrejtë me zhvillimin e saj.

Në literatura teorike të ndryshme mbi kreditimin janë theksuar efektet potencialisht pozitive të tij. Rritja ekonomike është konsideruar si aspekti më i rëndësishëm, sepse rritja ekonomike përbën një nga matjet sasiore në vlerësimin e suksesit të programit të zhvillimit.

¹ Diplomuar në vitin 2017 në Master Shkencor Financë(MSC). në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Aktualisht është koordinatore e Opportunity Course Center.

² Diplomuar në vitin 2004 në Bachelor Financë – Kontabilitet në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi dhe në 2008 ka marrë titullin Master Shkencor në Financë pranë Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2017 ka marrë gradën shkencore Doktor në fushën e Financës në Universitetin e Tiranës. Që nga viti 2004 është pedagoge pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi “ dhe lektore e lëndëve “Bazat e financës”, “Manaxhim financiar”, “Financa e Korporatave”.

Ky punim ka si qëllim që të tregojë ecurinë e kreditimit në Shqipëri ndër vite si dhe të paraqesë ndikimin e kreditimit mbi rritjen ekonomike për rastin e Shqipërisë.

Fjalët kyçe: sistemi financiar, sistemi bankar, niveli i kreditimit, rritja ekonomike.

The role of bank credit in the economy of a country. The case of Albania

Abstract

The financial system and especially the banking system is considered to have a very important role in the economy of a country. Banks provide funds from units that have surplus to the ones that do not have enough resources so in this way they have a very important role as financial intermediaries and in this way they determine the amount of credit that is available to the private sector.

The banking system has experienced a huge development during the last twenty years despite major problems of post-90s. Currently, the banking system in Albania is the most important sector of the financial system, telling us in some way about the weak role of the capital market and financial development. The level of lending in an economy is directly related to its development.

Various theoretical literatures on lending have highlighted its potentially positive effects. Economic growth is considered the most important aspect because economic growth is one of the quantitative measures in assessing the success of a development program.

This paper aims to show the performance of lending in Albania over the years and to present the impact of lending on economic growth in Albania.

Key words: financial system, banking system, credit, economic growth.

1. Hyrje

Që në momentin e fillimit të përdorimit të parasë në shoqëri kanë qenë dy lloje të personave: ata të cilët kanë më tepër para nga sa ju

nevojiten dhe ata të cilët nuk e kanë mundësinë që të mbulojnë shpenzimet e veta të momentit. Në mënyrë që të plotësoheshin këto nevoja financiare me kalimin e viteve u krijua ajo që ne sot njohim si sistemi i kreditimit. Industria bankare në ditët e sotme luan një rol mjaft të rëndësishëm në sistemin financiar të vendit tonë. Ai bën të mundur kalimin e depozitave të cilat mund t'i quajmë aktive likuide në hua ose aktive jolikuide.

Vendi ynë pas ndryshimeve politike të viteve '90 ka pësuar një ndryshim rrënjësor në të gjitha aspektet e sistemit financiar dhe veçanërisht të atij bankar. Rritja më e madhe njihet ajo pas vitit 2004 e deri me fillimin e efekteve të krizës botërore që pësuan tregjet financiare në vitin 2008. Pas kësaj, niveli i kreditimit në vend njohu rënie, si shkak i rënies së nivelit të likuiditetit të bankave dhe njëkohësisht të rënies së kërkesës nga ana e huamarrësve.

Në fushën e ekonomisë ka pasur gjithmonë një diskutim të madh rreth lidhjes që mund të jetë ndërmjet zhvillimit financiar dhe zhvillimit ekonomik. Pyetja kryesore e cila është diskutuar është në qoftë se ka lidhje shkak-pasojë ndërmjet tyre dhe a është zhvillimi financiar i cili sjell rritjen ekonomike apo ndoshta zhvillimi financiar thjesht ndjek rritjen ekonomike. Shumica e studimeve empirike të bëra arrijnë në konkluzionin se zhvillimi i sektorit financiar ndikon në përshpejtimin e rritjes ekonomike.

Konkretisht për të parë lidhjen kreditim – rritje ekonomike për Shqipërinë, në punimin tonë është realizuar një analizë ekonometrike e regresionit linear të shumës mbi seritë kohore të viteve 2000-2018, pra për 18 vite në total. Si variabël i varur është Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) dhe variabël i pavarur kreditimi i sektorit privat. Për një model me një shpjegueshmëri më të lartë, përveç këtyre variablave janë marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë shtesë të cilët kanë ndikim në rritjen ekonomike, si: norma e inflacionit për të ndihmuar në shpjegimin e disiplinës monetare, raporti i shpenzimeve qeveritare me PBB si mënyrë për të matur barrën qeveritare dhe eksportet si një ndër faktorët tradicionalë (edhe në teoritë më të vjetra) të cilët mund të lehtësojnë rritjen ekonomike.

1.1 Qëllimi

Qëllimi kryesor i këtij studimi është që të paraqesë një panoramë sa më të qartë të nivelit të kreditimit në Shqipëri si dhe ndikimin që mund të ketë ai në ekonomi. Synohet që kjo gjë të realizohet jo vetëm nga ana teorike, por edhe më anë të matjeve të bëra mbi ecurinë ndër vite si dhe gjetjen e lidhjes ndërmjet tyre.

1.2 Pyetja kërkimore

Cila është lidhja mes kreditimit të sektorit privat dhe rritjes ekonomike në Shqipëri?

2. Sistemi financiar dhe ndikimi i tij në ekonomi

2.1 Roli i sistemit financiar dhe ndërmjetësve financiarë

Roli i sistemit financiar është tëpër thelbësor për ekonominë e një vendi dhe kryesisht këtë rol e luan sistemi i formuar nga bankat. Operimi i bankave në treg realizohet nga mbledhja e fondeve nga njësitë suficitare dhe drejtimi i tyre drejt atyre njësive që kanë pamjaftueshmëri. Duke marrë parasysh që në një farë mënyre përcaktojnë shkallën e shpërndarjes së kredisë në ekonomi ato janë faktorë të rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë së një vendi.

Ndërmjetësit financiarë kanë një rol mjaft të rëndësishëm dhe thelbësor në funksionimin e një sistemi financiar. Veprimtaria e tyre mund të sjellë fitime të konsiderueshme për një ekonomi me përjashtim të rasteve kur ajo është e pakontrolluar ose mbikëqyrur që mund të shkaktojë ulje të nivelit të besueshmërisë në sistemin financiar.

2.2 Ecuria e sistemit financiar në Shqipëri

Me fillimin e viteve '90 erdhën edhe ndryshimet shumë thelbësore në sistemin financiar të vendit tonë. Në treg u futën shumë lloje institucionesh dhe shërbimesh që nuk ofroheshin më parë në aspektin financiar.

Në planin mikro dhe makroekonomik ekonomia e vendit tonë u përball me një sërë vështirësish dukë qenë se vinte nga një regjim më një ekonomi të centralizuar dhe më një kufizim në përdorimin e mënyrave të kreditimit. Duke marrë parasysh këtë, tregu ishte i etur për t'u plotësuar me kredinë mënyrë që të plotësoheshin nevojat e reja.

Gjatë dekadës së parë, pra nga 1990 deri në vitet 2000, e gjithë ekonomia duke përfshirë edhe sistemin financiar në Shqipëri janë karakterizuar nga një paqëndrueshmëri dhe madje disa herë edhe me goditje shumë të rënda, të cilat dhanë pasoja afatgjata në shumë fusha të tjera. Një ndër tronditjet më të mëdha të bëra ishte ajo e vitit 1997 e cila preku kryesisht sistemin bankar dhe u shkaktua nga mundësia që ju dha lulëzimit të tregut informal të ekonomisë.


2.3 Sistemi bankar

Baza më e rëndësishme për sistemin financiar për Shqipërinë është ajo e sistemit bankar për këtë arsye i kushtohet një rëndësi dhe vëmendje e madhe stabilitetit të tij.

Sistemi bankar i vendit tonë është i ndarë në dy nivele ku Banka Qendrore ka rolin e bankës qendrore dhe bankat tregtare kanë nivelin e dytë. Ndryshimet në mënyrën e funksionimit janë të dukshme që nga fillimi i funksionimit të tyre. Në fillimet e veta numri i bankave ishte tepër i ulët dhe forma e kapitalit të tyre ishte kryesisht shtetëror.

Ndikimi futjes së bankave të nivelit të dytë me kapital të huaj në vendin tonë ka qenë shumë i madh në ngritjen e këtij sistemi që ne kemi sot. Pasja e një numri më të madh të tyre pati një ndikim të drejtëpërdrejtë edhe në rritjen e kreditimit në ekonomi duke dhënë në këtë mënyrë efekte të vazhdueshme në rritjen e saj. Prania e bankave me kapital të huaj bën të mundur që të rritet stabiliteti në treg, kjo duke marrë parasysh rrezikun që kanë ato për falimentim është shumë më i ulët në krahasim me bankat vendase dhe në rast të ndonjë krize të mundshme në vend ato mund të injektojnë likuiditet.

Grafik 1: Numri i bankave në Shqipëri nga 1992-2017.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.4 Natyra e sistemit bankar në vendin tonë.

Siç shihet ndikimi i sistemit bankar ka një rëndësi të madhe në ekonominë e vendit tonë dhe në PBB, për këtë arsye është e mirë që të dihet më tepër rreth natyrës që ai ka pasur ndër vite në vendin tonë dhe situatën në të cilën ndodhet për momentin.

Pas viteve 2000 investimet e huaja direkte u rritën në mënyrë të konsiderueshme edhe në sektorin bankar bëri thithjen e kapitalit të huaj i cili i pati një rëndësi shumë të madhe. Ata të cilët zgjodhën të investojnë kapital në vendin tonë e bënë ndërmjet privatizimit ose krijimit të bankave të reja. Në ditët e sotme në sistemin bankar kemi një kapital të huaj i cili dominon atë shtetëror dhe origjina e tij është kryesisht nga Bashkimi Evropian.

Grafik 2: Struktura e kapitalit të sistemit bankar sipas origjinës.

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti vjetor 2017.

Ndër vite sistemi bankar ka pasur gjithnjë një normë të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit e cila për një periudhë të gjatë ka qenë edhe më e lartë se norma minimale e kërkuar. Shkak kryesor për këtë ishte, sepse në fillimet e viteve 2000, niveli i kreditimit ishte jo shumë i lartë dhe bankat investonin kryesisht në letrat me vlerë të qeverisë.

3. Karakteristikat e kreditimit në Shqipëri.

3.1. Faktorët që ndikojnë nivelin e kreditimit dhe tipare të përgjithshme të tij


Kreditimi bankar mund të ndikohet nga një seri e faktorëve të cilët mund të renditen si të ambientit të jashtëm ose si faktorë të brendshëm ose të specifikave që ka vetë çdo bankë. Shumë ekspertë janë marrë me studimin e tyre dhe kanë nxjerrë përfundime të ndryshme përgjatë viteve.

Niveli i kreditimit në një ekonomi ka lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimin e saj. Sa më shumë kreditim të ketë aq më shumë mundësi investimi do të ketë dhe kjo më pas do të sjellë një lidhje të drejtëprdrejtë në rritjen e vendeve të punës dhe të mirëqenies.

Duke njohur faktin që Shqipëria ishte një vend me një ekonomi të centralizuar, pas viteve '90 në të cilat u bë edhe liberalizimi i tregut, niveli i kreditimit ishte shumë i ulët dhe një gjë e tillë vijoi deri në fillim të viteve 2000. Menjëherë pas fillimit të gjallërimit të nivelit të kreditimit në vend edhe niveli i PBB njohu përmirësim në mënyrë të dukshme. Megjithëse nuk mund të thuhet në mënyrë të saktë se cili është shkaku dhe cila pasoja, por dihet që të dy janë mjaft të lidhur me njëri-tjetrin.

Niveli i kreditimit filloi të njohë përmasa të reja pas vitit 2005 kjo si duket si rezultat i shumë ndryshimeve të bëra në vendin tonë kryesisht në anën politike fillimisht. Konkurrenca filloi të ishte më e lartë dhe bankat filluan t'i kushtojnë më tepër rëndësi mënyrës se si ofronin shërbimet të ndryshme dhe kryesisht duke u fokusuar tek shërbimi i kreditimit. Filluan të kreditoheshin më tepër individë, por edhe biznese po ashtu u rritën përpjekjet për të ruajtur klientët e vjetër dhe për të shtuar ata të rinj.

Grafik 3: Niveli i ndryshimit të kreditimit në valutë, lekë dhe në total.




Burimi: Banka e Shqipërisë

3.2 Kreditimi në bazë të valutës.

Huadhënia në valutë pati një peshë mjaft të rëndësishme në kreditimin total pas vitit 2004 e deri në fillimin e krizës. Gjëja kryesore që ndikoi në këtë ishin normat e interesit më të ulëta që kishte kredidhënia në valutë përkundëjt asaj në monedhën vendase, por gjithashtu në të njëjtën kohë ishte edhe interesi i kredimarrësve.

Gjatë të gjithë periudhës që kursi i këmbimit kishte qenë në mënyrë të qëndrueshme problematikat që ekonomia mund të kishte për shkak të euronizimit nuk kishin dalë në pah. Me fillimin e krizës dhe të luhatjeve të para të mëdha që patën monedhat u shikuan edhe efektet që patën në ekonomi. Për këtë motiv nga ana e bankës qendrore filloi aplikimi i një sërë masash të cilat synonin ndryshimin e peshës që kishte në treg kreditimi në valutë.


Grafik 4: Kredia në lekë dhe në valutë.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.3 Kreditimi në bazë të afatit

Në periudhat e para të rritjes që pati kreditimi në sektorin bankar kredia afatgjatë ishte dukshëm më e preferuar se të tjerat. Një preferencë e tillë vinte kryesisht për shkak të pritshmërive pozitive që pritej të kishte ekonomia për të ardhmen dhe niveli i optimizmit ishte i lartë. Në të njëjtën kohë edhe investimi që bëhej në pasuri të paluajtshme po ashtu preferohej të shlyhej në periudhë afatgjatë, pasi pritej që çmimi i këtyre investimeve të bëra të rritej me kalimin e kohës.

Efektet që pati fillimi i krizës në vendin tonë dha një efekt edhe në afatin e maturimit që kishin kreditë. Tanimë bizneset kishin filluar të kërkonin kredi afatshkurtra në mënyrë që të mbulonin shpenzimet korente që nuk i përballonin dhe po ashtu individët për të përballuar vështirësitë ekonomike të periudhës filluan të rrisnin kërkesën për overdraft dhe kreditim me anë të kartës së kreditit

Grafik 5: Klasifikimi i kredive sipas afatit të maturimit.

Burime : Banka e Shqipërisë, Raporte vjetore.


3.4 Kreditimi në bazë të sektorëve

Në bazë të analizës që mund t'i bëhet kreditimit të sektorëve arrijmë të shikojmë që peshën më të konsiderueshme e ka marrë sektori i tregtisë,

riparimit të automjeteve dhe ai i ndërtimit me rreth 40%. Me kalimin e viteve duke marrë parasysh që sektori i ndërtimit filloi të pësojë rëniet e para për shkak të rënies së shitjeve në të njëjtën kohë edhe kërkesa e tyre për kredi pësoi rënie.

Vitet e fundit shihet që një rëndësi të konsiderueshme po fillon të ketë edhe sektori i energjisë duke kërkuar një nivel të rëndësishëm të kreditimit prej sektorit bankar. Një ecuri e tillë tregon që ky sektor po fillon të ketë një zhvillim dhe një impakt të madh edhe në pikëpamjen makroekonomike.

Grafik 6: Kreditimi në bazë të sektorëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.Ndikimi i kreditimit në rritjen ekonomike të vendit tonë.

4.1 Vendet në tranzicion dhe ndikimi i kreditimit në ekonominë e tyre.

Në fushën e ekonomisë ka patur gjithnjë një diskutim të madh rreth lidhjes që mund të jetë ndërmjet zhvillimit financiar dhe zhvillimit ekonomik. Pyetja më kryesore e diskutuar është në qoftë se ka lidhje shkak-pasojë ndërmjet tyre dhe a është zhvillimi financiar i cili sjell rritjen ekonomike apo ndoshta zhvillimi financiar thjesht ndjek rritjen ekonomike. Shumica e studimeve empirike të bëra arrijnë në konkluzionin se zhvillimi i sektorit financiar ndikon në përsheptimin e rritjes ekonomike.

Në bazë të studimeve janë katër grupe kryesore të shërbimeve të cilat sistemi financiar i jep ekonomisë: mobilizimi i kursimeve, diversifikimi i riskut, shpërndarja e kursimeve dhe monitorimi i menaxherëve të cilët bëjnë shpërndarjen. Të gjitha këto funksione së bashku munden që të ndikojnë kursimet, vendimet mbi investimet dhe si rrjedhojë më pas edhe rritjen ekonomike.

Vendi ynë po ashtu sikurse të gjitha vendet e dala nga një ekonomi e centralizuar mund të jetë veçanërisht interesant për t'u studiuar duke marrë parasysh tranzicionin e filluar në vitin 1990, vendosja e funksionimit në

mënyrën e duhur të sistemit financiar i cili është vonuar ose rrezikuar në shumë raste nga paqëndrueshmëria politike, hiperinflacioni ose edhe skemat piramidale. Studimet e bëra për të gjetur lidhjen mes zhvillimit të sistemit financiar dhe ekonomisë për vende të tilla si i yni kanë qenë mjaft të pakta dhe ato më kryesoret e bëra kanë tentuar që të gjejnë një lidhje pozitive ndërmjet disa treguesve financiarë dhe rritjes ekonomike.

4.2 Trajtimi teorik i studimit

Studimet kryesore në këtë fushë kanë filluar që në vitet e para të '90. Në 1993 King dhe Levine studiuan të dhënat e mbi 80 vendeve dhe qëllimi kryesor i studimit të tyre ishte që të analizonin efektet që sektori financiar kishte tek rritja ekonomike e sjellë me anë të PBB me katër indikatorë kryesorë si shuma e detyrimeve në raport me PBB, rëndësia e bankave tregtare në lidhje me banken qendrore kur bëhet shpërndarja e kreditit, raporti i kredisë së firmave private me totalin e kredisë dhe kreditimi i sektorit privat në raport me PBB. Pas kontrollit të bërë tek faktorët e tjerë që ndikojnë rritjen ekonomike King dhe Levine gjetën një lidhje të fortë dhe pozitive ndërmjet treguesve të zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike.

Në vitet e fundit shumë studime kanë përdorur si mënyrë për të nxjerrë përfundimet e tyre seritë kohore. Këto studime kanë konkluzione jo shumë të qarta për sa i përket rolit të zhvillimit të sektorit financiar dhe lidhjes së tij me rritjen ekonomike. Studimi i bërë nga Demetriades dhe Hussein në vitin 1996 u bënë teste shkak-pasojë për 16 shtete me ekonomi në zhvillim, tregon se lidhja shkak-pasojë ndërmjet sistemit financiar dhe rritjes ekonomike ndryshon në bazë të shteteve. Në pothuajse gjysmën e shteteve të marra në studim tregojnë një lidhje nga sistemi financiar tek rritja ekonomike, por pastaj për gjysmën tjetër lidhja shkon nga ekonomia tek financa, duke treguar në këtë mënyrë se nuk ka një të vetme të vërtetë unike e cila tregon se zhvillimi financiar mund të kontribuojë në rritjen ekonomike.

Winkler (2009) bën edhe njëherë rishikimin e procesit të varësisë financiare dhe lidhjen me cënueshmërinë dhe risqet e vendeve të Evropës Juglindore. Ai jep argument se strategjia e ndjekjes së zhvillimit financiar nëpërmjet hyrjes së bankave të huaja nuk do të thotë garantim të stabilitetit financiar.

Bonin dhe Watchel (2003) ishin të vetmit të cilët ranë dakord me pjesën se në dekadën e fundit si shkak i një mirëfunksionimi të tregut të ndërmjetësimit financiar kanë një impakt goxha të rëndësishëm në rritjen ekonomike të një vendi në tërësi.

4.3 Treguesit e përdorur për të bërë lidhjen ndërmjet rritjes ekonomike dhe kreditimi.

Në studimin e bërë rreth zhvillimit të sektorit bankar dhe rritjes ekonomike janë marrë të dhënat nga Banka Botërore për Shqipërinë nga viti 2000 deri në vitin 2018. Përcaktimi i viteve është bërë më tepër në përputhje me të dhënat e gjetura duke marrë parasysh se deri në vitin 2000 për disa nga indikatorët ishte e vështirë që të gjindeshin të dhënat.

Rritja ekonomike është një proces mjaft kompleks dhe që ndikohet nga një numër i madh faktorësh dhe teoria nuk na jep një përgjigje të qartë ose të vetme rreth pyetjes për përcaktimin e një modeli të vetëm dhe specifik. Literatura rreth kësaj teme po ashtu ka dilema rreth faktit se nëse variabli i varur në analizën empirike të rritjes ekonomike duhet të jetë norma e rritjes së PBB apo vlera e tij. Shumica e analizave përdorin normën e rritjes së PBB duke u nisur nga supozimi se ndryshimet në variablat shpjegues kanë një efekt të përhershëm në normën e rritjes së PBB. Për këtë motiv në këtë studim të bërë analiza do të bëhet duke u bazuar tek norma e rritjes.

Duke njohur faktin se sektori bankar dhe zhvillimi i tij është një koncept mjaft kompleks, duhet të përdoren shumë masa në mënyrë që të identifikohet, se cilat janë ato që janë më tepër të lidhura me rritjen ekonomike. Ne mund të përdorim masa matjeje të tilla, si: aktiviteti i sektorit bankar, madhësia e ndërmjetësve bankarë dhe eficaenca e sektorit bankar. Raporti ndërmjet kreditimit dhe PBB mund të përdoret si matës për të treguar zhvillimin bankar. Kreditimi i sektorit privat është një nga treguesit më kryesorë që përdoret në studimet empirike me qëllim shpjegimin e sistemit financiar dhe ecurinë e tij ndër vite. Kjo është veçanërisht për vendet si i yni, sepse përjashton kreditimin e qeverisë dhe ndërmarrjeve publike.

Në mënyrë që të kontrollojmë për faktorët e tjerë të cilët ndikojnë tek rritja ekonomike ne përdorim variabla që janë të zakonshëm për literaturën e trajtuar ndër vite. Si variabël tjetër shtesë në regresion përfshihet edhe norma e inflacionit për të ndihmuar në shpjegimin e disiplinës monetare, raportin e shpenzimeve qeveritare me PBB si mënyrë për të matur barrën qeveritare dhe eksportet. Eksportet konsiderohen si një ndër faktorët tradicionalë edhe në teoritë më të vjetra e cila mund të lehtësojë rritjen ekonomike. Si një masë matëse të eksporteve ne përdorim vlerat e eksporteve të të mirave dhe shërbimeve në lidhje me PBB.

Shumë studime të fushës të bëra si teorike dhe empirike nxjerrin rezultatet dhe japin sugjerimet se sa më të mëdha të jenë shpenzimet qeveritare aq më pak do të jetë tregu financiar i zhvilluar në atë vend. Prandaj, konsumi

qeveriar në përgjithësi përdoret si një variabël kontrollues kur kërkohet të bëhet përshkrimi i rritjes ekonomike (Kind dhe Levine 1993). Shpenzimet qeveritare i masim si raport i përgjithshëm i tyre me PBB dhe ne hedhim hipotezën për një lidhje negative ndërmjet tyre dhe rritjes ekonomike. Levine (1997) arriti të shpjegojë se një mbrojtje e mirë për investitorët do të shkaktojë më pas një rritje më të madhe ekonomike. Kjo situatë është veçanërisht e aplikueshme për produktet bankare ku lidhja me kompanitë tenton të jetë për periudha afatgjata. Për më tepër me rritjen e kompleksitetit të produkteve bankare, ata të cilët mund të bëjnë ndërtimin e politikave mund të vuajnë nga asimetria e informacionit. Mungesa e një sistemi të shëndoshë ligjor mundet gjithashtu që në një farë mënyre të pengojë efikasitetin e investimeve të bankave duke çuar në këtë mënyrë në rënien e vlerës së produkteve bankare.

4.4 Metodologjia e përdorur për studimin e bërë

Në bazë të ndjekjes së disa teorive në lidhje me rritjen ekonomike Barro dhe Sala Marin (2004) bënë sugjerimin se rritja e vërtetë ekonomike duhet të jetë e lidhur me disa variabla duke përfshirë vlerat fillestare të variablave të kontrollit të cilët reflektojnë në një lloj mënyre edhe zhvillimin ekonomik. Në mënyrë që të matet zhvillimi ekonomik ne mund të përdorim disa indikatorë të ndryshëm të cekur edhe më parë tek studimi.

Një ndër problemet kryesore në analizën empirike të rritjes ekonomike është të vlerësohet në mënyrën e drejtë se cili prej variablave të kontrollit të përfshihet në model. Brock dhe Durlauf (2001) e kanë përcaktuar një rezultat të tillë si një teori me të dhëna të hapura ose një lidhje shkak - pasojë ndërmjet një variabli dhe rritjes ekonomike dhe propozuan se një teori nuk mund të përcaktojë lidhjen ndërmjet një variabli tjetër dhe rritjes ekonomike. Sidoqoftë prioritet i këtij punimi nuk është që të ndikojë diçka në ndryshimin e teorisë, por të analizojë nëse dhe si zhvillimi i sistemit bankar mund të japë efekt në rritjen ekonomike. Për këtë qëllim më poshtë do të jepet modeli minimal i rritjes ekonomike si një mjet për të treguar lidhjet ndërmjet variablave:

$$y_i(PBB) = \beta_0 + \beta_1 K.P + \beta_2 EXP + \beta_3 INF + \beta_3 SH.Q + \epsilon_i \quad \text{për } i=1,2,\dots,n.$$

Mënyrat më kryesore për të bërë një studim mbi lidhjen e variablave të ndryshëm dhe ndikimin e tyre tek njëri- tjetri janë modelet e serive kohore dhe metoda e të dhënave të panelit. Për secilën prej tyre mund të nxirren avantazhet dhe disavantazhet përkatëse.

Sipas studimit të Temple (1999) mënyra më kryesore të cilën e përdorin ekonomistët për të përcaktuar rritjen ekonomike është ajo e regresioneve të

rritjes. Gjithsesi edhe me këtë mënyrë ka shumë probleme të lidhura edhe me këtë metodë dhe një ndër to, dhe më kryesorja, është ajo e heterogjenitetit të parametrave, gabimet e bëra në matje dhe endogjeniteti. Watchel (2001) beson se megjithë teknikat e përdorura më sipër përgjithësisht përdoren për të përmirësuar efektet, por në njëjtën kohë ato nuk e zgjidhin problemin në mënyrë përfundimtare. Ai argumenton se përdorimi i të dhënave të panelit bën një punë shumë më të mirë dhe korrekte.

Kërkuesit dhe studiuesit e kësaj fushe nuk kanë arritur në një mendim unanim në lidhje me të dhënat të cilat duhet të përdoren. Meqenëse marrëdhënia bazë e tyre është afatgjatë, disa argumentojnë se mesatarisht pesë deri në dhjetë vite të variablave duhet të përdoren minimumi në regresion me qëllim parandalimin e influencës që mund të japin efektet afatshkurta makroekonomike në rezultate.

Vlerësimet e bëra të treguesve të zhvillimit financiar mund të jenë të njëanshme për shumë motive, ndërmjet tyre mund të përmendim gabimin në matje ose lënien jashtë të variablave për shkak të një gjykimi jo të drejtë të bërë ndaj tyre. Për këtë arsye një metodë e përshtatshme duhet të përdoret më qëllim që vlerësimi i bërë të jetë i paanshëm dhe i qëndrueshëm.

4.5 Rezultatet empirike dhe analiza e modelit të regresionit.


Përdorimi i një teknike statistikore të tillë si model i regresionit na ndihmon që të ndërtojmë dhe të modelojmë lidhjen ndërmjet disa variablave shpjegues të cilët i quajmë ndryshe të pavarur dhe një variabli të varur. Çdo vlerë tek variabli i pavarur X do të ndikojnë tek vlera e variablit të varur Y. Për të matur së çfarë efekti ka niveli i kreditimit në vend tek rritja ekonomike dhe sa mund ta masim këtë efekt në formë sasiore në rastin e vendit tonë, duhet të realizohet analiza ekonometrike e regresionit linear të shumës mbi seritë kohore të viteve 2000-2018, pra për 18 vite në total. Synimi që ka një analizë e tillë është që të bëjë vlerësimin e variablit të varur kur jepen vlerat e variablave të pavarur dhe në fund të studimit ato duhet të jenë statistikisht domethënës me qëllim që të mund ta përdorim modelin për të nxjerrë konkluzione rreth fenomenit dhe parashikimet e bëra për të ardhmen.

4.5.1 Paraqitje grafike ndërmjet lidhjes së nivelit të kreditimit dhe rritjes ekonomike.

Një mënyrë e përdorur për të treguar marrëdhënien ndërmjet dy treguesve përpara vlerësimin të modelit të regresionit është ajo e Scattergraph. Ky

është një tip i diagramës matematikore e cila përdor koordinatat për të shfaqur vlerat e dy variablave për një seri të dhënash të caktuara. Boshti horizontal mban vlerat e njërit variablit përcaktues ndërsa ai vertikal vlerat e tjetrit dhe të dhënat e tyre shfaqen në formën e pikave ku secila prej tyre ka vlerat e variablave.

Grafiku7:Paraqitja grafike mes nivelit të kreditimit dhe rritjes ekonomike në Shqipëri (2000-2018).



Burimi: Llogaritje e autorit.

Si parametër të kontrolluar konsiderojnë atë i cili rritet ose ulet në varësi të parametrin tjetër të marrë në shqyrtim dhe ky vendoset në boshtin horizontal. Ndërsa variabli cili konsiderohet i varur, në rastin tonë rritja ekonomike do të vendoset në atë vertikal.

Në bazë të paraqitjes që na marrin variablat në model shikojmë se ekziston një marrëdhënie negative ndërmjet nivelit të kreditimit dhe vlerës së PBB, që do të thotë se një rritje e nivelit të kreditimit do të shkaktojë më pas edhe një rënie të nivelit të PBB.

Ky përfundim është në përputhje me studimin e Koivu (2000) dhe në ndryshim me të gjitha studimet e mëparshme. Koivu njihet si i pari që e gjeti këtë lidhje. Studimet e Fink (2009) dhe Caporale (2009) arrinin në përfundimet se sasia e kredisë nuk duhet të japë ndikim tek rritja ekonomike. Arsyeja e kësaj është se kufizimet që ka buxheti shpeshherë në vendet në tranzicion dhe dhënia hua tek kompanitë të cilat janë pjesë e një tregu me kufizime të buxhetit, bën që rezultatet e investimeve të mos jenë produktive dhe të sjellin humbje financiare. Sipas Mitchell (2001) bankat madje ndonjëherë ndikojnë negativisht në ekonomi duke i mbajtur llogari të tilla të kredive me probleme në bilancet e tyre të fundvitit. Për këtë motiv rritja e kreditimit nuk ka sjellë një përfitim të madh për ekonominë.

Një fenomen i rëndësishëm po ashtu i cili mund të çojë në të tilla rezultate dhe mund të jetë i lidhur me koeficientin negativ mund të jetë numri i lartë i krizës së bankave të cilën Shqipëria ka kaluar me ekonominë e saj ende në tranzicion. Ngrirja që pësuan tregjet financiarë globale në vitin 2008 pati një

lidhje të madhe edhe me sjelljen e investitorëve duke çuar në këtë mënyrë sistemin bankar në një situatë të vështirë për t'u kaluar dhe me ndikim të madh edhe në ekonomi. Pas një dekade me rrije ekonomike dhe me hyrje të reja të kapitalit në rajon, viti 2008 solli një kthesë të madhe, e cila pati një ndikim në situatën makroekonomike të vendit dhe një rënie të konisderueshme të prodhimit. Po ashtu në vitin 2010 u shfaqën probleme të tjera ku tregjet evropiane u përballën me trazira të tjera duke ngritur shqetësimin nëse disa vende të zonës së euros ishin në gjendje të financonin deficietet e tyre të buxhetore dhe rritjen e lartë që kishte marrë borxhi publik. Në fillim tregjet financiare u duk sikur i rezistuan pesimizmit që u krijua si shkak i borxhit në euro, por më pas presioni u bë më i madh duke shfaqur në një mënyrë edhe frikën se mosrritja e tij e mëtejshme do të krijonte prishjen e stabilitetit për sektorin bankar. Tregjet financiare ishin të fokusuara në efektet kryesore që mund të jepeshin nëpërmjet kanaleve kryesore tradicionale të infektimit nga kriza si tregtia ose ekspozimi bankar dhe vende të tilla si yni janë konsideruar më të prekshme duke marrë parasysh faktin se në treg ka prani të madhe të bankave greke.

4.5.2 Modeli i regresionit të shumfishtë

Programi “Gretl” na ndihmon që të përcaktojmë lidhjen që ekziston mes variablave të marrë në studimin tonë. Rezultatet e nxjerra janë:

Tabela 5: Analiza OLS, vëzhgimet e marra nga 2000-2018.

Variabël i varur: PBB

Variabla të pavarur	Koefiç.	Gabimi standard	Statistika t	Vlera p	
Konstante	15.2517	2.95877	5.155	0.0001	***
Niveli i kreditimit	-0.129233	0.0650121	-1.988	0.0668	*
No. e inflacionit	-0.0170521	0.248495	-0.06862	0.9463	
Niveli eksporteve	-0.124134	0.162772	-0.7626	0.4583	
Shpen. qeveritare	2.5814	8.3059	0.3108	0.7605	

Burimi: Llogaritje të autorit.

Model i regresionit:

GDP=15.25 - 0.13 rap.kreditim/GDP - 0.02 n.inf - 0.12 eksp. + 2.58 n.shp.qev

Rezultatet e mësipërme ofrojnë një mbështetje për hipotezën se ka një lidhje ngative ndërmjet nivelit të kreditimit të sektorit privat dhe rritjes ekonomike. Modeli na nxjerr një R^2 prej 0.539 që do të thotë se 53.9% e variacionit të rritjes ekonomike shpjegohet nga variablat e zgjedhur si shpjegues. Koeficientët të cilët ka marrë modeli i regresionit kanë shenjën e pritur në bazë të anës teorike të mbështetur. Nëse do t'i referoheshim vlerës kritike F (5.10), që tregon rëndësinë statistikore globale të modelit tonë, mund të themi se kemi një vlerë që tregon se modeli ynë është majft i mirë.

Konkluzione

Roli i sistemit financiar është tepër thelbësor për ekonominë e një vendi dhe kryesisht këtë rol e luan sistemi i formuar nga bankat.

Struktura e kredisë duket se ka njohur një sërë ndryshimesh në vitet e fundit përsa i përket sektorëve të ekonomisë, maturimit, por edhe valutës së preferuar për t'u marrë borxh.

Në fushën e ekonomisë ka pasur gjithnjë diskutim të madh rreth lidhjes që mund të jetë ndërmjet zhvillimit financiar dhe zhvillimit ekonomik. Në modelin e ndërtuar për të shikuar lidhjen mes nivelit të rritjes ekonomike dhe nivelit të kreditimit janë përdorur edhe variabla të tjerë të cilët në bazë të studimeve të bëra teorike tregohet qartë se japin ndikim. Variablat e përdorur janë norma e inflacionit, niveli i eksporteve dhe shpenzimet qeveritare. Të gjithë këta të fundit janë variabla të pavarur së bashku me nivelin e kreditimit ndërsa rritja ekonomike është variabli i varur ndaj tyre.

Në bazë të paraqitjes që na marrin variablat në model shikojmë se ekziston një marrëdhënie negative ndërmjet nivelit të kreditimit dhe vlerës së PBB, që do të thotë se një rritje e nivelit të kreditimit do të shkaktojë më pas edhe një rënie të nivelit të PBB. Modeli na nxjerr një R^2 prej 0.539 që do të thotë se 53.9% e variacionit të rritjes ekonomike shpjegohet nga variablat e zgjedhur si shpjegues. Koeficientët të cilët ka marrë modeli i regresionit kanë shenjën e pritur në bazë të anës teorike të mbështetur.

Ky përfundim është në përputhje me studimet e disa prej ekonomistëve të cilët kanë marrë në studim vendet e Evropës Juglindore dhe kryesisht ato me një ekonomi akoma në tranzicion. Arsyeja e kësaj është se kufizimet që ka buxheti shpeshherë në vendet në tranzicion dhe dhënia hua tek kompanitë të cilat janë pjesë e një tregu me kufizime të buxhetit, bën që rezultatet e investimeve të mos jenë produktive dhe të sjellin humbje financiare. Një fenomen i rëndësishëm po ashtu i cili mund të çojë në të tilla rezultate dhe mund të jetë i lidhur me koeficientin negativ

mund të jetë numri i lartë i krizës së bankave të cilën Shqipëria ka kaluar me ekonominë e saj ende në tranzicion.

Rekomandime

Sistemi bankar e ka të nevojshme që të krijojë një situatë më të qëndrueshme të depozitave në mënyrë që të garantohet në një farë mënyre më të përbërë edhe niveli i kreditimit. Në kushtet kur banka ka një normë të likuiditetit të lartë nënkupton që ajo mund të rrisë normën e huadhënies.

Me qëllim përmirësimit të "shëndetit" bankar duhet që t'i jepet një rëndësi e madhe edhe nivelit të kredive me probleme që është në vend për momentin. Shqipëria duhet të konsiderojë me një nivel të lartë të rëndësisë ndërtimin e një sistemi të mirëfilltë financiar në të cilin pesha që marrin tregjet e kapitalit ka shumë rëndësi. Gjithashtu me rëndësi është edhe ndryshimi i politikave të vetë bankave. Mënyra e vetme e implementimit të politikave të tilla do të jetë nëpërmjet përmirësimeve institucionale dhe dhënien e kontributit për rritjen e efikasitetit e veçanërisht të menaxhimit të riskut. Sistemi bankar duhet të dijë të shfrytëzojë pozicionin e tij si më i rëndësishmi i sistemit financiar dhe ta përdorë këtë në mbledhjen e informacionit rreth përdoruesve të produkteve bankare. Gjithmonë këto përpjekje të bankave duhet të ndihmohen edhe nga reforma të mirëfillta institucionale. Përmirësime të tilla do të ndihmonin sektorin bankar, por në të njëjtën kohë të japin efekt edhe në ekonominë e vendit.

REFERENCA

1. Arsene, F., dhe Guy-Paulin, D., (2013), "An Econometric Analysis of the Nexus between Credit to the Private Sector, Inflation and Economic Growth: Case of Cameroon 1965-2010", Working Paper
https://globaljournals.org/GJMBR_Volume13/7-An-Econometric-Analysis-of-the.pdf
2. Akpansung, A. dhe Babalola, S., (2011), "Banking sector and economic growth in Nigeria: An empirical investigation", Working Paper
https://www.econstor.eu/bitstream/10419/142050/1/cbn-jas_v2-i2-pp051-062.pdf
3. Banka e Shqipërisë, Raportet Vjetore të Mbikëqyrjes Bankare 2000-2017.
<https://www.bankofalbania.org/>
4. Duenwald Ch., Gueorguiev N. and Schaechter A., (2005), "Too much of a good thing? Credit booms in Transition Economies: The cases of Bulgaria, Romania and Ukraine", Working Paper. https://www.researchgate.net/publication/5124597_Too_Much_of_a_Good_Thing_Credit_Booms_in_Transition_Economies_The_Cases_of_Bulgaria_Romania_and_Ukraine
5. Égert, B., Backé, P., and Zumer, T., (2006), "Credit growth in Central and Eastern Europe. New (over)shooting Stars?" Working Papers
<https://pdfs.semanticscholar.org/8ede/77aef3d2d735c40be6ca5246845b75c45b33.pdf>

6. Hofmann, B., (2001), "The determinants of private sector credit in industrialized countries: do property prices matter?", Working Papers
<https://www.bis.org/publ/work108.pdf>
7. Kalluci, I., (2019), "Kreditimi në Shqipëri: Tendencat, karakteristikat, ekuilibri dhe faktorët që e përcaktojnë", Mbrojtje Disertacioni.
<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/epcontent/uploads/2019/04/Doktoratura-Irini-Kalluci.pdf>
8. Kelly, R., McQuinn, K., dhe Stuart, R., (2013), "Exploring dhe steady-state relationship between credit and GDP for small open economy: the case of Ireland", Working Paper.
<https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/scpWps/ecbwp1531.pdf?2854c58ec64673c9451ad22e70320531>
9. Korkmaz, S., (2015) "Impact of Bank Credits on Economic Growth and Inflation", Working Paper.
http://www.sciencypress.com/Upload/JAFB/Vol%205_1_4.pdf
10. Mühlberger, M., (2007), "Banking in South Eastern Europe: Moving into the spotlight", Deutsche Bank Research.
file:///C:/Users/User/Downloads/Banking_in_South_Eastern_Europe_Moving_into_the_Sp.pdf
11. Petkovski, M. dhe Kjosovski, J., (2014), "Does banking sector development promote economic growth? An empirical analysis for selected countries in Central and South Eastern Europe", Working paper.
<https://www.tandfonline.com/doi/pdf/10.1080/1331677X.2014.947107>
12. Reed, E., Cotter, R. and Gill, E., (1976) "Commercial Banking", New Jersey, USA, fq 160-164
13. Sheqeri, S., (2003), "Tronditjet e sistemit bankar Shqiptar dhe politikat e Bankës së Shqipërisë", Banka e Shqipërisë
https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Tronditjet_e_sistemit_bankar_shqiptar_dhe_politikat_e_Bankes_se_Shqiperise_1783_1_6312.pdf
14. Shingjergji, A., (2014), "Ndikimi i faktorëve makroekonomikë dhe bankar në nivelin e kredive me probleme në sistemin bankar Shqiptar", Temë disertacioni
<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/ep-content/uploads/2014/10/Doktoratura-Ali-Shingjergji-Fakulteti-i-Ekonomise-Departamenti-i-Finances.pdf>
15. Taci, A. and Fries, S. (2002), "Banking reform and development in transition economies", Working paper
file:///C:/Users/User/Downloads/Banking_Reform_and_Development_in_Transition_Economy.pdf
16. Vika, I., (2009), "Roli i Bankave në Transmetimin e Politikës Monetare në Shqipëri", Banka e Shqipërisë, Seria e Materialeve të Diskutimit 2009.
https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Studime_mbi_sistemin_bankar_dhe_zhvillimin_ekonomik_WWB_12486.pdf
17. Zdzienicka, A., (2009), "Vulnerabilities in Central and Eastern Europe: Credit Growth", Working Paper <file:///C:/Users/User/Downloads/0912.pdf>

NDIKIMI I RISTRUKTURIMIT NË EFIÇENCËN E KOMPANISË-RASTI I OSHEE, QARKU SHKODËR

Albano Beqiri¹, Irsida Kopliku²

¹ OSHEE sh.a, Sektori i Shitjes,

²Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Financë-Kontabilitetit

Abstrakt

Kompanitë përveç qëllimit kryesor për maksimizimin e fitimit të tyre udhëhiqen dhe nga parimet për plotësimin e standardeve dhe kënaqësisë së klientit. OSHEE ka synuar gjithmonë optimizimin e bilancit të saj, shërbimeve dhe produkteve për klientin dhe rritjen e kënaqësisë së tij. Ristrukturimi i organigramës së saj duke rishpërndarë përgjegjësitë dhe vendimmarrjen me qëllimin kryesor rritjen e efikasitetit në fillim të vitit 2018 shënon një kthesë pozitive në performancë. Pyetja kërkimore që ngrihet në këtë punim është se si ndikoi struktura e re organizative në efikasitetin e kompanisë OSHEE sh.a, e parë kjo në aspektin e arritjes së treguesve të performancës, duke u fokusuar veçanërisht në uljet e humbjeve në rrjet, në uljen e numrit të ankesave nga klientët familjarë dhe privatë, si dhe rritjen e përqindjes së realizimit të arkëtimeve, sipas tageteve në baza mujore, referuar faturimit përkatës.

Kërkimi konsiston në një analizë deskriptive dhe krahasuese, mbi gjendjen e disa treguesve të performancës para dhe pas një ‘shock’ i cili është restrukturimi i organigramës. Të dhënat janë marrë në database e kompanisë dhe lidhen me nivelin e arkëtimeve, numrin e ankesave, dhe përqindjen e humbjeve në rrjet për klientët privatë dhe familjarë të cilët banojnë në Qarkun Shkodër. Të dhënat u përpunuan me SPSS 20, duke

¹ Diplomuar në Financë-Kontabilitet, në 2011, dhe Master Shkencor në Administrim-Biznes, në Universitetin e Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’. Në periudhën 2010-2013 është angazhuar si financier në subjekte të ndryshme në sektorin privat, ndërsa nga 2013 e deri më sot është angazhuar në pozicione të ndryshme në OSHEE sh.a.

² Asistent lektor me kohë të plotë në Universitetin e Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’. Ka përfunduar studimet 4-vjeçare në Financë - Kontabilitet dhe Master Shkencor Kontabilitet në Universitetin e Shkodrës. Ka kryer një specializim për Financat Ndërkombëtare në Universitetin e Varshavës. Gjatë dhe pas studimeve është angazhuar në punë në sektorin privat, ashtu edhe në administratën publike duke krijuar një bazë experience të gjerë lidhur me fushën e ekonomisë.

përdorur teknikat dhe testet për krahasimin e mesatareve të dy grupeve. Rezultatet konfirmuan ndikimin pozitiv të ristrukturimit të kompanisë duke përmirësuar treguesit e performancës të marrë në shqyrtim, konkretisht duke ulur humbjet, ulur numrin e ankesave të klientit dhe duke rritur përqindjen e realizimit të arkëtimit.

Fjalët kyçe: Ristrukturim, Tregues performance, Eficiencë.

The organizational restructuring effect in the efficiency of a Company-OSHEE case

Abstract

Firms, except their purpose of maximizing their earnings, are led by principles of fulfilling standards and maximizing the clients' satisfaction. OSHEE has always targeted the optimizing of their financial and engineering balance, and the satisfaction of its clients. R restructuring of the organigrama by redistributing responsibilities and decisionmaking on purpose to increase efficiency in 2018, brought a positive turn in the overall performance. The rising research question in this study is hoë the neë organisative structure has influenced the efficiency of OSHEE, from the performance indicators point of view, focusing especially in minimizing te engineering loss, reducing clients' complaints, and rising the percentage of received cash from the current receipt. If this key performance indictor have moved positively, this means that the overall activities of the firm have improved taking in account the linked processes of the company. The research consists in a descriptive and comparative analysis, where data for the County of Shkodra is taken from 2016 till August 2019 and processed with statistical analysis (Paired t test) in SPSS. The results confirmed the positive influence of the new staff structure by improving the key performance indicators taken in analysis.

Key words: Restructuring, Performance Indicator, Efficiency.

Hyrje

Që nga krijimi i saj deri më sot, kompania ka synuar optimizimin e bilancit të saj, shërbimeve dhe produkteve për klientin dhe rritjen e kënaqësisë së tij. Një pikë kulmore në ecurinë e kompanisë gjatë viteve është ristrukturimi i organigramës së saj në strukturë që hyri në fuqi dhe filloi

aplikimin e saj më 01 janar 2018. Pritshmëritë e drejtimit të kompanisë ishin të mëdha, pasi ishte parashikuar një përmirësim i përgjithshëm i treguesve të performancës. Sigurisht një ndryshim i tillë implikon dhe çështje të tjera si një llogaridhënie dhe transparencë më të lartë, nivel më të lartë pagash bazuar në rezultate dhe tregues performance³, por gjithmonë me një centralizim raportimi.

Pyetja kërkimore që ngrihet në këtë punim është se si ndikon struktura e re organizative në efijencën e kompanisë OSHEE sh.a, e parë kjo në aspektin e arritjes së treguesve të performancës nga ana e kompanisë. Treguesit e performancës për vetë natyrën dhe dinamikën e kësaj ndërmarrjeje janë të shumtë, prandaj objekti i këtij hulumtimi është të verifikojmë nëse ristrukturimi i kompanisë ka pasur ndikim veçanërisht në 3 tregues performance si uljet e humbjeve në rrjet, në uljen e numrit të ankesave nga klientët familjarë dhe privatë, si dhe nëse është rritur përqindja e realizimit të arkëttimeve me mbi 90% në baza mujore, referuar faturimit përkatës. Disa autorë janë të mendimit se tregues më kompleksë dhe sezonalë performance janë më të përshtatshëm për disa operatorë ekonomikë për të matur efijencën⁴ e proceseve të tyre.

I. Një vështrim i përgjithshëm mbi strukturën e organizimit të OSHEE, operacionet dhe problematikat e implikuara

Punonjësit e kompanisë OSHEE konsiderohen padyshim burimi njerëzor më i çmuar që i siguron kompanisë zhvillim dhe mbarëvajtje. Janë ata që bëjnë të mundur ofrimin e një shërbimi të lartë dhe profesional në të gjitha pikëpamjet kundrejt konsumatorëve. Kompania synon në krijimin dhe inkurajimin e një mjedisi konkurrues midis punonjësve. Ajo synon në krijimin e një sistemi të ri incentivues të zbatueshëm për të gjithë stafin bazuar në një performancë që kërkon shumë punë. Sistemi duhet të ofrojë mundësinë për të zgjedhur nxitësa strategjike për çdo rol dhe vendndodhje dhe mundësinë për të përcaktuar pagesa të ndryshme të planifikuara në përputhje me natyrën e treguesve kryesorë të performancës edhe pse në një ent shtetëror⁵. Ky sistem dhe procesi i aplikimit të tij synojnë të rrisin garën

³ Greiling, D. (2006). Performance measurement: a remedy for increasing the efficiency of public services? *International Journal of Productivity and Performance Management*, Vol. 55, No. 6, 448-465.

⁴ Jacobs, R., Smith, P., & Goddard, M. (2004). *Measuring performance: An examination of composite performance indicators*. CHE Technical Paper Series 29.


⁵ Cutler, T. (2011). Performance Management in Public Services 'Before' New Public Management: The Case of NHS Acute Hospitals 1948-1962. *Public Policy and Administration* 26(1), 129-147

profesionale, si dhe të shërbejnë si instrument për identifikimin dhe administrimin e karrierës të punonjësve potencialë. Rritja arsimore dhe profesionale është një element shumë i rëndësishëm për kompaninë, duke synuar kështu balancimin e arsimit dhe të përvojës së punës së tyre me rolet dhe pozicionet që ato mbajnë. Politikat e burimeve njerëzore duhet të orientohen në dhënien e mundësive të barabarta në lidhje me punësimin, promovimin, pagat, përfitimet si dhe privilegje të tjera. Nga kombinimi i këtyre faktorëve realizohet ndërlihdja e kapitalit human, realizohen rezultate më të mira dhe një menaxhim i mirë i proceseve publike.⁶

1.1 Organigrama e re dhe ndryshimet kryesore në strukturë

Përmirësimet në strukturën organizative kanë qenë në fokusin e politikave të burimeve njerëzore, me qëllim rritjen e efikasitetit të kompanisë, duke forcuar bashkërendimin dhe komunikimin ndërdepartamental, përshtatjen e këtyre strukturave me detyrat e reja që burojnë nga objektivat strategjike të kompanisë, si dhe arritjen e standardeve të vendosura nga praktikrat më të mira në këtë lloj industrie.

Figura 1- Struktura e re organizative.




Burimi – Bordi Drejtues, Drejtorja e Kabinetit Oshee.

⁶Agranoff, R. (2008). Enhancing Performance Through Public Sector Networks: Mobilizing Human Capital in Communities of Practice. *Public Performance & Management Review*, Vol. 31, No. 3, 320-347.

1-Raporte Departamenti i Burimeve Njerëzore Tiranë & Shkodër.

Figura 2- Struktura e vjetër organizative.



Burimi - Bordi Drejtues, Drejtorja e Kabinetit Oshee


Struktura e vjetër organizative kishte një ndarje në 4 Njësi Administrimi, me bazë qytetet kryesore të Rajonit Shkodër, përkatësisht Njësia Shkodër (që ishte më e madhja në shtrirje dhe në numër klientësh, rreth 82000 klientë), Njësia Lezhë (me rreth 32000 klientë), Njësia Kopluk (me rreth 10500 klientë) dhe Njësia Pukë (me rreth 5800 klientë). Ky organizim ishte më i vështirë për Njësinë Shkodër, pasi kishte dhe numrin më të madh të klientëve dhe një shpërndarje gjeografike shumë më të madhe në krahasim me njësitë e tjera. Struktura e re bazohet në ndarjen në bazë NënStacioni / Fidri / Kabine dhe një numri të caktuar abonenti.⁷ Ndarja konsiston në formimin e Zonave të Shërbimit, përkatësisht 7 Zona Shërbimi, me bazë NST, ku çdo Zonë s' duhet të ketë më shumë se 25000 klientë. Zona e Shërbimit do të ketë përgjegjësi për çdo veprimtari dhe shërbim që mund t'u ofrohet klientëve, duke pasur akses për çdo ndërhyrje në shpërndarjen e burimeve njerëzore, sistemit të matjes dhe rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike tensioni TU. Hierarkia fillon nga koordinatori i zonës së

⁷ Raporte-Drejtorja e Kabinetit Oshee.

shërbimit – shefi i ekipit, i cili ka disa fidra të caktuara nën përgjegjësi, përkatësisht jo më shumë se 8000 klientë në qytet dhe 5000 klientë në fshat, ku përgjegjësia dhe të drejtat e tij janë gjithëpërfshirëse, duke i dhënë kompetanca për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe klientëve nën përgjegjësi; - administratori i proceseve, i cili administron dhe kontrollon mbarëvajtjen e të gjitha proceseve që realizohen nga Zona e Shërbimit, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse për çdo proces ku hasen problematika; - dataanalisti, ka si detyrë shpërndarjen e proceseve të punës ditore, raportimin e të dhënave dhe analizën e treguesve të performancës së proceseve dhe ecurinë e realizimit të targeteve kryesore faturim/arkëtim. Në strukturën e re të gjithë punonjësit kanë për detyrë dhe akses të mbulojnë të gjitha proceset e punës në fidrat që kanë nën varësi, duke filluar nga defektet në TU, sistemim matje, zgjidhje kërkesë/ankesave, faturimi dhe arkëtimi, ku kjo bën që ato të kenë përgjegjësi për çdo tregues rezultatesh.

Qëllimi i zonës së shërbimit është ekzekutimi i proceseve që lindin nga aktiviteti i shpërndarjes së energjisë elektrike te konsumatorët të cilët kanë një kontratë të furnizimit me energji elektrike osë kërkojnë të kenë një të tillë dhe në arritjen e efektivitetit në menaxhimin e këtij procesi.

Figura 3- Struktura e sektorit të shpërndarjes.



Burimi – Bordi Drejtues, Drejtoria e Kabinetit Oshee.

Vështirësitë fillonin si në shpërndarjen e punëtorëve në terren, logjistika për grupet e punës në terren, kontrolli i punës së tyre nga specialistët e njësisë, etj. Për të arritur këto rezultate duhen matur me tregues të veçantë me qëllim kontrolli, buxhetimi dhe promovimi.⁸ Shpërndarja e përgjegjësive bëhej në mënyrë të drejtë, pasi elektrikistët e verifikimtarët, të cilët bënin sistemimin e matjes, zgjidhjen e defekteve në skemë të matjes dhe kolaudimin e matësive, nuk kishin përgjegjësi në nivelin e humbjeve duke rritur dyshimet e moskorrektesisë në procedurat e punës⁹. Përgjegjësia për nivelin e humbjeve dhe mosarritjen e targetit të humbjeve binte mbi elektrikistët e kontrollit/debitorëve dhe faturuesve të zonave përkatëse. Kjo gjë rriste pakënaqësinë e tyre, pasi ato nuk kishin akses në sistemimin e matjes dhe kolaudimin e tij, duke qenë se matësi është 'peshorja' e matjes së performancës së tyre dhe të kompanisë. Shërbimi ndaj klientëve ishte më i vështirë me strukturën e vjetër, duke zgjatur në kohë zgjidhjen e kërkesë/ankesave të tyre, gjë që rriste pakënaqësitë e klientëve ndaj kompanisë. Kontrolli dhe evidentimi i problemeve që hasen në shpërndarjen e rrjetit ishte i vështirë duke qenë se ndarja e vjetër përfshinte një numër të lartë klientësh dhe shpërndarjeje gjeografike (përkatësisht Njësia Shkodër, e cila kishte dhe peshën më të madhe në numrin e klientëve dhe konsumin e energjisë elektrike). Në kuadër të bashkëpunimit që ka kompania OSHEE me Bankën Botërore, është bërë e mundur ristrukturimi i kompanisë nga niveli drejtues deri tek drejtoritë rajonale, me qëllim përmirësimin e performancës dhe veprimtarisë së OSHEE'së, arritjen e stabilitetit financiar në nivelin e arkëtimeve dhe të humbjeve, përgatitjen e kompanisë për tregun konkurrues rajonal. Ky projekt është financuar nga Banka Botërore me një grant të veçantë, ku fokus është Drejtoria Rajonale Shkodër. Marrëveshja e bashkëpunimit në kuadrin e asistencës teknike është bërë midis OSHEE dhe USAID më datë 12.12.2018 për një periudhë 1-vjeçare, e cila mund të zgjasë edhe më shumë, në varësi të ecurisë së përmirësimit të sistemit të shpërndarjes dhe shërbimit.

1.2 Sistemi i faturimit dhe problematikat e tij

Sistemi i faturimit përfshin të gjitha procedurat e punës që kanë të bëjnë me faturimin e energjisë elektrike të konsumuar në bazë klienti. Ky sistem fillon me përcaktimin e kabinave për lexim për çdo lexues, grafiku mujor i leximeve, me një ngarkesë të caktuar sipas udhëzimeve të Departamentit të

⁸ Behn, R. D. (2003). Why Measure Performance? Different Purposes Require Different Measures. *Public Administration Review*, Vol. 63, No. 5, 586-606, f. 594.

⁹ Raporte Departamenti i Shërbimit Tiranë.

Leximit, ku për zonat urbane jo më shumë se 1500 klientë dhe për zonat rurale jo më shumë se 900 klientë.¹⁰

Me strukturën e re çdo elektrikist/lexues duhet të lexojë brenda një NST dhe fidri të caktuar, dhe nuk duhet të dalë nga një fider i caktuar për lexim, kjo për arsye të rritjes së cilësisë së faturimit dhe ngarkimit të përgjegjësive në mënyrë të drejtë të personave që operojnë në të njëjtin fider. Problematika që haset në procesin faturimit janë klientët të cilët nuk janë të azhurnuar saktë në sistemin e faturimit, ku një klient furnizohet në një kabinë/fider të caktuar ndërsa në sistem rezulton në një kabinë/fider tjetër. Kjo problematikë shfaq moslexim korrekt të këtij abonenti nga elektrikisti/lexues i kabinës dhe një bilanc shitjeje jo të saktë të kabinës përkatëse, pasi ky abonent konsum energjinë e X kabine dhe faturimi i pasqyrohet Y kabine. Me strukturën e vjetër një lexues mund të lexonte në dy, tre ose më shumë fidra të ndryshëm njëkohësisht, madje edhe në NST të ndryshëm, ku kishte një ndërthurje midis disa lexuesve në të njëjtin fider dhe një numër më të lartë klientësh për lexim (në qytet rreth 2700 klientë për lexim dhe fshat 1650 klientë), duke krijuar një shpërndarje jo efëcente të ngarkesës e përgjegjësive dhe ulje të cilësisë së faturimit. Pas mbarimit të leximeve fillon faza e verifikimeve të rasteve problematike të cilat ndahen në tri kategori kryesore¹¹ : 1-Të dyshimta; 2-Të pakaluara; 3-Anomali.

Rastet e dyshimta janë ato raste ku një klient ka një konsum të dyshimtë, një rënie ose rritje të theksuar të konsumit në krahasim me muajin paraardhës, mesataren e faturimit vjetor dhe historikun e konsumit të klientit ndër vite.

Të pakaluara janë rastet të cilat nuk marrin faturë, kjo si rezultat i një indeksi aktiv, reaktiv dhe pikë më të vogël se ai në sistemin e faturimit, lexim i raportuar gabim 0, matësa të pamënaxhuar në sistem. Prioritet për verifikime kanë ato klientë të cilët kanë marrë faturë muajin ose vitin e kaluar dhe tani nuk marrin faturë.

Anomalite janë raste të cilat janë raportuar nga lexuesit me një problematikë të caktuar, anomali, e cila ndikon në matjen jo të drejtë të konsumit të energjisë elektrike. Anomalitë i ndajmë në 13 kategori, ku çdo anomali ka një kod identifikues.

1.3 Bilanci i humbjeve teknike- joteknike dhe sfidat me arkëtimet

Struktura e konsumit të energjisë elektrike ndikon drejtpërsëdrejti edhe në profilin e ngarkesës ose të konsumit të energjisë elektrike. Në dallim nga profili i ngarkesës në një ditë me konsum maksimal, në profilin e një dite


¹⁰ Departamenti i Divizionit Tregtar Tiranë & Shkodër.

¹¹ Vendimi Nr.101, datë 26.08.2008 ERE, KODI I MATJES.

me konsum minimal spikat një pik ngarkese në orët e mbrëmjes 19.00-22.00 i cili ka të bëjë kryesisht me intensifikimin e veprimtarisë familjare në këto orë.

Nga studimi i profilit vjetor të konsumit të energjisë elektrike, tipari karakteristik i këtij profili është simetria thuajse e plotë e konsumit dimër – verë. Çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë elektrike, pikërisht të efektit nga përdorimi ose mospërdorimi i ngrohjes elektrike të banesës.¹² Nga analiza e treguesve të balances së import-eksportit të energjisë elektrike për periudhën 1985 – 2014, vihet re se deri në vitin 1998, (me përjashtim vetëm të vitit 1990) vendi ynë ka qenë një vend eksportues neto i energjisë elektrike. Për periudhën 1998 – 2014, me përjashtim të vitit 2010, vendi ynë rezulton të jetë një importues neto i energjisë elektrike.

Figura 4- Import-Eksport i Energjisë Elektrike.



Burimi - INSTAT


Gjatë viteve efijenca e tregimit të energjisë elektrike ka vijuar të jetë e ulët deri në 2014, në referencë gjithnjë të faktorëve përcaktues në nivelin e efijencës së konsumit të energjisë elektrike të cilët janë:

- Niveli i lartë i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje,
- Niveli i ulët i arkëttimeve të energjisë elektrike të faturuar.

¹² Vendimi Nr.100, datë 26.08.2008, ERE, KODI I SHPËRNDARJES.

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga Kompania për vitin 2014, arrijnë në 37.81%, duke shënuar një rënie të ndjeshme. Humbjet totale në rrjet përbëhen nga humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim dhe humbjet në shpërndarje, të cilat përbëhen nga humbjet teknike dhe joteknike.

Figura 5- Humbjet e energjisë elektrike.



Burimi - INSTAT

II Hipotezat dhe metodologjia e kërkimit

Bazuar në pyetjen kërkimore mbi ndikimet e strukturës së re të kompanisë OSHEE.sha në efektivitetin e saj dhe përmirësimin e performancës, bazuar në tregues të brendshëm dhe të jashtëm janë ngritur 3 hipoteza, pikërisht lidhur me ndryshimet që ndodhin apo jo në këto indikatorë siç janë numri i ankesave në 15 ditësh, humbjet e kompanisë, faturimet apo arkëtimet.

Hipoteza 1 verifikon ndikimin e strukturës së re organizative, në efikasitetin e kompanisë duke përmirësuar cilësinë e operacioneve të saj, gjë që rezulton dhe në një numër më të ulët ankesash nga klienti.

$H_0: \mu_1 = \mu_2$ Hipoteza bazë: Numri i ankesave është statistikiisht i njëjtë para dhe pas futjes së strukturës së re organizative.

$H_1: \mu_1 \neq \mu_2$ Hipoteza alternative: Numri i ankesave nuk është statistikiisht i njëjtë para dhe pas futjes së strukturës së re organizative.

Hipoteza 2 verifikon ndikimin e strukturës së re organizative, në efikasitetin e kompanisë duke përmirësuar cilësinë e operacioneve të saj, nëpërmjet zvogëlimit të humbjeve joteknike, gjë e cila do të pasqyrohet dhe në uljet e humbjeve totale.

$H_0 : \mu_1 = \mu_2$ Hipoteza bazë: Humbjet totale teknike dhe joteknike janë statistikisht të njëjta para dhe pas futjes së strukturës së re organizative.

$H_1 \mu_1 \neq \mu_2$ Hipoteza alternative: Humbjet totale teknike dhe joteknike nuk janë statistikisht të njëjta para dhe pas futjes së strukturës së re organizative ku μ përfaqëson vlerën mesatare të humbjeve për Qarkun Shkodër dhe $i=1,2$ i referohet para dhe pas ndryshimit të strukturës.

Hipoteza 3 verifikon ndikimin e strukturës së re organizative, në efijencën e kompanisë duke përmirësuar cilësinë e operacioneve të saj, nëpërmjet rritjes së përqindjes së realizimit të arkëtimit (raportit arkëtim/faturim).

$H_0 : \mu_1 = \mu_2$ Hipoteza bazë: % e realizimit të arkëtimit është statistikisht e njëjta para dhe pas futjes së strukturës së re organizative.

$H_1 \mu_1 \neq \mu_2$ Hipoteza alternative: % e realizimit të arkëtimit nuk është statistikisht e njëjta para dhe pas futjes së strukturës së re organizative.

ku μ përfaqëson vlerën mesatare të % së realizimit për Qarkun Shkodër dhe $i=1,2$ i referohet para dhe pas ndryshimit të strukturës.

Analiza që bëhet me të dhënat e grumbulluara nga sistemi i OSHEE është një analizë përshkuese dhe krahasuese, kjo pasi na jep informacion përshkues mbi gjendjen e disa treguesve të performancës para dhe pas një 'shock'-u i cili është ristrukturimi i organigramës. Me anë të kësaj analize ne do të verifikojmë nëse ka pasur ndryshime në nivelet e indikatorëve të performancës. Të dhënat janë sekondare, pasi janë marrë në database e kompanisë me autorizimin përkatës nga instancat drejtuese. Ato kanë natyrë sasiore, numerike, pasi lidhen me nivelin e arkëtimeve, numrin e ankesave, dhe përqindjen humbjeve në rrjet. Popullimi përfshin të gjithë klientët privatë dhe familjarë të cilët banojnë në Qarkun Shkodër. Në këtë studim janë marrë në analizë të gjithë elementet e popullimit, që përfshihen në database e kompanisë. Të dhënat përfshijnë ankesat e klasifikuara në familjare apo private, në nivel kontrate, për çdo 15 ditësh në 4 vitet e fundit për Qarkun Shkodër. Për të njëjtin hark kohor në baza mujore, janë marrë të dhënat për humbjet totale, teknike dhe joteknike, si dhe vlerat përkatëse të faturimit dhe arkëtimeve, raporti i të cilave gjeneron përqindjen e realizimit të shitjeve.

Të dhënat janë përpunuar me SPSS 20, duke përdorur teknikat dhe testet për krahasimin e mesatareve të dy grupeve, para dhe pas një shoku apo ndërhyrjeje (Paired t-test), që në rastin e këtij kërkimi është ristrukturimi i kartës organizative të punonjësve.

Vlefshmëria. Ky punim ka një vlefshmëri të brendshme dhe të jashtme, pasi mund të shikohet qartë ndikimi që ka pasur struktura e re organizative e kompanisë, në aktorët kryesorë si punonjësit, bordin drejtues apo dhe

klientët, por njëkohësisht mund të shëbejë si një rast studimor për ndërmarrje shitjeje e shërbimi të ngjashme.

Gjetjet kërkimore

Të dhënat dhe gjetjet empirike të kërkimit në lidhje me ndikimin e organigramës së re në efikasitetin dhe efektivitetin e kompanisë OSHEE sh.a, të shikuara në aspektin e klientit, por dhe vetë firmës paraqiten bazuar në analizën krahasimore të treguesve të performancës para dhe pas ndërvënies të strukturës së re.

Bazuar në pyetjen kërkimore mbi ndikimet e strukturës së re të kompanisë OSHEE.sh.a në efektivitetin e saj dhe përmirësimin e performancës, bazuar në tregues të brendshëm dhe të jashtëm janë ngritur 3 hipoteza, pikërisht lidhur me ndryshimet që ndodhin apo jo në këto indikatorë siç janë numri i ankesave në një periudhë 15- ditore, humbjet e kompanisë, faturimet apo arkëtimet.

Hipoteza 1 pohon ndikimin e strukturës së re organizative, e cila rezulton në një numër më të ulët ankesash nga klienti, duke ndikuar në efikasitetin e kompanisë përmes përmirësimit të cilësisë të operacioneve të saj.

$H_0 : \mu_1 = \mu_2$ Hipoteza bazë: Numri i ankesave është statistiki i njëjtë para dhe pas futjes së strukturës së re organizative.

$H_1 : \mu_1 \neq \mu_2$ Hipoteza alternative: Numri i ankesave nuk është statistiki i njëjtë para dhe pas futjes së strukturës së re organizative.

ku μ përfaqëson numrin mesatar të ankesave për Qarkun Shkodër dhe $i=1,2$ i referohet para dhe pas ndryshimit të strukturës.

Bazuar në të dhënat dhe hipotezën janë krijuar 6 variabla dhe me numër vëzhgimesh si më poshtë:

ankesa_fam1	nr. i ankesave të klientit familjar në 15ditësh para strukturës së re	Janar2016-dhjetor2017 48 vëzhgime
ankesa_fam2	nr. i ankesave të klientit familjar në 15ditësh pas strukturës së re	Janar2018-shtator2019 42 vëzhgime
ankesa_privat1	nr. i ankesave të klientit privat në 15ditësh para strukturës së re	Janar2016-dhjetor2017 48 vëzhgime
ankesa_privat2	nr. i ankesave të klientit privat në 15ditësh pas strukturës së re	Janar2018-shtator2019 42 vëzhgime
ankesa_total1	nr. i ankesave të klientit në 15ditësh para strukturës së re	Janar2016-dhjetor2017 48 vëzhgime
ankesa_total2	nr. i ankesave të klientit në 15ditësh para strukturës së re	Janar2018-shtator2019 42 vëzhgime

Para se të testojmë hipotezat le të shikojmë të dhënat përshkruese për këto variabla.

Tabela 1- Statistika përshkruese.

Statistics

	nr ankesave të klientit familjar në 15ditësh para strukturës së re	nr ankesave të klientit familjar në 15ditësh pas strukturës së re	nr ankesave të klientit privat në 15ditësh pas strukturës së re	nr ankesave të klientit privat në 15ditësh pas strukturës së re	nr ankesave të klientit në 15ditësh para strukturës së re	nr ankesave të klientit në 15ditësh pas strukturës së re
Valid N	48	42	48	42	48	42
Missing	0	6	0	6	0	6
Mean	245.6	155.8	47.7	26.6	293.3	182.4
Mode	177.00 ^a	83.00 ^a	.00	18.00	98.00 ^a	79.00 ^a
Std. Deviation	203.78	118	58.2	20	238.3	136.7
Minimum	19.00	5.00	.00	.00	19.00	5.00
Maximum	896.00	492.00	270.00	83.00	939.00	575.00

Nga tabela shikojmë se numri mesatar i ankesave nga klienti familjar në një 15 ditësh para strukturës së re është 245, ndërsa pas saj 155 ankesa me një ndryshim domethënës prej 90 ankesa në afro 2 javë. Nëpërmjet testimit statistikor do të shikojmë nëse ky ndryshim është me të vërtetë domethënës apo thjesht i rastit. Gjithashtu ndryshim të madh ka dhe numri mesatar i ankesave të klientit privat nga 47 në 26, dhe si rrjedhojë edhe numri total mesatar i ankesave. Përgjithësisht ka një devijim standard shumë të lartë që tregon ndryshueshmërinë e madhe të vëzhgimeve nga mesatarja, ku një rast

ekstremum është dhe vlera maximale 896 për ankesat e klientit familjar dhe 939 total, që i përkon periudhës 15-30 Prill 2016.

Tabela 2-Rezultatet e Paired Samples Test

Paired Samples Test

	Paired Differences					t	df	Sig. (2-tailed)
	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean	95% Confidence Interval of the Difference				
				Lower	Upper			
Pair 1 nr i ankesave të klientit familjar 1 - nr i ankesave të klientit familjar 2	80.8	211.05	32.5	15.0	146.5	2.5	41	.017
Pair 2 nr i ankesave të klientit privat 1 - nr i ankesave të klientit privat 2	12.404	43.298	6.681	-1.087	25.897	1.9	41	.071
Pair 3 nr i ankesave të klientit total 1 - nr i ankesave të klientit total në 15ditësh 2	93.21	237.29	36.61	19.269	167.16	2.5	41	.015

Hipotezën e mësipërme e kemi ngritur dhe për klientin familjar, privat dhe në total, duke testuar kështu në qoftë se ndryshon numri i ankesave të klientit familjar para dhe pas ndryshimit organizativ, numri i ankesave të klientit privat para dhe pas ndryshimit dhe në total. Hipotezën e testojmë me Paired t-test, pasi i njëjti popullim që janë klientët e Qarkut Shkodër i merr shërbimin nga e njëjta kompani, por me një organizim ndryshe, për të cilin ne kemi mendimin hipotetik që është më eficient, dhe kjo do të pasqyrohet dhe me një numër më të vogël ankesash.

Bazuar në rregullin e marrjes së vendimit për hipotezat, me Paired t-test (pasi janë verifikuar kushtet për ushtrimin e tij) vërejmë që probabiliteti p

ose $\text{sig} = 0.017, 0.071$ dhe 0.015 përkatësisht për palët e testuara para dhe pas riorganizimit për numrin mesatar të ankesave nga klientët familjarë, privatë dhe total në 15 ditë është më i vogël se 0.05 ose 5% , që është gabimi i lejuar në studim. Në këtë mënyrë mund të hedhim poshtë hipotezën bazë dhe të mbajmë si statistikisht të vërtetë hipotezën alternative duke pohuar se numri i ankesave pas riorganizimit të strukturave të punës ka rënë në mënyrë të ndjeshme, e provuar statistikisht me një gabim të lejuar 5% .

Hipoteza 2 verifikon ndikimin e strukturës së re organizative, në efijencën e kompanisë duke përmirësuar cilësinë e operacioneve të saj, nëpërmjet zvogëlimit të humbjeve joteknike, gjë e cila do të pasqyrohet dhe në uljet e humbjeve totale.

$H_0 : \mu_1 = \mu_2$ Hipoteza bazë: Humbjet totale teknike dhe joteknike janë statistikisht të njëjta para dhe pas futjes së strukturës së re organizative.
 $H_1 \mu_1 \neq \mu_2$ Hipoteza alternative: Humbjet totale teknike dhe joteknike nuk janë statistikisht të njëjta para dhe pas futjes së strukturës së re organizative.
 ku μ përfaqëson vlerën mesatare të humbjeve për Qarkun Shkodër dhe $i=1,2$ i referohet para dhe pas ndryshimit të strukturës.
 Bazuar në të dhënat dhe hipotezën janë krijuar 6 variabla dhe me numër vëzhgimesh si më poshtë:

humbje_1	% e humbjeve totale mujore para ristrukturimit	Janar 2016-gusht 2017 20 vëzhgime
humbje_2	% e humbjeve totale mujore pas ristrukturimit	Janar 2018-gusht 2019 20 vëzhgime

Para se të testojmë hipotezat le të shikojmë të dhënat përshkruese për këto variabla.

Tabela 3-Statistika përshkruese

Statistics

	% e humbjeve totale mujore para ristrukturimit	% e humbjeve totale mujore pas ristrukturimit
N Valid	20	20
Missing	0	0
Mean	.44071	.40268
Mode	.352 ^a	.325 ^a
Std. Deviation	.068287	.039676
Minimum	.352	.325
Maximum	.623	.463

a. Multiple modes exist. The smallest value is shown.

Nga të dhënat përshkruese në tabelën e mësipërme shikojmë që humbjet mesatare totale para ristrukturimit janë rreth 44% ndërsa pas ristrukturimit janë 40.2%. Ndryshime të dukshme kemi në vlerat maximum 62.3% në janar 2017 dhe vlerës makimale pas ristrukturimit 46.3% në dhjetor 2018. Gjithashtu vërejmë se dhe devijimi standard mesatar i humbjeve është më i ulët nga afro 7% në 4% pas ristrukturimit. Le të verifikojmë statistikisht hipotezën e ngritur në lidhje me humbjet totale dhe ndikimin e strukturës së re organizative në menaxhimin e tyre. Me anë të Paired t Test do të verifikojmë nëse ulja me rreth 4% e këtyre humbjeve mesatare është statistikisht domethënëse apo thjesht rezultat i rastit.

Hipotezën e testojmë me Paired t-test, pasi i njëjti popullim që janë klientët e Qarkut Shkodër marrin shërbimin nga e njëjta kompani, por me një organizim ndryshe, për të cilin ne kemi mendimin hipotetik që është më eficient në menaxhimin e operacioneve, dhe kjo do të pasqyrohet dhe me një ulje të humbjeve .

Tabela 4-Rezultatet e Paired Samples Test.

Paired Samples Test

	Paired Differences					t	df	Sig. (2-tailed)
	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean	95% Confidence Interval of the Difference				
				Lower	Upper			
Pair 1 % e humbjeve mujore para - % e humbjeve mujore pas ristrukturimit	.038	.062	.013993	.00874	.06732	2.718	19	.014

Bazuar në rregullin e marrjes së vendimit për hipotezat, me Paired t-test (pasi janë verifikuar kushtet për ushtrimin e tij) vërejmë që probabiliteti p ose sig =0.014 më i vogël se 0.05 ose 5 % që është gabimi i lejuar në studimin tonë. Në këtë mënyrë hedhim poshtë hipotezën bazë dhe mbajmë si statistikisht të vërtetë hipotezën alternative duke pohuar se humbjet joteknike pas riorganizimit të strukturave të punës ka rënë në mënyrë të ndjeshme, e provuar statistikisht me një gabim të lejuar 5%.

Në hipotezën e tretë të formuluar, ndiqet logjika e punës në OSHEE bazuar në % e realizimit. Përqindja e realizimit të arkëtimit tregon pjesën e faturës mujore që arkëtohet, ku si target kryesor është 90% dhe mund të shkojë deri në 110%. Kjo ndodh, sepse aftësia paguese e klientit, mund të variojë bazuar në kushtet e ndryshme financiare në të cilat ai ndodhet, pavarësisht se vërehet fakti që edhe fatura dhe arkëtimi i binden një lloj sezonaliteti, që ndikohet së pari nga kushtet atmosferike, dhe së dyti, sipas flukseve

financiare. Arkëtimet e një muaji mund të përfshijnë dhe debinë e një, dy apo më shumë muajve të mëparshëm dhe si rrjedhojë mund të tejkalojë vlerën e faturimit mujor.

Hipoteza 3 verifikon ndikimin e strukturës së re organizative, në efijencën e kompanisë duke përmirësuar cilësinë e operacioneve të saj, nëpërmjet rritjes së përqindjes së realizimit të arkëtimit (raportit arkëtim/faturim).

$H_0: \mu_1 = \mu_2$ Hipoteza bazë: % e realizimit të arkëtimit është statistikisht e njëjta para dhe pas futjes së strukturës së re organizative.

$H_1: \mu_1 \neq \mu_2$ Hipoteza alternative: % e realizimit të arkëtimit nuk është statistikisht e njëjta para dhe pas futjes së strukturës së re organizative.

ku μ përfaqëson vlerën mesatare të % së realizimit për Qarkun Shkodër dhe $i=1,2$ i referohet para dhe pas ndryshimit të strukturës.

Tabela 5-Statistika përshkruese.

Statistics

		% e realizimit të arkëtimit para ristrukturimit	% e realizimit të arkëtimit para ristrukturimit
N	Valid	20	20
	Missing	28	28
Mean		.8754	.9856
Mode		.71 ^a	.84 ^a
Std. Deviation		.07765	.08872
Minimum		.71	.84
Maximum		1.07	1.21

a. Multiple modes exist. The smallest value is shoën

Nga të dhënat përshkruese në tabelë mund të shikojmë se përqindja mesatare e realizimit të arkëtimeve është rritur nga 87.5% në 98.5%, pra me 11%. Gjithashtu konstatojmë se realizimi ka qenë nën targetin e kompanisë, ndërsa pas ristrukturimit targeti tejkalohet. Ndryshe nga rastet në hipotezat e tjera, devijimi standard i % së realizimit është rritur me 1.1%, një e dhënë pozitive që i bën arkëtimet e kompanisë të parashikueshme deri në një masë, bazuar tek faturimi.

Tabela 6-Rezultatet e Paired Samples Test

Paired Samples Test

	Paired Differences					t	df	Sig. (2-tailed)
	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean	95% Confidence Interval of the Difference				
				Lower	Upper			
Pair 1 % e realizimit të arkëtimit para ristrukturimit - % e realizimit të arkëtimit para ristrukturimit	-.110	.12634	.02825	-.16933	-.05108	-3.9	19	.001

Nga rezultatet e testit, bazuar në rregullin e marrjes së vendimit për hipotezat, me Paired t-test (mund të hedhim poshtë hipotezën bazë dhe të mbajmë si statistikisht të vërtetë hipotezën alternative (sig<0.05) duke pohuar se përqindja e realizimit të arkëtimit pas riorganizimit të strukturave të punës është rritur me sukses në mënyrë të ndjeshme me 11%, duke përmirësuar performancën, e provuar statistikisht me një interval besimi 95%.

Përfundime dhe komente

Bazuar në gjetjet kërkimore që u shpalosën më sipër mund të konkludojmë se struktura e re ka sjellë ndryshime pozitive në treguesit e performancës. Meqenëse një prioritet i kompanisë është shërbimi ndaj klientit dhe minimizimi i ankesave që ato kanë për çështje të ndryshme, nga ana statistikore u vërtetua se numri i ankesave ka rënë me rreth 93 ankesa në dy javë, ku peshën specifike më të madhe e zënë ankesat nga konsumatori familjar, por gjithashtu edhe ankesat nga konsumatori privat kanë shënuar ulje të ndjeshme, duke vërtetuar dhe njëherë efikasitetin e kompanisë, bazuar në këtë tregues.

Një ndryshim i dëshiruar në tabelën e rezultateve nga drejtimi i kësaj ndërmarrjeje, për të cilin janë ndërmarrë dhe masa nga më të ndryshmet është dhe ulja e humbjeve joteknike si zë me peshë në humbjet totale, duke pasur parasysh faktin që humbjet teknike janë pothuajse në nivele të njëjta. Nga të dhënat që u analizuan rezulton se ndryshimi i organigramës ka sjellë hapa pozitivë në uljen e humbjeve totale me rreth 4% në muaj, duke ndikuar pozitivisht bilancin e kompanisë. Kjo tregon se faturimi ka qenë më i saktë dhe më i afërt me konsumin real të klientit si dhe janë ulur rastet e abuzimit me linja të dyta.

Së treti dhe shumë e rëndësishme për kompaninë, është treguesi i efijencës që shpreh përqindjen e realizimit të arkëtimeve, i cili është përmirësuar me 11% pas futjes së skemës së re organizative. Kjo tregon se tashmë në baza mujore arrihet targeti prej 90% për arkëtimet e faturës mujore dhe ka konsistencë ky fakt, pavarësisht nivelit të faturimit.

Menaxhimi i operacioneve në përgjithësi është shumë i rëndësishëm për këtë kompani dinamike, e cila duhet të kryejë parashikime sa më të afërta me realitetin, në lidhje me nevojat për të blerë energjinë, arkëtimet, pagesat, investimet dhe shpenzimet për mjete dhe materiale. Por hapi kryesor, promotori i të gjitha aktiviteteve është procesi i faturimit, i cili duhet të jetë sa më i saktë dhe me një tolerancë gabimi sa më të vogël. Nga faturimi dhe leximi që është dhe përballja me terrenin dalin në pah të gjitha çedimet që mund të ketë krejt zinxhiri i aktiviteteve në kompani. Me strukturën e re ankimimet janë reduktuar, faturimi është më i saktë, humbjet janë ulur dhe mbledhja e debisë nuk është më problem. Ajo çfarë sugjerohet është ulja e kohës për procesimin e kërkesë/ankesave e cila zgjatet artificialisht nga centralizimi i të dhënave, si dhe vazhdimi i politikave nxitëse për rekrutimin e specialistëve me profesionalizëm të lartë dhe arsimim në përputhje me punën që duhet kryer. Nga teoritë e ndryshme të motivimit, në përputhje dhe me arritjet e treguesve të performancës, është edhe realizimi i shpërblimit financiar në rastet e arritjes së targeteve, i personave që kanë influencuar në arritjen e tyre.

Kufizimet dhe supozimet. Sigurisht që ky punim ka kufizimet përkatëse. Së pari në mbledhjen e të dhënave do të ishte më relevante në qoftë se do të merrnim vetëm pjesën e humbjeve joteknike dhe jo në total, por meqenëse kjo ishte pothuajse e pamundur dhe nën supozimin se humbjet teknike janë pothuajse konstante gjatë periudhës së marrë në shqyrtim, edhe humbjet totale përbëjnë një zë domethënës. Së dyti, kërkimi bazohet në supozimin se në krahasimin e ankesave, humbjeve, faturimit dhe arkëtimit mes periudhave të njëjta (p.sh., janar 2016 me janar 2018) ndryshon vetëm fakti që aplikohet struktura e re e drejtimit, ceter paribus (referuar kushteve atmosferike, aftësisë paguese apo investimeve në rrjet). Së treti, do të ishte më e volitshme një numër më i madh vëzhgimesh, për një përfaqësim më të mirë të situatës, por bazuar në të dhënat dhe llojin e veçantë të tyre, mundësia për të dhëna të sakta ishte vetëm për këtë hark kohor.

REFERENCA

1. Agranoff, R. (2008). Enhancing Performance Through Public Sector Networks: *Mobilizing Human Capital in Communities of Practice*. Public Performance & Management Review, Vol. 31, No. 3, 320-347.
2. BAK. (2007). *Decentralisation Indicators: Preliminary final report of the pilot study*. Basel: BAK Basel Economics.
3. Bartels, K. P. (2009). The Disregard for Weber's "Herrschaft": *The Relevance of Weber's Ideal Type of Bureaucracy for the Modern Study of Public Administration*. Administrative Theory & Praxis, Vol. 31, No. 4, 447-478
4. Behn, R. D. (2003). *Why Measure Performance? Different Purposes Require Different Measures*. Public Administration Review, Vol. 63, No. 5, 586-606.
5. Cutler, T. (2011). *Performance Management in Public Services 'Before' New Public Management: The Case of NHS Acute Hospitals 1948–1962*. Public Policy and Administration 26(1), 129-147
6. Greiling, D. (2006). *Performance measurement: a remedy for increasing the efficiency of public services?* International Journal of Productivity and Performance Management, Vol. 55, No. 6, 448-465.
7. Jacobs, R., Smith, P., & Goddard, M. (2004). *Measuring performance: An examination of composite performance indicators*. CHE Technical Paper Series 29.
8. Pidd, M. (2012). *Measuring the Performance of Public Services: Principles and Practice*. Cambridge University Press.
9. Raporte-Drejtoria e Kabinetit Oshee.
10. Raporte Departamenti i Divizionit Tregtar Tiranë & Shkodër.
11. Raporte Departamenti i Burimeve Njerëzore Tiranë & Shkodër.
12. Raporte Departamenti i Shërbimit Tiranë.
13. Vendimi Nr.100, datë 26.08.2008, ERE, KODI I SHPËRNDARJES.
14. Vendimi Nr.101, datë 26.08.2008 ERE, KODI I MATJES.
15. Zyra e Kujdesit Ndaj Klientit Shkodër-Database.

ISSN 2411 - 4960

*Doli nga shtypi dhjetor 2019 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x 250mm.
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*